

PËRMBAJTJA

Portreti i muaji: Pavarësia e pakthyeshme	2
Dr. Milazim Krasniqi: Bashkëpunimi rajonal "euro-integrues" po e izolon Kosovën	3-4
Muhamet Jahiri: Kuvendi miratoi deklaratë politike.....	5
Muhamet Jahiri: Strategjia inkurajuese, por e vështirë për t'u implementuar.....	6-7
Alban Zeneli: Jeta në dysh e banorëve të Mitrovicës.....	8
Drita Vitia: Shkenca e ndarë në dysh.....	9-10
Drita Vitia: Nderim shtetëror të rënëve për liri..	11-13
Fatos Shala: Të sëmurit mentalë – rrezik për qytetarët.....	14
Astrit Veliqi: Bastoromania që 'zhvesh' emocionet e thyera kosovare!	15
Osman D. Gashi: Mungesë e literaturës shqipe në universitet.....	16-17
Lulzim Ahmeti: Sukseset vazhdojnë.....	18-19
Intervistë me kryeshefin ekzekutiv të PTK-së, dr. Shyqri Haxha	20-21
Mr. Milazim Mustafa: Po zbrazet Karadaku i Kumanovës!!!	22-23
Drita Azemi: Presheva mes shpresës dhe zhgënjimit..	24
Iljasa Salihu: Loja e shumëfishtë me kufijtë shqiptaro-shqiptarë	25-26
Muhamed J. Kajolli: Lufta rreth devesë.....	27-30
Agim Avdiu: Ankthi i tërmeteve përfshin edhe Kosovën	31
Tërmetet: Kur toka nis të dridhet.....	32-33
Rindërtimi i qyteteve të shkatërruara	34
Avni Avdiu: Greqia në kolaps – Evropa në ankth..	35-36
Rini Hyseni: Çamëria – plaga që dhemb.....	36-37
Flamur Maloku: Kulturë.....	38
Alban Bilalli: Nuk e pengon futbollli për namaz...	39
Fjalëkryqi	40



5 uvendi miratoi deklaratë politike



16 Mungesë e literaturës shqipe...



20 Intervistë me dr. Shyqri Haxha



25 Loja e shumëfishtë me kufijtë...



38 Ankthi i tërmeteve përfshin...



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET,
KULTURË, ARSIM, ETIKË
Viti V / Nr. 40
19 mars 2010 - 19 prill 2010

Botues

Zëri Ynë

O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor

Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës

Avni AVDIU

avni.avdiu@gmail.com

Redaktor i kulturës

Flamur MALOKU

flamurmaloku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika

Osman D. GASHI

osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore

Mimoza SINANI

e-mail:

revistapaqja@gmail.com

revistapaqja@hotmail.com

http://www.zeri-yne.org

Adresa:

Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14,
përballë teatrit Dodona,
Prishtinë, Kosovë

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!

Portreti i muajit

Pavarësia - e pakthyeshme



Ministri i jashtëm francez dhe ish-përfaqësuesi i parë i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në Kosovë, Bernard Kouchner, qëndroi në Prishtinë tri ditë, pasi që kryeqytetin e Kosovës e vizitoi diplomati amerikan Stjuard Xhons. “Dua t’u them në emër të Francës se pavarësia juaj nuk është në pikëpyetje. Kjo është lëvizje e historisë. Askush dhe asgjë nuk mund ta ndryshojë këtë lëvizje të historisë dhe çdonjëri duhet ta pranojë”. “Derisa në Kosovë nuk do të ketë pajtim të plotë, derisa Kosova nuk do t’i bashkohet Evropës, diçka do t’i mungojë familjes evropiane”. Kështu ka deklaruar kryediplomati francez, Bernard Kouchner, në një seancë solemne të Kuvendit të Kosovës, të organizuar me rastin e vizitës së tij në Kosovës. Kouchner, duke aluduar për Serbinë, ka thënë se askush nuk duhet të

mendojë se mund të hyjë në Evropë duke e penguar fqinjën e vet. “Do të jetë iluzion të mendojmë që mund të ecim drejt Evropës duke penguar vendin fqinj të ecë edhe ai gjithashtu, ngase evropianët nuk e pranojnë këtë, prandaj dialogu mes vendeve tuaja është një kusht paraprak për të arritur integritetin evropian”, - ka thënë Kouchner. Pajtimi, sipas tij, është i domosdoshëm. Ai tha se pavarësia e Kosovës nuk është vetëm përfundimi i një pune të madhe, por fillimi i një rruge për Kosovën dhe Ballkanin. “Nuk jeni vetëm në këtë rrugë. Kosova mund të besojë në miqësinë e Francës dhe do të bëjë gjithçka që të jap mundësi t’i jepni jetë lirisë suaj. Për dy vjet keni bërë shumë. Pas viteve të luftës dhe vuajtjeve, pas viteve të euforisë, ka ardhur koha e vendosjes, e përgjegjësive afatgjate”.

Kouchner, gjatë vizitës në Kosovë, është pritur në takime të veçanta nga

kryetari i Parlamentit, Jakup Krasniqi, presidenti Fatmir Sejdiu, kryeministri Hashim Thaçi dhe ministri i Jashtëm, Skender Hyseni.

Kouchner, gjatë qëndrimit të tij në Graçanicë, e quajti “budalla” gazetarin serb të “Zërit të Amerikës”, Budimir Niniç, pasi i bëri një pyetje provokative lidhur me trafikimin e organeve në Kosovë, menjëherë pas luftime. I pyetur në fund të vizitës së tij në Kosovë lidhur me trafikimin e organeve njerëzore, Kouchner u përgjigj se nuk dinte asgjë për këtë. “Ti je i sëmurë. Je i çmendur, mos fol marrëzira të tilla”, - i tha Kouchner gazetarit duke mos besuar se ai mund të bënte një pyetje aq pa lidhje. “Ç’është kjo shtëpi e verdhë? Pse e verdhë? Zotëri, ju duhet të shkoni të kontrolloheni te një mjek”, - i tha shefi i diplomacisë franceze gazetarit serb. ■

BIOGRAFIA: Bernard Kouchner ka lindur në vitin 1939 në Avignon, Francë. Është politikan francez, që ka pasur postin e kryeadministratorit të Kosovës (PSSP), i emëruar nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Kofi Anan për periudhën: 1999-2000. Ka qenë bashkëthemelues i organizatës "Doctors Without Borders" - "Mjekë pa kufi". Ai ka qenë edhe anëtar i Partisë Komuniste Franceze, por u përjashtua në vitin 1966. Ka qenë dy herë ministër i shëndetësisë në Francë. Tash ushtron postin e ministrit të jashtëm.



Ballkanoskopia

Bashkëpunimi rajonal “euro-integrues” po e izolon Kosovën

Serbia, në një rën anë, luan rolin e shtetit që synon të arrijë standardet europiane nëpërmjet bashkëpunimit rajonal, ndërsa, në anën tjetër, vazhdon politikën piromane, duke e mbajtur një pjesë të Ballkanit Perëndimor si vrimë të zeze të kontinentit. Nëse Kosova është “pjesa më e errët e Europës”, sikundër ka thënë ministri i jashtëm i Serbisë, ajo është e tillë për shkak se Serbia është sponsorizuese e terrorizmit shtetëror në truallin e Kosovës



Dr. Milazim KRASNIQI

Vizita zyrtare që i bëri Serbisë ministri i jashtëm i Shqipërisë, Ilir Meta, inkuadrohet në aktivitetet intensive që kanë ndodhur në dy muajt e fundit, në kuadër të përpjekjeve të diplomacinë serbe për ta çuar përpara integrimin e saj në Bashkimin Europian. Vizita e Ilir Metës do të interpretohet si një arritje e re e Serbisë në rrugën e saj të integritimit europian, në të cilën duhet të eliminohen kontestet me fqinjët, përkatësisht duhet të thellohet bashkëpunimi rajonal. Kryetari i Komisionit Europian, Hoze Manuel Baroso, pati deklaruar gjatë takimit me kryeministrin e Serbisë, Mirko Cvetkoviçin, se “Marrëdhëniet e mira me fqinjët dhe zgjidhja e çështjeve bilaterale janë elemente kyçe të eurointegritimit”. Edhe Herman van Rompui i pati rekomanduar Cvetkoviçit: “Shpresoj se Serbia do të ketë ndikim pozitiv për stabilitetin e rajonit. Bashkëpunimi i mirë rajonal është i rëndësishëm për BE. Njëherësh, kjo është një çështje themelore në proceset e stabilizim-asocimit.”

Vetëm dy javë pas vizitës të Cvetkoviçit në Bruksel dhe rekomandimeve që ia dhanë në formën e recetës Baroso e Rampui, ndodhi vizita e Metës në Serbi, si një përmbushje e “elementeve kyçe të eurointegritimit” nga ana e Beogradit zyrtar. Po të mos ishte obligativ respektimi i kësaj recete, zor se ministrin e jashtëm të Shqipërisë do ta rrethonte gjithë ajo pritje miqësore në Beograd, e cila në disa raste dukej si pritje “vël-

lazërore” e kohëve parainformbyroiste të marrëdhënies të drejtuesve komunistë të të dyja vendeve. Pjesëmarrja e Metës në nderimet e ish-kryeministrit serb, Zoran Gjingjiçit, në shtatëvjetorin e vrasjes së tij, takimi me zonjën Ruzhica Gjingjiç dhe akordimi i bashkëpunimit me fondacionin që ajo drejton, ia dha Metës tretmanin e “njeriut të shtëpisë” në sytë e qeveritarëve serbë. Në fakt, Ilir Meta ka pasur raporte të mira me ish-kryeministrin Gjingjiç, por inkuadrimi i tij në ceremonitë shtetërore e familjare, ka ndodhur vetëm kësaj here, e jo edhe në vitet e shkuara, gjë që lë të nënkuptohet se është bërë për nevojat e vetë qeverisë serbe.

Edhe vizita e Metës në Luginën e Preshevës dhe tonet optimiste për të drejtat e shqiptarëve që u shqiptuan në takime me udhëheqësit shqiptarë të atjeshëm, inkuadrohen në idilin e ri të marrëdhënies “fqinjësore”, për të cilën Beogradi ka shumë nevojë. Jashtë këtij konceptimi, Shqipëria e Serbia tashmë

nuk janë fare shtete fqinje, sepse askund nuk kufizohen njëra me tjetrën. Rrjedhimisht, në kushte normale përkujdesja për shqiptarët në Luginën e Preshevës do të duhej t’i takonte Kosovës, për shkak të afërsisë gjeografike dhe lidhjeve të shumëfishta të saj me Luginën e Preshevës. Por, këtë rol Kosova nuk është në gjendje ta luajë për shkak të marrëdhënies skajshmërisht të këqija me Serbinë. Prandaj, edhe është mirë që ka ndodhur angazhimi i Tiranës zyrtare për përmirësimin e pozitës së shqiptarëve në Luginën e Preshevës dhe kjo duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen. Por, është shumë i rëndësishëm konteksti i angazhimit. A po ndodh ai angazhim për nevojat e Serbisë, që t’i përmbushë “elementet kyçe të eurointegritimit”, apo do të ndodhë për shkak të rolit që dëshiron të luajë Shqipëria si shtet amë edhe i shqiptarëve të Luginës së Preshevës? Qoftë dhe për ta kompensuar detyrën, të cilën Kosova nuk po arrin ta kryejë ndaj tyre.



Sidoqoftë, normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë e Serbisë, qoftë kjo dhe vetëm për nevojat e Serbisë në rrugën e saj të eurointegrimeve, mund të sjellë efekte pozitive në rajon. Mund të kontribuojë për shtendosjen e marrëdhënieve serbo-shqiptare, gjë që është kusht për çuarjen përpara të procesit të integrimeve euro-atlantike të të dyja kombeve. Por, ky kontribut mund të realizohet vetëm nëse këto marrëdhënie të reja ndërmjet Serbisë e Shqipërisë nuk bëhen përjashtuese ndaj prezencës së Republikës së Kosovës në bashkëpunimin rajonal dhe në përmirësimin e marrëdhënieve fqinjësore. Në të kundërt, pra nëse Kosova përjashtohet, ose vetëm nëse minimizohet rëndësia e saj në kuadër të këtyre marrëdhënieve, komplikimet mund të jenë afatgjata. Në fakt, Serbia është shumë e interesuar që ta shndërrojë Kosovën në një konflikt të ngrirë dhe ta përjashtojë tërësisht nga bashkëpunimi rajonal. Deklaratat e ministrit serb, Vuk Jeremiçiqit, se Serbia në rast se do të detyrohej të zgjidhte ndërmjet Kosovës dhe integritimit evropian, do të zgjidhte Kosovën, janë në funksion të kushtëzimit të Bashkimit Evropian, për ta lënë anash Kosovën. Dhe veçmas deklarata e tij e para do kohëve në mbledhjen e Këshillit të OKB-së për të drejtat e njeriut në Gjenevë, me ç'rast ai tha se "Kosova është pa dyshim pjesa më e errët e Europës", e bën të qartë këtë strategji të fshehtë për ngrirjen e konfliktit. Nëse Kosova do të kualifikohet si "pjesa më e errët e Europës", ajo do të mund të mbahej në karantinë. Nëse arrin që ta shndërrojë në një konflikt të ngrirë, pa u implikuar në këtë mes shtetet e tjera fqinje dhe veçmas Shqipëria, Serbia do të integrohej në Bash-

kimin Evropian pa marrë obligime që të respektojë statusin e Kosovës si shtet i pavarur, sepse në atë rast do të ishte një konflikt i ngrirë. Ndërsa, mbetja e Kosovës si konflikt i ngrirë, do ta linte jashtë procesit të integrimeve dhe pas disa viteve të kolapsit të saj, do të provohej të hapej një proces i ri negociatash për statusin e saj. Ai proces do të ishte i shoqëruar me ofertën/shantazhin ndaj Kosovës, që të bëjë koncesione në rast se dëshiron të integrohet në Bashkimin Evropian. Sot për sot nuk mund të dihet saktësisht se cilat kërkesa do të ishin në tavolinën e ofertës/ shantazhit, por mund të jetë që do të ishte çështja e veriut të Kosovës. Ndërsa, çështja e veriut të Kosovës, e shpëputur nga çështja e Luginës së Preshevës, shumë më lehtë do të mund të bëhej pre e kalkulimeve për ndarjen e Kosovës. Prandaj, edhe tonet e reja në marrëdhëniet e Serbisë me Shqipërinë, njëherë nga objektivat e kanë shpëputjen e çfarëdo lidhjeje në mes të Luginës së Preshevës dhe zhvillimeve të tashme e të ardhshme në Kosovë. Pra, edhe nga kjo anë, mund të pandehet se ka elemente të një defaktorizimi dhe izolimi të ri të Kosovës edhe brenda vetë Ballkanit Perëndimor.

Një gjë është e sigurt: trendet e tilla izoluese dhe injoruese ndaj Kosovës do të rriten edhe më shumë në të ardhmen, nëse vetë Kosova nuk e ndryshon dinamikën e vet të veprimit politik e shtetëror. Nëse nuk ndodh një ofensivë e fuqishme e fuqizimit të brendshëm, me anën e një partneriteti të ri me bashkatdhetarët që janë të shpërndarë në Europë, në Turqi e në Shtetet e Bashkuara, varfëria e papunësia do të rriten, e kjo do ta minojë stabilitetin e shtetit të ri. Nga ana tjetër, nëse qeveria nuk i shpall

luftë të fortë korrupsionit dhe nëse nuk e fiton atë luftë, imazhi i shtetit të ri do të zbehet e do të hapet mundësia e trajtimit të Kosovës si shtet i dështuar, për të cilin duhet të kërkohen opsione të reja.

Të gjithë ata që nuk duan të shohin realitetin në sy dhe që nuk duan të bëjnë ndryshime, mund të thonë se këto janë "teori të konspiracionit". Por, në të vërtetë, këto janë observime kritike të zhvillimit të ngjarjeve brenda një logjike politike dhe historike, e cila është e qartë. Ata që nuk i shohin detajet, që nuk i vërejnë nuancat, që nuk arrijnë të krijojnë mozaikun dhe ta kuptojnë përmbajtjen e tij, mbeten indiferentë ndaj këtyre zhvillimeve. Fatkeqësisht ata janë shumicë në Kosovë. Dhe ne jemi kështu si jemi, për shkak të tyre. Edhe sulmet më të fundit në pikën kufitare 31 në veri të Kosovës, vetëm një ditë pas vizitës së Ilir Metës në Serbi, e cila u shpall shumë e suksesshme për bashkëpunimin rajonal, inkuadrohen në këtë mozaik, në të cilin me pak përpjekje intelektuale mund të shihet qartë loja dyfytërshe e Serbisë. Serbia, në njëherë anë, luan rolin e shtetit që synon të arrijë standardet europiane nëpërmjet bashkëpunimit rajonal, ndërsa, në anën tjetër, vazhdon politikën piromane, duke e mbajtur një pjesë të Ballkanit Perëndimor si vrimë të zezë të kontinentit. Nëse Kosova është "pjesa më e errët e Europës", sikundër ka thënë ministri i jashtëm i Serbisë, ajo është e tillë për shkak se Serbia është sponsorizuese e terrorizmit shtetëror në truallin e Kosovës. Por, nëse Serbia po del e palagur nga kjo lojë dyfytërshe, ndërsa Kosova po zhytet në izolim, nuk është faji i vetëm i Serbisë, por edhe i barosove, i rampuive e metëve, që po i mbyllin sytë para këtij konspiracioni kundër Kosovës. ■





Kuvendi i Republikës së Kosovës ka diskutuar për Strategjinë e propozuar nga Qeveria e Kosovës dhe Zyra Civile Ndërkombëtare (ICO)

Kuvendi miratoi deklaratë politike



Muhamet JAHIRI

Kuvendi i Kosovës ka miratuar një deklaratë politike, me të cilën e fton qeverinë dhe të gjitha institucionet të shtojnë përkushtimin për zbatimin e Kushtetutës dhe ruajtjen e tërësisë territoriale të Kosovës. Miratimi i kësaj deklarate pasoi debatin në lidhje me zbatimin e Kushtetutës dhe praninë e strukturave të pushtetit të Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës.

Në deklaratën e Kuvendit të Kosovës është ritheksuar domosdoshmëria e zbatimit të Kushtetutës në gjithë territorin e Kosovës, duke garantuar ruajtjen e tërësisë territoriale dhe pacenueshmërinë e kufijve, të pranuar ndërkombëtarisht.

Miratimi i kësaj deklarate është shoqëruar me debatin në lidhje me zbatimin e Kushtetutës dhe praninë e strukturave të pushtetit të Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës, i thirrur sipas një kërkesë të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Propozuesi i kësaj pike, kryetari i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, Nexhat Daci, në fillim të seancës kërkoi miratimin e një rezolute, e cila do ta obligonte qeverinë për shtrirjen e pushtetit në gjithë territorin e Kosovës.

“Mendoj se duhet të jetë një rezolute, e cila e obligon qeverisjen e vendit t’i ushtrojë obligimet e veta kushtetuese

në shtetin e Kosovës, me integritet dhe sovranitet të pranuar nga 65 shtete të botës”, - ka thënë Nexhat Daci në emër të LDD-së.

Ndërkaq në emër të qeverisë për strategjinë e veriut, para kuvendit ka folur vetë kryeministri Hashim Thaçi, i cili ka prezantuar planet e parapara për shtrirjen e pushtetit në veri, përmes zbatimit të Strategjisë për integrimin e kësaj pjese.

Ai e siguroi kuvendin se qeveria është e gatshme t’i japë fund, siç tha kryeministri, kaosit 10-vjeçar në veri. Thaçi përjashtoi edhe njëherë përdorimin e dhunës si mjet për zgjidhjen e problemeve ekzistuese në veri.

“Qeveria është e vendosur përfundimisht për shtrirje institucionale dhe kujdes institucional në veri”, - ka deklaruar Thaçi, duke shtuar se: “Strategjia për veriun është e bazuar në katër fusha kryesore: fuqizimi i sundimit të ligjit, decentralizimi ose reformimi i pushtetit lokal dhe themelimi i komunës së Mitrovicës së veriut, adresimi i qeverisjes në tri komunat e veriut, në Leposaviq, Zubin Potok e Zveçan dhe përmirësimi i situatës socio-ekonomike në këtë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës”.

Ndryshe, Kuvendi i Kosovës, përmes kësaj deklarate, shpreh përkushtimin për të siguruar që të gjithë shtetasit e Kosovës të gëzojnë mbrojtjen e shtetit ligjor. Kuvendi mirëpret përkrahjen e Bashkimit Evropian e të bashkësisë ndërkombëtare për të bërë të mundur që të gjithë qytetarët të kenë përfaqësim demokratik në pushtetin qendror dhe

lokal, të përfitojnë nga shërbimet e investimet dhe të kenë qasje në drejtësi.

Krijohen 6 grupe punuese për zbatimin e Strategjisë

Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar vendimin për krijimin e gjashtë grupeve punuese për zbatimin e Strategjisë për veriun e Kosovës.

Me synimin e implementimit të Strategjisë për veriun e Kosovës, Qeveria ka aprovuar vendimin për themelimin e gjashtë grupeve punuese: Grupi punues për sundimin e ligjit; Grupi punues për kthimin, pajtimin dhe iniciimin e dialogut ndëretnik; Grupi punues për zhvillimin socio-ekonomik të rajonit; Grupi punues për zhvillimin e reformës së pushtetit lokal në këtë pjesë të vendit; Grupi punues për ngritjen e shërbimeve publike për qytetarët e kësaj pjese të vendit; dhe Grupi punues për komunikimin.

Kryeministri Thaçi ka theksuar se në përbërjen e këtyre grupeve do të përfshihet edhe opozita dhe shoqëria civile. “Sipas rrethanave të reja, gjatë implementimit të strategjisë, do të themelohen edhe grupe të reja punuese, gjithnjë në funksion të implementimit të plotë të strategjisë. Puna e përgjithshme në implementimin e strategjisë dhe angazhimet do të koordinohen me të gjitha institucionet, në të gjitha nivelet dhe me institucionet ndërkombëtare që janë në Kosovë”, - ka thënë ai.

Qeveria ka aprovuar vendimin për fillimin e hartimit të Strategjisë Nacionale dhe Planit të Veprimit për Siguri në Bashkësi, si dhe ka aprovuar projektligjin për energjinë elektrike. ■

Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë mendime të ndryshme sa i përket strategjisë së veriut, të

Strategjia inkurajuese, por e v



Muhamet JAHIRI

Përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës dhe Zyrës Civile Ndërkombëtare kanë projektuar një dokument të quajtur “Strategjia për Veriun e Kosovës”, përmes të cilit pritet shtrirja e pushtetit të institucioneve të vendit edhe në atë pjesë. Por, pavarësisht kësaj, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë qëndrime të ndryshme për këtë strategji dhe për mundësinë e shtrirjes së pushtetit në pjesën veriore të Kosovës.

Ramosaj: Strategjia për veriun, inkurajuese

Deputeti Berim Ramosaj, i cili vjen nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), ka thënë se e mbështet projektin e qeverisë për veriun e Kosovës, mirëpo ka dyshime për zbatimin e tij në terren.

“Ne e mbështesim si projekt dhe mund të themi se shihet se është inkurajues, mirëpo të shohim se sa do të mund të implementohet ai projekt. E them këtë duke marr parasysh se vullneti për të bashkëpunuar, nga ana e palës serbe, është i ulët”, - ka thënë Ramosaj, duke shtuar se deri me tani



Ibrahim Makolli

kanë munguar veprimet konkrete, sepse ka pasur vetëm disa iniciativa “ad hoc”.

Ramosaj ka deklaruar se ai që iu është prezantuar deputetëve si dokument është mjaft inkurajues dhe gjithëpërfshirës.

E kemi parë si projekt dhe mund të them se është inkurajues në kuptimin e pjesëmarrjes të të gjitha palëve në këtë projekt. Kjo është ajo ana e mirë. Ky dokument inkurajon bashkëpunimin e të gjitha komuniteteve dhe ai nuk është një projekt që mbështetet shumë në mekanizmat shtetërorë dhe të ligjit, por më tepër mbështetet në vullnetin e mirë të mundësive për motivim nga të gjithë”, - ka deklaruar ai.

Deputeti Ramosaj, nuk beson se ky projekt mund t’i japë efektet e tij shumë shpejt, pasi që, sipas tij, komuniteti serb i nxitur nga Beogradi nuk do të jetë konstruktiv dhe do ta pengojë zhvillimin e strategjisë.

“Por duke marrë parasysh se në një pjesë të madhe të veriut të vendit sundojnë strukturat paralele dhe ato kriminele, nuk besoj se do ta pranojnë dhe do të jenë pjesë e projektit”, - është shprehur deputeti Berim Ramosaj.

Makolli: Mospjesëmarrja e KFOR-it dhe EULEX-it – mangësi e madhe

Edhe deputeti nga radhët e Aleancës Kosova e Re (AKR), Ibrahim Makolli ka thënë se e mbështet dokumentin për shtrirjen e pushtetit në veriun e Kosovës. Makolli ka deklaruar se mangësi e këtij dokumenti është mospërfshirja në strategji e KFOR-it dhe e misionit evropian EULEX.

“Mund të them se ajo që i mungon dokumentit është mungesa e mekanizmave të qartë për të implementuar këtë strategji. Problem tjetër, i cili mund të shkaktojë defekt relativisht të madh, është edhe mosgatishmëria e KFOR-it dhe EULEX-it që të jenë pjesë e këtij projekti, mekanizma pa të cilat është vështirë të imagjinohet implementimi i saj duke pasur parasysh mandatin dhe përgjegjësinë e madhe që ka KFOR-i, por edhe EULEX në fushën e drejtë-



Berim Ramosaj

propozuar nga Qeveria e Kosovës dhe Zyra Civile Ndërkombëtare (ICO)

Vështirë për t'u implementuar

sisë”, - ka thënë Makolli, duke shtuar se pavarësisht kësaj nuk duhet prejudikuar, sepse nëse ekziston një vullnet i të gjitha institucioneve të vendit, atëherë mund të themi se ka mundësi që të fillojë implementimi i kësaj strategjie.

Deputeti Makolli e ka kritikuar qeverinë për faktin se ajo nuk i ka ftuar edhe partitë opozitare, për krijimin e strategjisë.

“Tani duhet të presim se si do të jetë fillimi i saj, edhe pse nuk është një fillim i mirë, sepse është përjashtuar opozita. Përpos deklaratave mediale të qeverisë, kjo e fundit nuk ka bërë asgjë konkrete, duke përjashtuar opozitën”, - ka pohuar Ibrahim Makolli.

Tali: Strategji naive që ka për qëllim vetëm përmbushjen e normës

Ndërkaq për deputetin e pavarur Driton Tali, ky dokument i propozuar nga Qeveria e Kosovës është qesharak.

“Nga përmbledhja që na është ofruar mund të them se ka qenë shumë gjithëpërfshirëse dhe kur e kam lexuar një pjesë ku thuhet se presim bashkëpunim nga Beogradi, kjo gjë për mua ka qenë shumë qesharake”, - ka thënë Tali, duke shtuar në këtë kontekst se: “Kjo fjalë e përdorur në atë përmbledhje është qesharake për mua, duke pasur parasysh se shteti serb mundohet ta pengojë dhe të shkatërrojë Kosova kudo që mundet”, - u shpreh ai.

Sipas tij, kjo strategji më tepër mund të cilësohet naive dhe është projektuar për përmbushjen e normës nga ana e qeverisë dhe e ndërkombëtarëve.

“Kjo është një strategji naive, të cilën ndërkombëtarët dhe vendorët e kanë bërë për ta përmbushur normën”, - është shprehur Tali, duke shtuar se nëse mendohet që kjo strategji do të funksionojë me ndihmën e Beogradit, një gjë e tillë do të ishte fyese për qytetarët e Kosovës.



Driton Tali

“Nëse për implementimin e saj pritet bashkëpunim nga Serbia, kjo gjë nuk do të ketë suksese dhe do të ishte fyese për qytetarët e Kosovës”, - ka shtuar në fund deputeti i pavarur Driton Tali. ■



Nga pjesa veriore e Mitrovicës

Jeta në dysh e banorëve të Mitrovicës

Një autobus, që paguhet nga Komuna e Mitrovicës, është mënyra e vetme e udhëtimit për banorët e lagjes veriore “Kodra e Minatorëve” për në jug të qytetit. Banorët thonë se janë të kufizuar në lëvizjet e tyre dhe, po ashtu, thonë se nuk ndihen të sigurt të udhëtojnë në këmbë, edhe pse lagja e tyre gjendet vetëm një kilometër në veri të qytetit, ku banojnë kryesisht pjesëtarë të komunitetit serb

Alban ZENELI

Besnik Pllanës, 24 vjeçar nga Lagja “Kodra e Minatorëve” në veri të Mitrovicës, në orën 18:00 në mbrëmje i duhet të ndahet nga shokët e tij që shkojnë të shohin lojë basketbolli, sepse në këtë kohë i duhet të zërë “autobusin e fundit” për në lagjen e tij, që është e rrethuar nga banorët serb të kësaj pjese. Ai thotë se autobusi, i cili qarkullon çdo tre orë nga kjo lagje për në jug të qytetit, është e vetmja mundësi e udhëtimit për rreth 100 familje të kësaj lagjeje edhe pse rruga nga ura kryesore e lumit Ibër në këtë lagje është vetëm disa minuta udhëtim në këmbë. Besniku thotë se nuk ndihet i sigurt që këtë rrugë ta përshkruajë në këmbë.

“Shokët e mi shkuan të shikojnë lojën e basketbollit në mes të Trepçës dhe Bashkimit, por unë nuk mund të shkoj sepse në orën gjashtë në mbrëmje është udhëtimi i fundit i autobusit për në lagjen time. Nëse nuk e zë këtë autobus nuk mund të shkoj në shtëpi. Vajtja në këmbë është shumë e rrezikshme”, - tre-

gon ai, duke kujtuar disa nga rastet e trazirave në këtë pjesë të Kosovës, ku ka pasur edhe të vrarë e të lënduar.

Besniku thotë se, që nga paslufta, nuk është ndierë kurrë i sigurt në shtëpinë e tij, në lagjen e tij të banuar me shqiptarë, por të rrethuar nga lagjet e tjera me pjesëtarë të komunitetit serb. Jeta në këtë pjesë të Kosovës është duke u bërë çdo ditë e më e vështirë, kur i shtohet edhe numri i të papunëve dhe i rasteve sociale.

“Në lagjen time shumica e banorëve janë të papunë. Ne me këtë autobus, që e paguan komuna, dalim në jug të qytetit që të marrim pak furnizime për familjet”, - thotë Besniku, duke shprehur mllëfin e tij për mungesën e interesimit institucional për këta banorë. Ai thotë se në këtë pjesë nuk është bërë asnjë investim që nga paslufta. Një tjetër banor i kësaj lagjeje, Besim Sylja thotë se problemi i lëvizjes së lirë të banorëve të kësaj lagjeje i ka goditur më së shumti fëmijët, të cilëve iu duhet të presin në rrugë deri në tri orë derisa të vijë koha e qarkullimit të autobusit për në pjesën veriore, më saktësisht në lagjen “Kodra e Minatorëve”.

“Unë e kam djalin në klasën e dytë, në shkollën fillore “Muharrem Bekteshi” dhe mësimi i tij përfundon zakonisht në orën 15 e 30. Më duhet që, së bashku me të, të shëtitim nëpër qytet deri në ora 18:00, kur të vijë autobusi”, - thotë ai. Përveç lagjes “Kodra e Minatorëve”, në pjesën veriore të Mitrovicës, ka edhe disa lagje të tjera me banorë shqiptarë që kanë probleme me qarkullimin. Në lagjen e quajtur “Tre Rrokaqiejt”, banorët nuk mund të shkojnë me automjetet e tyre, por duhet të kalojnë nëpër një urë të ngushtë mbi lumin Ibër që lidh lagjen e tyre me pjesën jugore të qytetit, ndërsa automjetet e tyre mbesin në pjesën jugore të qytetit. Qyteti i Mitrovicës, që nga paslufta, ka qenë vater e krizave të ndryshme mes serbëve dhe shqiptarëve. Si pasojë e dhunës ndaj tyre, shumica e banorëve shqiptarë të pjesës veriore të këtij qyteti i kanë lënë shtëpitë e tyre. Nën masa të rrepta sigurie, vitin e kaluar, në lagjen “Kroi i Vitakut” në veri të këtij qyteti, kishin filluar punimet për rindërtimin e shtëpive të shqiptarëve të shkatërruara nga lufta, edhe pse një gjë e tillë ishte kundërshtuar nga banorët serbë të kësaj ane. ■



Besnik Pllana duke pritur për në lagjen e tij.



Shkenca e ndarë në dysh

Të vetmet fakultete në Kosovë, që nuk iu kthyen kurrë më objekteve të veta që nga shpërngulja e tyre prej ish-regjimit serb, janë Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë dhe ai i Shkencave të Aplikuara në Mitrovicë. Këto fakultete, ende ndodhen në objektin e ish-Fabrikës së Akumulatorëve, të cilin e kishin adaptuar për mësim disa vjet më parë. Studentët, si dhe personeli akademik, ankohen për kushte të rënda të punës, por objekti i tyre ndodhet në pjesën veriore të Kosovës, ku ata nuk mund të shkojnë.

Drita VITIA

Në pjesën më të harruar të Kosovës, në Mitrovicë, duket se janë harruar edhe fakultetet të cilat ndodhen këtu, e që konsiderohet të jenë fakultetet më me rëndësi për zhvillimin e vendit. Një gjë të tillë e thonë edhe vetë qytetarët e Mitrovicës, pasi që ata ndihen të lënë anash edhe në aspektin e edukimit. “Përkundër dëshirës së madhe të studentëve dhe personelit të Fakultetit për t’u kthyer në objektet zyrtare që gjenden në veriun e Mitrovicës, Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë (FXM), ende vazhdon të punojë në lokale të përkohshme, sikurse edhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në këtë qytet,” - kështu e fillon rrëfimin dekani i Fakultetit të Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë, Izet Zeqiri. Ai shprehet i shqetësuar për gjendjen, në të cilën ndodhen këto njësi akademike të Universitetit të Prishtinës, të cilat tash e disa vjet e zhvillojnë veprimtarinë në lokalet e ish-ndërtesës së administratës së Fabrikës së Akumulatorëve, në kuadër të Kompleksit Industrial Trepça në Mitrovicë. “Jemi të vetmet fakultete që nuk u kthyem në objektet prej nga u përzumë

në vitin 1991 nga regjimi i atëhershëm serb”, - thekson Zeqiri.

Studime në kushte të improvizuara

Gjendja e objektit ku ndodhet Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë dhe ai i Shkencave të Aplikuara në Mitrovicë, edhe pse është e adaptuar për mësim, nuk mund të thuhet se është shumë e mirë. Dekani i fakultetit të Xehetarisë dhe Metalurgjisë, Izet Zeqiri, shprehet se do të ishte me interes shumë të madh që të adaptohet edhe ndonjë aneks-sallë mësimi ose ndonjë amfiteatër, pasi që numri i studentëve për të studiuar në drejtimet, të cilat i ofrojnë fakultetet, prej pasluftës e këndej është çdo herë në rritje. “Megjithëse jemi si të lënë anash ose edhe të harruar në çdo aspekt, ne, në të dy fakultetet, jemi çdoherë në krijim të kushteve sa më të mira për studentët, të cilët orientohen në drejtimet e këtyre fakulteteve, duke adaptuar objektet e Fabrikës së Akumulatorëve”, - u shpreh dekani Zeqiri. Ai theksoi se, në kuadër të krijimit të kushteve optimale për punë, fakulteti është duke bërë përpjekje së bashku me rektoratin e UP-së që të sigurojë parcelë

tokësore nga Kuvendi Komunal i Mitrovicës për ndërtimin e objektit të ri për FXM, FSHTA dhe objekteve të tjera përcjellëse. Me realizimin e këtij projekti, dekani Zeqiri beson se studentët dhe personeli akademik do të kenë hapësira të mjaftueshme për zhvillimin e fushë-veprimtarisë së fakulteteve si, salla mësimi dhe amfiteatro, biblioteka dhe salla leximi, hapësira për laboratorët ekzistues, kabinete për personelin akademik, konvikte dhe mensa për studentë, hapësira për rekreacion sportiv dhe aktivitete të tjera të lira.

Studentët e pakënaqur me gjendjen e fakulteteve

Megjithatë, në Fakultetin e Xehetarisë dhe Metalurgjisë, të gjitha drejtimet janë të lidhura ngushtë me laboratorët. Tani për tani, të gjitha degët në këtë fakultet si: Xehetari, Gjeologji, Metalurgji dhe Materiale, Teknologji Kimike dhe Mjedisore si dhe ajo Ushqimore, janë të pajisur mirë me laboratorë, mirëpo, studentët ankohen se nuk ka hapësirë të mjaftuar për punë për të gjithë studentët. Albert Kopriva, student në vitin e parë në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara në Mitrovicë, thotë se objekti

ku ndodhen fakultetet, nuk i plotëson as kushtet minimale për studim. Sipas tij, vetëm në vitin e parë në Degën e Informatikës Inxhinierike, ndodhen rreth dyqind studentë, të cilëve nuk u vjen as radha të shfrytëzojnë kompjuterët. Po ashtu, edhe Blerina Mazhiqi, studente e vitit të tretë në të njëjtin fakultet, tha se nuk kanë kushte të përshtatshme për studim. Sipas saj, edhe pse në shumicën e lëndëve studimore do të duhej të kishte punë praktike, ligjëratat zhvillohen vetëm në teori dhe studentët duhet të ndahen në disa grupe për shkak të sallave shumë të vogla mësimore.

Studime në tre nivele

Në Fakultetin e Xehetarisë dhe Metalurgjisë, edhe pse ka një staf shumë të kualifikuar dhe me përvojë të gjatë pune, studentët ankohen se nuk mësojnë shumë punë praktike për të qenë të gatshëm për punë. Studentëve të këtij fakulteti, pas diplomimit, ju duhet edhe një përvojë disamuajshe në mënyrë që të mund të punësohen si profesionistë. Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë, sikurse në të kaluarën, për praktikën e studentëve ka vazhduar bashkëpunimin me industrinë e Kosovës, me Minierat e Trepçës në tërësi, me Korporatën Energjetike të Kosovës, me Fabrikën INKOS, si dhe me kompani të tjera gjeo-minerale. Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë, tani për tani, numëron rreth tetëqind studentë në studimet themelore-bachelor, rreth dyqind në ato postdiplomike-master, si dhe njëzet studentë në studimet pasuniversitare (PhD).

2 fakultete me probleme të njëjta

Ndërkohë, probleme gati të njëjta kanë edhe studiuesit e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara në qytetin e Mitrovicës, sepse ky është fakulteti i dytë, i cili ndodhet në të njëjtin objekt të improvizuar, sikurse ai i Xehetarisë dhe Metalurgjisë. Mirëpo, sipas dekanit të këtij fakulteti, Avdi Salihu, për të paraqitur gjendjen e këtij fakulteti, duhet të analizohet kaluara, e tashmja dhe kushtet për të vazhduar në të ardhmen. "Ky institucion është themeluar në vitin 1961, si Shkollë e Lartë me dy drejtime. Ai ka dhënë një kontribut të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës në atë kohë. Jemi dy fakultete në Uni-

versitetin e Prishtinës, që akoma e vazhdojmë veprimtarinë jashtë objekteve. Kemi ndërruar shumë lokale, që nuk kanë qenë të përshtatshme, deri në vitin 2004. Tani gjendemi në kompleksin e 'Trepçës', - thekson dekan i këtij fakulteti, Avdi Salihu. Ndërkohë, sipas tij, vetë fakti se fakulteti ndodhet në ndërtesën e kompleksit Trepça, bën që personeli akademik dhe studentët e dy fakulteteve të jenë pjesë aktive e proceseve dhe rrjedhave politike që akoma nuk kanë përfunduar në Mitrovicë.

Studime të rregullta në kushte të vështira

Me gjithë kushtet e papërshtatshme objektive, drejtuesit e këtij fakulteti thonë se mësimi zhvillohet me rregull. Sipas tyre, në afro 2 mijë e 200 metra katrorë hapësirë të objektit sa ka kjo ndërtesë, ka hapësirë për kabinete, personel akademik, si dhe pajisje të tjera të nevojshme për studim. "Aktiviteti shkencor bëhet përmes publikimeve shkencore në revistat me recension ndërkombëtar", - shpreh dekan Salihu. "Mirëpo, Fakultetit të Shkencave të Aplikuara në Mitrovicë, pas tetëmbëdhjetë vjetësh pune, i duhet ndërtesa me standarde, konvikte dhe mensa", - thotë dekan. Por, për të zhvilluar studime normale në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara, nevojitet edhe shumë punë. Zyrtarët e fakultetit thonë se në laboratorë duhet të investohet vazhdimisht dhe pa kufizime, pasi që, siç shprehen ata, është koha e ndryshimeve të mëdha të teknologjive, prandaj asnjëherë nuk duhen ndalur investimet në këtë drejtim. Investimi në laboratorë do të thotë të krijosh kushte për shkencë.

Nuk ka hapësirë për laboratorë

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në Mitrovicë, prej vitit 2005 nuk ka pasur mundësi të investojë për laboratorët, pasi që nuk ka pasur hapësira ku t'i vendosë ato. Ndërsa, zhvillimi i punës praktike dhe hulumtuese është planifikuar në tri faza. Vitin e kaluar është bërë inaugurimi i fazës së parë të laboratorëve për Departamentin e Makinerisë Industriale dhe Informatikës Inxhinierike, që ka zgatur tre vite e gjysmë, pra prej vitit 2005. Kjo fazë ka filluar prej makinave CNC, që janë të parat në UP, e deri te teknologjitë CAD/CAM. Këta laboratorë shfrytëzohen për tri qëllime: për ushtrime të studentëve, mundësi për hulumtime nga ana e studentëve e mësimdhënësve dhe mundësi për punë prodhuese. Faza e dytë e punës praktike, nga mesi i vitit 2009, e cila ka të bëjë kryesisht me pajisje hulumtuese, ka filluar me dinamometrat për matjen e forcave gjatë prerjes për katër lloje të makinave dhe aparaturën për matjen e ashpërsisë së sipërfaqeve të përpunuar gjatë prerjes, që matet mbi 50 parametra në 3D, fazë e cila vazhdon ende. Faza e fundit mendohet të jetë objekti me standarde dhe staf edhe më të kompletuar. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në Mitrovicë numëron afër tetëqind studentë aktivë në dy departamente: atë të Makinerisë Industriale dhe Informatikës Inxhinierike. Ndërkohë, këto fakultete, të cilat shfrytëzojnë objekte të ndryshme për mësim, objektin e tyre të posaçëm e kanë në pjesën veriore të Mitrovicës, për shfrytëzimin e të cilit u është privuar e drejta që nga vitet e '90-ta. ■





Dymbëdhjetë vjet më pas

Nderim shtetëror të rënëve për liri

Në dymbëdhjetë vjetorin e rënies së familjes pesëdhjetë anëtarëshe të Jasharajve, në kulat e tyre në Prekaz, si dhe në të gjitha qytetet anekënd Kosovës, janë organizuar aktivitete të ndryshme për të përkujtuar veprën e familjes Jashari, me në krye komandantin legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jasharin.

Drita VITIA

Dymbëdhjetë vjet pas luftës dhe dy vjet pas shpalljes së shtetit të Kosovës, për çka edhe kishin luftuar Jasharajt, këta të fundit janë përkujtuar në mënyrën më madhështore nga i gjithë shteti i Kosovës. Dymbëdhjetë vjet më parë, në Prekaz të Skenderajt, ku ishte zhvilluar një luftë e pabarabartë në mes të një familjeje heroike shqiptare dhe një armate të tërë forcash të armatosura serbe, u vranë më shumë se pesëdhjetë anëtarë të familjes

Jashari, me në krye komandantin legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jasharin. Ndërkohë, pesë marsi ishte dita e parë e manifestimit, tashmë tradicional, “Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, ku edhe kishte ndodhur ngjarja heroike e Jasharajve, dymbëdhjetë vjet më parë. Në ditën e parë të këtij manifestimi, Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, e ka çmuar lart sakrificën dhe çmimin, siç ka thënë ai, që ka dhënë familja Jashari për lirinë e Kosovës. “Dymbëdhjetë vjet më parë, Kosova ka përjetuar njërin prej episodeve më të rënda të historisë së

saj më të re dhe sakrificë e Jasharajve, si dhe sakrificë e shumë familjeve të tjera anembanë Kosovës, ishte një tagër i madh që paguam si popull për liri”, - u shpreh presidenti.

12 vjet më pas, dëshmorëve u ripërtërihen emrat

Në manifestimin tradicional “Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, e cila këtë vit ishte organizuar nën patronazhin e kryeministrit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, është përkujtuar 5 marsi i vitit 1998, kur në Prekaz të Ulët të Drenicës, kishin rënë në altarin e lirisë komandanti legjendar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari, bashkë me babanë, Shabanin dhe me vëllanë, Hamzën. Atë ditë, përveç këtyre tre martirëve, u ishte shuar jeta edhe shumë anëtarëve të tjerë të familjes Jashari.

Në ditën e flijimit unikat të familjes së Jasharajve, ata janë stolisur me kurorën më të praruar të historisë së luftës së gjatë për liri e pavarësi, janë shndërruar në një simbol të pakrahasueshëm të vetëflijimit sublim dhe të sakrificës për të mirën e atdheut, - është thënë në manifestim. Ndërkohë, për të ripërtërirë trungun e familjes Jashari, dymbëdhjetë vjet më pas, të gjithë fëmijët e lindur pas kësaj sakrifice, kanë trashëguar emrat e të flijuarve.

Marsi – historia moderne e lirisë sonë

Ish-luftëtari i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, tashmë kryeministri i vendit, Hashim Thaçi, ka kujtuar luftën e dymbëdhjetë viteve më parë, duke thënë se Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte dhe do të mbetet rezistenca më vigane, më origjinale dhe e papërsëritshme në historinë e çlirimit të një kombi. “Sakrificë e komandantit legjendar, Adem Jashari, është akti sublimues i gjithë përpjekjeve dhe sakrificave shekullore për lirinë e Kosovës. Është kryevepër e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Epopeja e 5, 6 dhe 7 marsit 1998 është historia moderne e lirisë sonë”, - ka thënë Thaçi. Ndryshe, për hir të përkujtimit të martirëve të lirisë, në ditën e parë të manifestimit, më 5 mars, në mesditë, në Sheshin “Skënderbeu”, Garda e Nderit e Forcës së Sigurisë së Kosovës ka nderuar manifestimin me prezencën e personaliteteve të larta

shtetërore, ndërkohë që në mbrëmje është organizuar turneu ndërkombëtar i futbollit të vogël "Adem Jashari" në Pallatin e Rinisë, me pjesëmarrjen e reprezentacioneve dhe ekipeve nga rajoni dhe më gjerë.

Homazhe në Varrezat e Dëshmorëve në Prekaz

Në ditën e dytë të manifestimit tradicional "Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", udhëheqësit e shtetit të Kosovës, kanë bërë homazhe në Kompleksin Memorial të dëshmorëve në Prekaz dhe kanë vizituar familjen Jashari. Me këtë rast është thënë se sakrificat sublime e komandantit Adem Jashari dhe familjes së tij, është dhe do të mbetet udhërrëfyes për të ardhmen. Presidenti i vendit, Fatmir Sejdiu, ka çmuar lartë veprën e Jasharajve për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës dhe ka theksuar se u mbetet institucioneve për ta çuar në vend amanetin e dëshmorëve. Ai ka kujtuar kohën e sulmeve të egra, që janë kryer mbi familjen Jashari dhe ka pohuar se është e paharrueshme gjithë ajo pjesë e përkushtimit të saj për ditët e sotme. Po ashtu, edhe kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se po viziton Prekazin, për të bërë nderime shtetërore për ata që vunë themelet e shtetit të Kosovës. "Jemi këtu për nderime shtetërore, nderime për komandantin Adem Jashari, për familjen Jashari, në emër të lavdisë, të krenarisë, por edhe të përgjegjësive dhe vizionit tonë për të ardhmen, për zhvillimin e shtetit tonë sovran të pavarur

dhe demokratik", ka shtuar ai. Ndërkaq, Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, e ka quajtur Prekazin 'vendi ku janë shpërndarë rrezet e dritës dhe të lirisë së Kosovës.'

Nata e zjarreve përmbyll manifestimin "Epopeja e UÇK-së"

Nisja e ushtarëve me flakadanë nga Kulla e Adem Jasharit nga njëra anë, vashat dhe djemtë me veshje kombëtare, të cilët gjithashtu mbanin në duar flakadanë që simbolizon përkrahjen për UÇK-në, nga ana tjetër, të cilëve u është bashkuar edhe Garda Ceremoniale e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, kanë bërë nderime pranë varrit të komandantit legjendar, Adem Jashari, të premtën mbrëma në "Natën e Zjarreve", natë kjo e cila edhe e ka përmbjllur manifestimin "Epopeja e UÇK-së", me ndezjen e zjarrit nga kulla e improvizuar, që njëherësh simbolizonte shpërthimin e luftës së lavdishme. Dhjetëra mijëra qytetarë, nga të gjitha trojet shqiptare, i janë bashkëngjitur këtij manifestimi, që me "Natën e Zjarreve" përmbjlli epopenë e dhjetë me radhë. Pankartat, mbishkrimet dhe simbolet e tjera shtetërore dhe kombëtare, ku ka dominuar ai, "Bac, u kry" i kanë dhënë ngjyrë të veçantë manifestimit dhe atmosferës në përrugët e qytetit të Skenderajit, të cilat i turmës së njerëzve nga e gjithë hapësirën shqiptare, por edhe diaspora. Këta njerëz, të

cilët nuk i pengonte as shiu i pareshtur, e që imagjinonin se çfarë ka mundur të ndodhte aty para dhjetë viteve, argëtoheshin nga tingujt e muzikës popullore, të cilën e ekzekutonin artistë të njohur të estradës sonë. Programi artistik, i cili ka zgjatur rreth katër orë, ka përmbjllur manifestimin mbarëkombëtar "Epopeja e UÇK-së", që i është kushtuar veprës madhore të komandantit legjendar, Adem Jashari, familjes Jashari dhe dëshmorëve të UÇK-së dhe i cili, kësaj radhe, është mbajtur në vitin më të rëndësishëm në historinë e popullit shqiptar të Kosovës. Ajo çka e ka dalluar manifestimin e sivjetmë nga vitet e kaluara, ishte torta gjigante, 15 metra e gjatë, me logon "Bac, u kry", të cilën e ka prerë Rifat Jashari, vëllai i ikonës së luftës së UÇK-së.

Artistët kanë përkujtuar heroin e Kosovës, Adem Jasharin

Galeria e Arteve e Kosovës, Trupa e Baletit dhe Qendra për zhvillimin e teatrit për fëmijë, të enjten, në organizime të ndara artistike, kanë përkujtuar heroin e kombit, komandantin legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jasharin. Për realizimin e kësaj pjese të programit ishin kujdesur kryesisht të rinjtë, të cilët me idetë e tyre origjinale përfaqësonin brezin e ri të krijuesve të Kosovës. Ata kanë performuar me temë nga vepra e komandantit legjendar, Adem Jashari dhe të dëshmorëve të lirisë. Shtatëmbëdhjetë autorë, njohës të mirë të portreteve, kanë pikturuar figurën e improvizuar të Adem Jasharit, ndërsa këto punime do të





jenë ndër punimet e para që do të ekspozohen në Galeri, në kuadër të kompleksit Adem Jashari në Prekaz. Ndërsa Trupa e Baletit, pas një performance para Teatrit Kombëtar, njeriut të veshur si Adem Jashari, i ka sjellë një skulpturë në të cilën ishte harta e Kosovës. Në anën tjetër, nën organizimin e Qendrës për zhvillimin e teatrit për fëmijë, në platenë e Teatrit Kombëtar është shfaqur shfaqja teatrale për fëmijë e regjisorit David Gothard "Ura". Kjo shfaqje bartte me vete mesazhe paqeje dhe pajtimi ndërmjet popujve. Ndërkohë, qëllimi i kësaj shfaqjeje ka qenë që të jepet ideja e pajtimit dhe që ajo të ketë ndikim pozitiv, në vend se të ketë shfaqje me stereotipe të luftës, dhunës dhe viktimeve.

5, 6 dhe 7 mars

Manifestimi "Epopeja e UÇK-së" ka nisur më 5 mars në Prishtinë, me parakalimin e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës (tashmë FSK) nëpër sheshin "Skënderbeu" dhe "Nëna Terezë". Për të vazhduar të nesërmen me nderimin e dëshmorëve të kombit, të rënë në luftën e fundit për lirinë e Kosovës. Manifestimi i sivjetmë, i cili ka qenë i organizuar nën patronazhin e kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi, është zhvilluar nën moton "Bac, u

kry", sintagmë kjo e cila kishte mbuluar të gjitha sheshet e Kosovës, madje duke u vendosur edhe në shumë bilborda të të gjitha qyteteve të Kosovës.

Adem Jashari është emri më i përmendur dhe heroi më i lavdishëm i historisë më të re të kombit shqiptar. Në periudhën kur shqiptarët e Kosovës kanë përjetuar dhunën më të tmerrshme nga regjimi i Milosheviqit famëkeq, ai me vëllanë e tij, Hamzën, dhe me një grup shokësh kanë rezistuar me armë kundër atij regjimi. Madje, që nga viti 1991, ai ka jetuar në ilegalitet, duke u fshehur në malet e Drenicës dhe, gjatë gjithë asaj periudhe, kishte arritur të mblidhte rreth vetes dhjetëra luftëtarë, të cilët, më 28 nëntor 1997, kishin dalë për herë të parë në skenë nën emblemën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Mirëpo si figura kyçe e luftës, Adem Jashari ishte sulmuar nga forcat serbe dhe pas një rezistence tri ditore kundër mijëra luftëtarëve të Serbisë, Ademi, së bashku me 20 anëtarë të familjes së tij dhe rreth 30 të tjerë të farefisit, kishte rënë heroikisht më 7 mars 1998, në kullat e tij në Prekaz. Ndërkaq, lufta e Jasharëve i dha zemër UÇK-së për ta vazhduar luftën deri në çlirimin e Kosovës. Që atëherë, kulla e Jasharëve

është bërë vendi më i vizituar jo vetëm nga shqiptarët, por edhe nga qytetarët ndërkombëtarë. Në librin e vizitorëve thuhet se Kullën e Adem Jasharit, për dhjetët vjetët e kaluara, e kanë vizituar më shumë se shtatë milionë vizitorë.

Tre ditë manifestimi: "Epopeja e UÇK"-së

Që nga dita e parë e organizimit, 5 mars, kur ka filluar manifestimi tradicional "Epopeja e UÇK-së", në mbarë Kosovën janë organizuar disa aktivitete të ndryshme kulturore-artistike, lidhur me këtë festë. Në ditën e parë, në 5 mars, në Prishtinë ka parakaluar Garda e Nderit e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Manifestimet e epopesë kanë vazhduar ditën e dytë me homazhe të Varrezat e Dëshmorëve në Prekaz, ndërsa në mbrëmje me një Akademi Përkujtimore, ku u përkujtuar të gjithë të rënë të dymbëdhjetë vjet më parë. Po ashtu, aktivitet tjetër lidhur me këtë përvjetor ka qenë edhe turneu ndërkombëtar i futbollit të vogël "Adem Jashari" në Pallatin e Rinisë, ku kanë marrë pjesë reprezentacione dhe ekipe nga rajoni dhe më gjerë. Tre ditët e manifestimit janë përmbyllur me "Natën e Zjarreve", me qindra pjesëmarrës nga e gjithë Kosova edhe më gjerë. ■

Nëpër rrugët e Prishtinës është shtuar numri i të sëmurëve mentalë

Të sëmurit mentalë - rrezik për qytetarët



Fatos SHALA

Numri i personave me sëmundje mentale që bredhin rrugëve të Prishtinës është në rritje. Frekuentimi i tyre nëpër rrugët e kryeqytetit është shpeshtuar shumë kohët e fundit. Madje disa qytetarë kanë pësuar edhe lëndime trupore nga reagimi i tyre. Ata më së shpeshti gjenden në rrugë, por ka raste kur hyjnë edhe nëpër shkolla, kafene dhe lokale të ndryshme, ku mund t'i takosh në çdo kohë. Në të shumtën e rasteve ata janë shumë të papastër, prandaj mund të jenë bartës të infeksioneve, ndërsa institucionet kompetente nuk bëjnë sa duhet në këtë drejtim për largimin e tyre nga rruga, ose për rehabilitimin e tyre. Ky është vlerësimi i shumë qytetarëve prishtinas. Ndryshe, sipas statistikave që posedon Qendra për Punë Sociale në Komunën e Prishtinës, numri i personave me sëmundje mentale është shtuar nga paslufta e kënde.

Institucionet të përkujdesen më tepër

Sipas psikiatrit Agim Selimi, veprimet e njerëzve me sëmundje mentale mund të jenë të paparashikueshme, meqë, sipas tij, edhe institucionet shëndetësore është dashur të gjejnë mundësinë të kujdesen më tepër për këta persona. "Bredhja e personave me sëmundje mentale nëpër rrugë të ndryshme të kryeqytetit paraqet rrezik permanent për qytetarët. Një pjesë të fajit, pse sot nëpër shumë rrugë mund të hasen persona të tillë, e bartin edhe institucionet tona shëndetësore, meqë është dashur që ndaj këtyre personave të kenë një kujdes të shtuar", - u shpreh psikiatri Selimi. Sipas tij, personave me sëmundje mentale u mungojnë kushtet

elementare për jetë; atyre u mungon strehimi, u mungon ushqimi, u mungon veshmbathja e shumë gjëra të tjera, për të cilat institucionet përgjegjëse do të duhej ta shtonin përkujdesjen më të madhe. Kapiten Baki Kelani, shefi i Zyrës për Informim në Policinë e Kosovës, ka deklaruar se derisa punohet për zbatimin e ligjit, zyrtarët policorë që merren me rastet e njerëzve, për të cilët dyshohet se janë me sëmundje mentale, ekziston mundësia e paraqitjes së dhunës. Sipas tij, pas vënies së situatës nën kontroll, kontaktohen organet e Prokurorisë dhe gjykatës kompetente, të cilat varësisht nga rasti i denoncuar (veprimeve të personit të dyshuar) dhe gjendja emocionale dhe psikike e personit marrin vendimin ligjor (p.sh. masat e trajtimit të detyrueshëm). Sipas Kelanit, nuk do të thotë se të gjithë njerëzit e sëmurë mentalisht janë të rrezikshëm, sepse disa mund të paraqesin rrezik vetëm në rrethana dhe kushte të caktuara. Mirëpo, krahas kësaj, ka raste kur policia reagon për ta vënë situatën nën kontroll, gjatë rasteve që kanë të bëjnë me persona me të meta psikike, të cilët tregojnë shenja reagimi të dhunës dhe janë të rrezikshëm për vetveten, zyrtarët policorë ose për qytetarët e tjerë. Po ashtu, ai tha se Policia e Kosovës reagon varësisht nga situatat e paraqitura dhe të denoncuar




nga qytetarët. Sipas tij, reagimi policor u përshtatet rrethanave të incidenteve që raportohen, në përputhje me ligjet e aplikueshme në Kosovë dhe konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Personave me sëmundje mentale u mungojnë kushtet elementare për jetë; atyre u mungon strehimi, u mungon ushqimi, u mungon veshmbathja e shumë të tjera, për të cilat institucionet përgjegjëse do të duhej të kishin një përkujdesje më të madhe.

Qytetarët frikësohen

Për njerëzit me sëmundje mentale do të duhej të kishte një përkujdesje më të mirë nga institucionet që e kanë për obligim përkujdesjen ndaj tyre. Kjo është përshtypja e shumë qytetarëve të kryeqytetit, të cilët thonë se njerëzit me sëmundje mentale, përveç që paraqesin rrezik për qytetarët, paraqesin rrezik edhe për veten e tyre për shkak të jetës që bëjnë në rrugë, duke ndikuar kështu në përkeqësimin e shëndetit të tyre. Sipas qytetarëve, të sëmurët mendore paraqesin rrezik për ta, e sidomos për fëmijët, pasi shpeshherë tentojnë t'i sulmojnë. "Ne po frikësohemi nga personat e tillë, sepse ata po paraqiten nëpër rrugë dhe hapësira të ndryshme të qytetit. Frika jonë më e madhe është për fëmijët tanë, sepse ata janë të vegjël dhe shumë herë nuk dinë se si të reagojnë kur takojnë persona të tillë", - u shpreh Sabrie Gashi, qytetare e lagjes Ulpianë. Po ashtu, edhe një qytetar tjetër thotë se kohëve të fundit është vërejtur që personat me sëmundje mentale po shëtisin rrugëve të qytetit, ndërkaq ka raste që ata me sjelljet e tyre dhe me agresivitetin që manifestojnë paraqesin rrezik për jetën e qytetarit. "Personat me sëmundje mendore, pothuajse çdo ditë, bredhin rrugëve të kryeqytetit, pa u penguar nga askush, madje ka raste kur ata i sulmojnë kalimtarët e rastit, ose ka raste kur edhe u shkaktojnë frikë qytetarëve", - tha Besim Idrizi, banor i kryeqytetit. ■

Bastoromania që 'zhvesh' emocionet e thyera kosovare!



Astrit VELIQI

Kohët e fundit, bastoret janë bërë një sëmundje e pashërueshme për të gjitha moshat e shoqërisë, e madje edhe për femrat.

Shumë të rinjve, por edhe të rejave, pothuajse nuk u kalon dita pa vënë bast për lojërat e fatit në Kosovë.

Ato që ndoshta po i joshin më shumë të rinjtë tanë janë bastoret, të cilat kanë mbirë si kërpudhat pas shiut në Kosovën e pasluftës.

A janë këto një humbje kohe dhe lojë emocionale njerëzore, apo mundësi për ta mbushur apo zbratur xhepin, këtë e dinë më se miri të rinjtë tanë të cilët shprehën mendimet e tyre në lidhje me këtë temë.

Elbasani: Në dorë e ke humbjen dhe fitoren



Elbasan Qestaj thotë se po t'i shikosh bastoret, ato janë gjithnjë përploot njerëz, ngase në një farë forme aty njerëzit provojnë fatin e tyre, ose fitojnë ose humbin.

"Unë luaj jo shpesh. Ka raste kur fitoj, por natyrisht nëse luan shpesh edhe mund të humbasësh, ngase bastoret kanë këtë pamje që edhe të gëzojnë, por edhe mund të trishtojnë në disa raste", - thotë Elbasani.

Ai mendon se për të fituar në bastore duhet të jesh aktiv në përcjelljen e lojërave dhe ligave të ndryshme futbolistike në botë.

Sipas tij, në lojën e bastoreve ke në dorë dy fate: o humbjen, o fitoren, andaj kjo është e mira, ngase njëra ndodh domosdo.

Astriti: Loja në bastore të zhvesh shpirtërisht

Ndërsa Astrit Pirraku thotë se luan në



bastore nganjëherë, por jo shumë.

Ai e klasifikon bastoren si një lloj sëmundje, që po të kapi vështirë se mund të largohesh nga ajo.

"Lojërat e fatit kanë atë egon që të joshin shumë lehtë dhe joshja pas tyre është shumë e keqe, ngase në shumë raste edhe të zhveshin shpirtërisht", - thotë Astriti.

Ai mendon se bastoret duhet të jenë me licenca, që po fitove, të paktën, ta marrësh pjesën si duhet.

Sipas tij, në bastore çdo gjë është relative, ngase mund të jesh pranë fitores dhe mjafton një çast dhe mund ta kesh epitetin e humbësit.

Ai, kur luan, nuk rekomandon shumë t'i përcjellë lojërat që ka luajtur, ngase sipas tij krijohen lloj-lloj emocione që të mbajnë pezull shumë gjatë.

Kosovë: 43 subjekte të lojërave të fatit, 10% pa licencë

Në Kosovë janë 43 subjekte të lojërave të fatit, prej të cilave 10 për qind nuk kanë fare licencë.

Administrata tatimore e Kosovës thotë se kjo dukuri nuk e dëmton buxhetin e Kosovës, përveç se ato duhen mbyllur.

Deri tani, në Prishtinë e Pejë u është venë dryni gjithsej tetë subjekteve që kanë ushtruar këtë veprimtari.

Por bashkë me entuziazmin e kosovarëve për të fituar para nga lojërat e fatit, po rritet edhe numri i këtyre subjekteve që nuk kanë licenca.

Kjo dukuri në rritje është bërë tanimë shqetësuese edhe për vetë Administratën Tatimore të Kosovës.

Saktësisht, të dhënat nga ATK flasin për 13 subjekte që merren me baste sportive, në kuadër të të cilave janë të licencuara edhe 258 njësi të basteve sportive, ndërsa për 16 subjekte të tjera që merren me lojëra me aparate, në të cilat hyjnë 2.072 aparate të licencuara.

Kurse subjektet që merren me tom-bola bingo janë 13 dhe një kazino.

Megjithatë, zyrtarë të ATK-së thonë se

nga numri i tërësishëm i subjekteve të licencuara, 10 për qind e tyre nuk kanë licenca.

Hava Ademi, zyrtare për informim në ATK, thotë se pavarësisht nga ekzistimi i subjekteve pa licenca, ato nuk i shkaktojnë humbje buxhetit të Kosovës, sa i përket pagesës për licencimin e tyre.

"Nëse një subjekt heziton që të licencohet që në fillim të aktivitetit të tij, ai patjetër që brenda një periudhe të arsyeshme kohore, ose do të jetë i detyruar që të licencohet dhe të vazhdojë aktivitetin e vet, ose do të mbyllet", - shprehet ajo.

Megjithëkëtë, ndonëse shumë subjekte të tilla operojnë në Kosovë,

Administrata Tatimore, në bashkëpunim edhe me policinë, ka filluar para disa ditësh një aksion, ku janë mbyllur disa nga këto lokale të lojërave të fatit.

Në Prishtinë e Pejë janë mbyllur disa subjekte të lojërave të fatit

Vetëm në komunën e Prishtinës janë mbyllur katër subjekte të lojërave të fatit dhe 4 njësi tjera të vendosura nëpër lokacione të ndryshme në kryeqytet. Ky aksion ka hasur në subjekte të palicencuara edhe në Pejë dhe ka rezultuar me mbylljen e 4 subjekteve të lojërave të fatit atje dhe 5 njësi të tjera.

"Aktivitete të tilla të planifikuara dhe të koordinuara mes ATK-së, doganave dhe policisë janë planifikuar të vazhdojnë edhe në të ardhmen, duke mbuluar kështu gjithë territorin e Kosovës", - pohon Ademi.

Nga ana tjetër, rregullativa ligjore për këtë fushë ekziston, pasi është në fuqi Ligji për Lojërat e Fatit, ku parashihen edhe ndëshkimet.

Sipas këtij ligji, subjektet ekonomike që organizojnë lojëra të fatit pa leje të organit kompetent, varësisht nga lloji i lojës se fatit, gjobiten prej 35 mijë deri 70 mijë euro. Ndërkaq, kur bëjnë shkelje të rregullave, dënimi me të holla arrin nga 5 mijë deri 25 mijë euro.

Ndryshe, varësisht prej llojit të licencës që aplikon një subjekt, pagesa për hapjen e tij kushton prej 5 mijë, që janë tombolat, deri në 25 mijë euro që paguhet për hapjen e bastoreve. ■

Hulumtim për praninë e literaturës në gjuhën shqipe në Universitetin e Prishtinës (UP)

Mungesë e literaturës



Osman D. GASHI

Universiteti kryesor publik në Kosovë, ai i Prishtinës, përballlet me probleme të shumta: numri i madh i studentëve, problemet e menaxhimit në çdo aspekt, problemet e hapësirës dhe infrastrukturës, e ndër to edhe problemi i sigurimit të literaturës në gjuhën shqipe për studentë.

Dihet se studentët, për të qenë sa më të përkushtuar ndaj studimeve, duhet të jenë të pajisur me literaturë. UP-ja duhet të krijojë, në përgjithësi, parakushte dhe lehtësira që studentët ta kenë literaturën në gjuhën amtare. Sipas statutit të UP-së parashihet që studimet të zhvillohen në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera, neni 149, pika (1), por se sa zbatohet kjo në praktikë, është një çështje tjetër, e cila do të trajtohet më poshtë në detaje.

Një grup studentësh, i fakultetit të Filologjisë të degës së Gazetarisë, duke u nisur nga ankesat e studentëve për mungesën e literaturës në gjuhën shqipe bënë një hulumtim pikërisht për këtë problematikë, hulumtim që kishte për qëllim të nxirrte në pah gjendjen ekzistuese të librit universitar në shqip dhe faktin se a ka përkthime të literaturës në shqip.


Ky hulumtim është zhvilluar në gjashtë fakultetet më të mëdha të UP-së, në: Ekonomik, Juridik, Filologjik, Filozofik, Edukim dhe Shkenca Matematiko-Natyrore, me një numër të intervistuarish që ka arritur deri në 120. Forma e hulumtimit ka qenë e tipit të mbyllur.

Hulumtimi ka pasur 13 pyetje, midis të cilave janë përfshirë pyetje të tilla si: sa kohë ia kushtojnë studentët leximit, çfarë lexojnë më shumë, a janë librat të shtrenjtë, a kanë mundësi ata ta sigurojnë literaturën e detyruar, pyetje rreth asaj se në ç'ambient mësojnë studentët, e deri tek bashkëpunimi me profesorët dhe njohuritë e studentëve për faktin


se UP-ja është e obliguar t'ua sigurojë literaturën në shqip studentëve të tij.




Si çdo hulumtim që fillon me pyetje relaksuese, në mënyrë që të anketuarit ta pranojnë më lehtë anketimin, hulumtimi në fjalë fillon me kohën që studentët i kushtojnë leximit. 82 të anketuar ose 68% i kushtojnë kohë mesatarisht, kurse 30 të anketuar, ose 25% nga numri i përgjithshëm që ishte 120, i kushtonin shumë kohë leximit. Kurse pjesa e mbetur, rreth 7%, i kushtonte pak kohë atij. Dhe, kryesisht, ky lexim përshinte literaturën e obliguar shkollore, numër që arrinte diku deri në 75 të anketuar, ose 63% e tyre.



Në anën tjetër, gjendja jo e mirë ekonomiko-sociale e shoqërisë sonë, reflektohet edhe në sigurimin e literaturës për studentët, ngase pyetjes se sa është real çmimi i librave, 69 të anketuar, ose 58%, i janë përgjigjur se çmimi i tyre është i shtrenjtë sepse shumë prej studentëve nuk kanë mundësi ta sigurojnë këtë literaturë. Numri i të anketuarve që dhanë një përgjigje të tillë arriti deri në 60 sish, ose rreth 49% e tyre.



Me gjithë problemet për sigurimin e literaturës, studentët, si vend të preferuar për lexim e studim e kanë dhënë me tepër ku banojnë. Rreth 53% ose 64 të anketuar preferojnë më tepër dhomën e tyre, 22% Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës (BKUK), 25% bibliotekën e fakultetit të tyre. Edhe pse 60% e studentëve të anketuar pajtohen se, qoftë BKUK e qoftë bibliotekat e fakulteteve, kanë literaturë të mjaftueshme, ata nuk e shfrytëzojnë këtë literaturë aq shumë. 37% e shfrytëzojnë mesatarisht, kurse 31% e të anketuarve e shfrytëzojnë pak literaturën e bibliotekave.



Gjendja e tillë, që u përshkrua më sipër, tregon nuk ajo nuk është e kënaqshme dhe gishti për këtë mund të drejtohet nga UP-ja dhe mësimdhënësit universitarë. Këta të fundit, jo që nuk kanë punë individuale, libra të tyre personale, por as që nuk e marrin mundimin që të paktën të përkthejnë edhe prej ndonjë gjuhe të huaj, pasi që 88 të anketuar ose 73% janë përgjigjur se ka pak literaturë të përkthyer në gjuhën shqipe e, në anën tjetër, jo të gjithë profesorët bashkëpunojnë me studentë sa i


shqipe në universitet

Hulumtimi

Pyetja kryesore e hulumtimit ka qenë:

A ka mungesë të literaturës në gjuhën shqipe në fakultetin tuaj?

84 studentë të anketuar ose 70% e tyre janë pajtuar që ka mungesë të literaturës shqipe në fakultetet e tyre përkatëse, kurse 36 të anketuar, ose 30%, janë pajtuar që nuk ka mungesë të literaturës. Nga kjo statistikë del në pah, ajo që ka qenë paraparë qysh në fillim, se: Në UP ka mungesë të literaturës në gjuhën shqipe.



njohuritë e studentëve në lidhje me të drejtat e tyre, që UP-ja ka karshi tyre, për sigurimin e literaturës dhe se ata e kanë kërkuar në fakultetet e tyre këtë literaturë. Më tepër se gjysma e të intervistuarve, rreth 51% e studentëve,

sitetin e Prishtinës ka mungesë të literaturës në gjuhën shqipe, pasi kështu janë përgjigjur 84 të anketuar, që i bie rreth 70%.


Një përfundim tjetër, që është nxjerrë nga grupi që ka bërë këtë hulumtim, është mos informimi dhe mos njohuria e studentëve për të drejtat e tyre, në raport me Universitetin e Prishtinës, pasi që 61 të anketuar, ose 51% e studentëve, i takojnë kësaj kategorie.

Gjithashtu, nga ky hulumtim, është nxjerrë një përfundim tjetër i rëndësishëm për interesimin dhe vetinicitivën e studentëve për kërkimin e librave. Rezultati është tejet i dobët: vetëm 42 të anketuar, ose 35%, kanë kërkuar në fakultetet e tyre literaturë shqipe.

Pas tërë këtyre të dhënave të këtij hulumtimi, rekomandimet e nxjerra janë:

- Studentët duhet që, përmes formave të ndryshme të lejuara, të bëjnë presion dhe të ankohen për mungesën e literaturës në gjuhën shqipe.
- Realizimi i një fushate informuese, qoftë nga studentët e qoftë nga vetë UP-ja, për këtë problematikë.
- Bërja presion te mesimdhënësit universitarë që të punojnë më shumë rreth literaturës në gjuhën shqipe. Të mos bëhen avancime në tituj shkencor nëse profesorët nuk e arsyetojnë titullin me punë shkencore e intelektuale, duke lënë pas tyre libra nga të cilat studentët do të përfitonin, ashtu që të arsyetonin edhe pagën e tyre, që tashmë është rritur goxha shumë. ■

FYETJA 8:
A KA MUNGESË TË LITERATURËS NË GJUHËN SHQIPE NË FAKULTETIN TUAJ?



përket sigurimit të literaturës në gjuhën shqipe. Nga rezultatet e hulumtimit mësojmë se rreth 66% ose 79 studentë të anketuar mendojnë se profesorët nuk janë bashkëpunues dhe mendojnë se ekziston fenomeni i mbajtjes së distancës profesor-student.

70% e të anketuarve mendojnë se ka mungesë literature në gjuhën shqipe


Tri pyetjet e fundit kanë të bëjnë me

nuk e dinë që UP-ja është e obliguar t'ua sigurojë literaturën në gjuhën amtare studentëve, gjë që parashihet nga statuti i vetë këtij institucioni të arsimit të lartë, neni 149, pika (1). Bazuar në këtë mos njohuri të studentëve për të drejtat e tyre, 65% e të anketuarve nuk e kanë kërkuar literaturën në gjuhën shqipe prej fakultetit të tyre.

Pra, në fund, mund të vlerësojmë se nga ky hulumtim kemi arritur të nxjerrim përfundimin se në Univer-

Anketimin e realizuan:

Adelina Sahiti, Osman Gashi,
Perparim Bublaku dhe Valon Gerbeshi



Sektori i ekonomisë gjatë dy viteve të funksionimit si shtet

Sukseset vazhdojnë

Gjatë dy viteve të funksionimit të Republikës së Kosovës si shtet janë bërë ndërtime të mëdha, duke filluar nga infrastruktura rrugore, ndërtimi i shkollave, por edhe i objekteve qeveritare dhe institucioneve të tjera me rëndësi për kulturën dhe shkencën.

Është rinovuar ndërtesa e ish-Bankës së Lubjanës për ndërtesën e qeverisë së Kosovës. Po ashtu, është rinovuar dhe përshtatur pallati i Medieve "Rilindja" për objektet e disa ministrive, është ndërtuar Selia e Ministrisë së Arsimit dhe ndërtesa e Akademisë së Shkencave. Por, pavarësisht këtyre, ka ende punë për t'u bërë.



Lulzim AHMETI

Funksionimi si shtet i Kosovës për dy vjet është treguar i suksesshëm edhe në sferën ekonomike. Përveç që ka pasur të arritura të shumta në të gjithë sektorët ekonomikë, si në përmirësimin e infrastrukturës, rrugore, investimet në ndërtimin e shkollave dhe objekteve të ndryshme, po ashtu ka pasur ndryshime për dy vite edhe në sektorin e energjetikës, i cili konsiderohet si një ndër sektorët më problematikë në vend.

Por, pavarësisht kësaj, mund të thuhet se Kosova ka funksionuar si shtet gjatë këtyre dy viteve dhe po vazhdon të funksionojnë, por institucionet e Kosovës kanë ende shumë punë para vetes për të bërë, në rend të parë për të ulur papunësinë, si dhe për të rritur standardin e jetesës për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Këto dy vitet e funksionimit, Republika e Kosovës ka arritur që të bëhet pjesë e disa organizatave të rëndësishme financiare ndërkombëtare, të cilat kanë dhe janë duke e ndihmuar Kosovën, si vendi më i ri në botë, në mënyra të ndryshme.

Anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), liderë të vendit dhe ata të institucioneve ndërkombëtare e patën vlerësuar lart si një mundësi e mirë për Kosovën.

Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, anëtarësimin e Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), e ka quajtur si proces i cili shënon një ditë të rëndësishme për proceset që kemi arritur së bashku me miqtë ndërkombëtarë.

"Vendimi i marrë pa hezitim është

një thirrje për vendet e tjera të botës demokratike ta njohin sa më shpejt Republikën e Kosovës, prandaj e kemi rrugën çel përpara, e ne do të punojmë që kjo rrugë të jetë sa më e shkurtër", - pat thënë presidenti Sejdiu.

Ndërsa kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, e pat vlerësuar si vepër të qytetarëve të Kosovës dhe institucioneve të Kosovës.

"Anëtarësimi në FMN është vepër e qytetarëve të Kosovës, vepër e institucioneve të Kosovës dhe vepër e institucioneve ndërkombëtare",.

Ndërkaq kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, e pati cilësuar atëherë anëtarësimin e Kosovës në FMN si një përgjegjësi për Kosovën.

"Ekuptomëse anëtarësimi në FMN është sukses yni, në të njëjtën kohë është përgjegjësi dhe sfidë për ne", - pat thënë Thaçi.

Kurse sa i përket zhvillimit ekonomik në vend, ai, gjatë vitit që e lamë pas, nuk ishte aq i mirë për disa arsye.

Qeveria e Republikës së Kosovës pat parashikuar që viti 2009 t'i sillte Kosovës një rritje ekonomike deri në 6 për qind, ndërsa ajo nuk arriti të shkojë më shumë se 4 për qind.

Nuk ishte vetëm ky parashikimi për rritjen e produktit bruto të brendshëm (GDP).



Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) nuk parashikoi të ketë rritje ekonomike më shumë 3.4 për qind.

Në krahasim me vitin 2008, kjo shifër paraqet zvogëlim të trendit të rritjes që ishte 5.4 për qind, por të gjithë janë të kënaqur që nuk ka zvogëlim të zhvillimit ekonomik.

Zyrtarë të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF), këtë rritje e kanë bazuar në katër sektorë: në sektorin real, fiskal, financiar dhe atë të jashtëm.

Por disa ekspertë të ekonomisë, këtë nuk e quajnë rritje reale. Sipas tyre, kjo rritje është kryesisht nga konsumi.

Por ekspertët e shohin si fat nëse Kosova do të ketë një rritje ekonomike prej 4.4 për qind.

Njëjtë vlerësohet të ketë ndodhur edhe me investimet e huaja direkte, të cilat sipas statistikave kanë shënuar rënie për më shumë se 15 për qind gjatë vitit 2009.

Sipas të dhënave në vitin 2008, vlera zyrtare e investimeve ka qenë 350 milionë euro, ndërsa për vitin 2009, përgjegjësit për nxitjen e investimeve vazhdojnë të mos e dinë, por e pranojnë se është dukshëm më i vogël.

Këtu ka pasur ndikim pasiguria që iu ka dhënë kriza globale, por ata janë përballur me problemet e njëjta të disa viteve më herët.

Këtu, pa dyshim, ka pasur ndikim edhe marrëveshja për tregti të lirë CEFTA, e cila nuk ka shënuar ndonjë

përmirësim gjatë vitit që lamë pas, në respektimin e saj nga ana e Serbisë.

Asnjë produkt i eksportuar në Serbi nga Kosova, nuk ka kaluar pa taksa sipë parashihej në marrëveshje.

Madje, as nuk dihet se kur do të respektohet kjo.

As nga qeveria nuk është premtuar se kur do ta bindin qeverinë serbe për respektimin e kësaj marrëveshjeje.

Rritja e shkallës së importit ka reflektuar edhe në çmimet e konsumit në Kosovë.

Si duket, ka pasur ulje të çmimeve në të gjitha vendet nga të cilat Kosova importon.

Kjo sepse viti 2009 është karakterizuar nga një situatë e stabilizimit të çmimeve, përkatësisht me zbritje të vazhdueshme të çmimeve, pas rritjes në vitin 2008.

Kështu që, përderisa viti 2008 karakterizohej nga një shkallë e lartë inflacioni, 2009-ta shënoi gradualisht shkallë deflacioni deri në muajt e fundit të atij viti.

Disa nga ekspertët për përcaktimin e çmimeve, njërin prej indikatorëve e kanë parë edhe të dërgesat e emigrantëve, të cilat ndikojnë në rritjen e konsumit.

Por edhe ato këtë vit kanë shënuar zbritje.

Të hyrat nga remitencat kanë shënuar zbritje deri në 8 për qind.

Të paktën këto janë shifrat që ka raportuar Banka Qendrore e Kosovës për gjashtëmuajorin e parë të këtij viti.

Ato në vitin 2008 ishin më shumë se 500 milionë dhe kjo do të thotë se kanë hyrë disa milionë më pak.

Në mënyrë zinxhurore kjo ka ndikuar edhe në depozitat bankare, përkatësisht,

në rënien e depozitave për disa banka.

Gjatë këtyre dy viteve, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (ANP), Posta dhe Telekomit i Kosovës kanë vazhduar sukseset e tyre.

Investimet në rrugë dhe shkolla

Kurse investime në projekte kapitale më së shumti ka pasur në infrastrukturën rrugore dhe në fushën e arsimit.

35 për qind e buxhetit të viti 2010 është planifikuar për ndërtimin e rrugëve, për shpenzime kapitale, nga 1 miliardë e 461 milionë euro sa është buxheti.

Gjatë vitit 2008 janë shtruar me asfalt 618 kilometra rrugë, në të cilat përfshihen rrugët lokale, regionale dhe ato nacionale, kurse një vit më herët, në vitin 2007, sipas statistikave, janë asfaltuar rreth 100 kilometra.

Me gjithë faktin se ndërtimi i autostradës Vërmicë-Prishtinë-Merdare cilësohet si një nga projektet më të rëndësishme të vendit, me çka dhe Kosovës po i hapen rrugët për të pasur më lehtë qasje në tregjet e jashtme, problem do të jetë gjetja e mjeteve financiare.

Çmimi prej 7.5 deri në 8 milionë euro për një kilometër mund të jetë i arsyeshëm, nëse ai nuk ndryshon gjatë ndërtimit të saj.

Autostrada Vërmicë - Prishtinë - Merdare do të jetë hyrje - dalje e sistemit të mbyllur, do të jetë e gjatë 103 kilometra, e gjerë 28 metra do t'i ketë katër shirita qarkullues me nga 3.75 metra, si dhe dy shirita për ngadalësim me nga 3 metra dhe brezi i gjelbër në mes me 4 metra gjerësi. Ndryshimi i trasesë nga

udhëkryqi i autostradës E 6 E7 deri në kycjen E9 është me gjatësi prej 11.6 kilometrash. Oferta e kompanisë "Bechtel & Enka" përmban planin për përfundimin e të gjithë autostradës për 36 muaj punë. Faza e parë përfshin ndërtimin e segmentit A1, A2 dhe B3 - që përfshin Vërmicë-Prizren-Suharekë-Orllat në gjatësi prej 60.7 kilometrash, e cila pritet të përfundojë për 24 muaj nga dita e fillimit të punës. Ndërsa faza e dytë përfshin ndërtimin e segmentit Sllatinë-Besi me gjatësi 27 kilometra.

Sektori i energjisë

Pavarësisht prej investimeve të cilat janë bërë në Korporatën Energjetike të Kosovës gjatë këtyre dy viteve të funksionimit si shtet, furnizimi me energji elektrike ende nuk është stabil.

Projekti më i madh në sektorin energjetik, ai për ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re", i përfolur si projekti më i madh ballkanik që do të furnizojë jo vetëm Kosovën por edhe më gjerë, ka vazhduar të jetë pjesë e ndryshimeve të shpeshta që nga viti 2006.

Tani, në plan, sipas vendimeve të Komitetit drejtues për "Kosovën e Re", kapaciteti i tij do të jetë 500 megavat me mundësi shtimi edhe 500 të tjerë.

Problem i madh për KEK-un, përveç furnizimit me rrymë, është edhe inkasimi i borxheve që kalojnë 350 milionë euro.

Por ajo çfarë na mbetet për të bërë është se duhet të punojmë sa më shumë që të rrisim punësimin në vend, pasi, për çdo vit, tregut të punës në vend i shtohen mijëra të rinj. ■



Intervistë ekskluzive me kryeshefin ekzekutiv të PTK-së, dr. Shyqyri Haxha

Brenda një viti, PTK shënon rritjen

Intervistoi: Alban BILALLI

Të arriturat e kompanisë më të madhe në vend, zhvillimet dhe sfidat e saj, llojlojshmëria e shërbimeve me të cilat operon, si dhe problemet me të cilat ballafaqohet, janë në fokus të intervistës me kryeshefin ekzekutiv të PTK-së, dr. Shyqyri Haxha. Ai, midis të tjerash, pohoi se kompania që ai drejton është duke shënuar rezultate dhe se është promotor i luftimit të varfërisë në Kosovë, i punësimit të kategorive të dala nga lufta, por edhe kontribuuesi më i madh i buxhetit të Kosovës.

PAQJA: Ju sapo e keni nisur vitin e dytë të menaxhimit në kompaninë më të madhe në vend. Cilat janë rezultatet e punës suaj të deritashme?

Dr. HAXHA: Mund t'iu konfirmoj se PTK, brenda një viti të udhëheqjes sime, ka pësuar ndryshime rrënjësore pozitive në aspektin e menaxhimit, në ofrimin e shërbimeve të konsumatorëve, në investimet kapitale dhe, si rrjedhojë, kjo ka ndikuar drejtpërsëdrejti në rritjen e vlerës së korporatës. Gjithashtu, PTK gjatë të njëjtës periudhë, krahas profitit të planifikuar, ka arritur që deri në këtë kohë ta tejkalojë planin mbi 40 për qind. Këtë dua ta ilustroj me faktin se PTK Sh. a në fillim të vitit 2009 ka pasur rënie të të hyrave, mirëpo me masat emergjente të ndërmarra në muajt në vazhdim, si rezultat i projekteve dhe produkteve të njëpasnjëshme, të cilat i kemi lansuar në treg, uljes së shpenzimeve dhe menaxhimit efikas - ka arritur rezultate të jashtëzakonshme.

PAQJA: Cilat janë projektet aktuale që po zhvillohen në PTK?

Dr. HAXHA: Në fakt, bëhet fjalë për dhjetë projekte të mëdha që tregojnë për punët kapitale që janë duke u bërë në PTK. Projektet madhore janë: licenca e katërt në Shqipëri; fijet optike në shkolla dhe institucione të tjera shtetërore; risstrukturimi i njësie biznesore; Faza e VI (3G); Internet Protocol Television (IPTV); sistemi i ri i BILINGUT; lansimi i numeracionit të ri 045 (50 për qind

ngritje e kapacitetit); luftimi i dukurisë SIM TO SIM; ulja e shpenzimeve, si dhe rritja e numrit të konsumatorëve dhe e të hyrave financiare. Posta dhe Telekom i Kosovës, prej ardhjes sime, ka shënuar një ndryshim evident pozitiv. Të gjitha këto kanë ndikuar direkt në rritjen e vlerës së kompanisë, numrit të konsumatorëve dhe rritjes së neto profitit. PTK do të publikojë edhe rezultate të tjera edhe më të mira se këto. Kjo për faktin se kompania ka shënuar një kthesë të madhe në zgjerimin e gamës së produkteve, shërbimeve kualitative, imazhit dhe numrit gjithnjë në rritje të konsumatorëve të saj.

PAQJA: Operatori Vala ka shtuar numrin e konsumatorëve. Na thoni si është arritur kjo?

Dr. HAXHA: Është e vërtetë se Posta dhe Telekom i Kosovës, përkatësisht njësia VALA, gjatë katër muajve të kaluar ka shtuar mbi 110 000 mijë konsumatorë të rinj. Shtimi i numrit të konsumatorëve ndikon direkt fillimisht në rritjen e të hyrave të korporatës, në veçanti, por edhe në ngritjen e vlerës së saj, në përgjithësi. Me këtë ritëm të rritjes së numrit të konsumatorëve, ne kemi tejkeluar konsumatorin tonë aktiv të njëmiliontë, ndërkohë kohë më parë, me investimet e realizuara në VALA, janë rritur kapacitetet që të kemi deri në 1 milion e 200 mijë konsumatorë. Kjo është arritur falë investimeve që kemi nisur dhe ato që tashmë kemi përfunduar në VALA, kështu që ne, përveç produkteve dhe shërbimeve të reja të cilat po iu ofrojmë konsumatorëve, do të jemi në gjendje që këto shërbime t'ua ofrojmë me një kualitet të lartë dhe kjo është dëshmuar për festat e fundit, ku

për herë të parë në historinë e saj VALA ka funksionuar pa asnjë problem.

PAQJA: PTK është kompania që kontribuon më së shumti në buxhetin e Kosovës. Cili është koment juaj?

Dr. HAXHA: PTK, pikë së pari, është shumë transparente dhe përveç të tjerash është institucion i shtetit që gjeneron mjete dhe që e ndihmon shtetin. Ne e ndihmojmë buxhetin e Kosovës jo vetëm me tatime, por edhe me ndihma ndaj kategorive sociale, ndërtojmë shtëpi për skamnorët, japim donacione për invalidë të luftës, punësojmë njerëz me aftësi të kufizuara, ndajmë bursa për studentë, pastaj ndihmojmë arsimin, shkollat, etj. Zgjerimi ynë, ose rritja e numrit të konsumatorëve, të gjitha në mënyrë indirekte po e ndihmojnë edhe veten, sepse ato para po i kthehen shtetit dhe shteti po forcohet me një kompani si PTK-ja.

PAQJA: Meqë jemi te shkollat, a jeni ju duke vazhduar zgjerimin e rrjetit optik në gjithë Kosovën, me objektivin që interneti të shtrihet në të gjithë shkollat?

Dr. HAXHA: Ky është njëri ndër projektet më të mëdha në Kosovë dhe është projekti më i madh në PTK. Ideja ka qenë që internetin ta fusim nëpër shkolla. Gjeneratat e ardhshme do të jenë ata që do ta marrin këtë beneficion menjëherë. Kjo do të ndikojë drejtpërdrejt në ngritjen e standardit të edukimit. Saktësisht janë 1 mijë e 80 shkolla që do t'i kenë fijet optike të internetit. Procedurat e prokurimit na kanë zvarritur. Mirëpo tash e kemi përgatitur gjithë dokumentacionin dhe tenderet kanë dalë për zgjedhjen e kompanive për kryerjen e këtyre punëve. Besoj që



më të madhe

shumë shpejt punët do të fillojnë dhe ky projekt shumë të madh do të kryhet. Është një projekt që do t'i japë një vlerë të madhe PTK-së dhe me këtë projekt arrijmë që nëpër të gjitha shkollat t'i kemi konsumatorët tanë. Strategjia ime ka qenë që, si shef ekzekutiv, jo vetëm të kemi profit për kompaninë, por edhe për qytetarët e Kosovës. Vetë qytetarët e Kosovës, të gjithë mund ta dinë që qëllimi ka qenë dhe është që këtë të mirë ta marrin qytetarët e Kosovës dhe ta kenë këtë vegël në dorë (informatën) dhe, ana tjetër, është edhe aspekti i përfitimit komercial, d. m. th. se këta janë konsumatorët tanë.

PAQJA: *Një nga nismat që ka marrë PTK-ja kohëve të fundit është ndihma që po u ofron familjeve nevojtare, familjeve skamnore dhe të pastreha. Sa do të jetë në gjendje të vazhdojë ky projekt edhe në muajt dhe vitet në vazhdim?*

Dr. HAXHA: Prej se kam ardhur në PTK vërehen suksese. Të hyrat janë rritur, kemi suksese për çdo ditë, kështu që vetë kjo na ka shtyrë, që ne të kontribuojmë. Kjo është një kompani publike, prandaj edhe e kemi parë të arsyeshme që t'i ndihmojmë qytetarët e Kosovës, si kompania më profitabile në Kosovë. Ne kemi ndihmuar në ndërtimin e shtëpive, kemi ndihmuar fëmijët, 450 nxënës, si edhe disa raste individuale për shërimin e personave të ndryshëm. Kemi kontribuar në mënyra të ndryshme në formën e donacioneve për t'u dalë në ndihmë gjithë atyre që janë të rënduar nga gjendja e rëndë ekonomike dhe sociale. PTK do të vazhdojë të jetë lider jo vetëm në ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët të Kosovës, por do të jetë dorë e zgjatur për të gjitha ato kategori sociale që u duhet përkrahja dhe ndihma në vazhdimësi. Rasti i fundit ishte një marrëveshje mirëkuptimi, që ka të bëjë me mbështetjen financiare të PTK për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për realizimin e projektit për kuzhinat popullore. PTK ka dhënë donacion në emër të projektit "Kuzhina Popullore", të menaxhuar nga Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në vlerë prej 45 mijë euro. Synimi

i këtij projekti është që të ofrohet një shujtë e ngrohtë për individë a familje me nevojë gjatë 365 ditëve të vitit, saktësisht 1000 shujta në ditë, në pesë qendrat më të mëdha të Kosovës, si në Prishtinë, Pejë, Ferizaj, Gjiilan dhe Mitrovicë. Gjithashtu, PTK-ja ka krijuar vende të punës dhe integrimin e komuniteteve në përputhje edhe me strategjinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe integrimin e të gjitha rajoneve, si me shërbime të PTK-së, ashtu edhe përfshirjen e komuniteteve në struktura të PTK-së, në veçanti në pjesët e banuara nga pakicat, si: Graçanicë, Shtërpçë, Brezovicë, etj. Në të njëjtën kohë, PTK ka ndërmarrë aktivitete të shumta të natyrës sociale duke ndihmuar dhe asistuar financiarisht, në një ndihmë prej 10 mijë eurosh, banorët e përmbytur në Shqipëri, ndërtimin e shtëpive shtesë për kategoritë e rrezikuara sociale, etj. Kemi dhënë donacione dhe kemi sponsorizuar më shumë se çdoherë, në një vlerë mbi 1 milion e 300 mijë euro. Të hyrat janë shumë të mira dhe këta indikatorë na kanë obliguar që të ndihmojmë. PTK do të vazhdojë të financojë dhe ndihmojë kurdo dhe kudo që ka mundësi, natyrisht duke pasur në konsideratë autorizimet ligjore dhe mundësitë financiare.

PAQJA: *Një problem me të cilin jeni duke u ballafaquar kohët e fundit është borxhi i konsiderueshëm që kanë ndaj PTK-së borxhlinjtë e ndryshëm. Sa është ky borxh aktualisht?*

Dr. HAXHA: Këto ditë, PTK-ja ka qenë e detyruar që të publikojë listën e tretë të borxhlinjve më të mëdhenj, duke qenë e shtyrë që konform ruajtjes së pasurisë së saj dhe me qëllim të rritjes së mëtutjeshme, të bëjë identifikimin e një liste tjetër të borxhlinjve të saj. Kjo është hera e tretë që PTK bën publikimin e emrave të borxhlinjve. Me këtë rast është vërejtur një lëvizje pozitive në disa riprogramime të borxheve dhe disa pagesa, si në Telekomin e Kosovës, ashtu edhe në VALA. Megjithatë, PTK shpreson se konsumatorët borxhlinj do ta konsiderojnë këtë nismë të PTK-së si shumë serioze dhe do të vazhdojnë të përgjigjen pozitivisht, pasi që pas identifikimit të borxhlinjve ka pasur shumë telefonata nga konsumatorët për të marrë informata shtesë rreth borxheve që kanë dhe mundësisë së shlyerjes së tyre



me këste. Sa i përket borxhit të përgjithshëm, bazuar në statistikat e fundit të Komisionit të Arkëtimit të Borxheve, borxhi i përgjithshëm i konsumatorëve ndaj Postës dhe Telekomit të Kosovës edhe më tutje mbetet në shifra të larta, përkatësisht në mbi 40 milionë euro. Për këtë arsye, PTK ka ngritur mijëra padi në gjykatat kompetente. Megjithatë, për fat të keq, vetëm një numër i vogël i tyre kanë përfunduar me sukses. PTK do të publikojë sërish listat e borxhlinjve të saj, pa përjashtim, me synimin e vetëm që kjo do të mund të ketë efekt në ndërgjegjësimin e institucioneve, komunave, organizatave partiake, bizneseve private dhe individëve borxhlinj, të cilët tash e sa kohë i kanë të pashlyera faturat ndaj PTK-së.

PAQJA: *PTK-ja është në prag të privatizimit dhe, në këtë kontekst, si e shihni zgjidhjen më të mirë për kompaninë që ju udhëhiqni?*

Dr. HAXHA: Detyra ime parësore është se si t'ia rris vlerën kësaj kompanie dhe vlera i është rritur. Nëse dëshironi ta dini se sa po kontribuojmë prej se kam ardhur unë, atëherë kthehuni një vit më parë e shikoni se ku ka qenë kompania dhe krahasojeni me sot, ose me atë ku do të jetë nesër. Me vlerë të rritur, privatizimi mund të ketë më shumë sukses. Por, sa i përket privatizimit, është qeveria ajo që vendos. Ka modele të ndryshme privatizimi dhe besoj se qeveria do të zgjedhë modelin më të mirë. Mirëpo, ne do ta ngremë standardin e kompanisë, në mënyrë që, kurdo që të shitet dhe të privatizohet, tash a më vonë, ose kurdo që qeveria e shih të arsyeshme, vlera e PTK-së të jetë shumë e lartë. ■



Mr. Milazim MUSTAFA

Ndonëse vizat u liberalizuan për të gjithë qytetarët e Maqedonisë, ata që më së shumti ishin të interesuar ishin shqiptarët, respektivisht nga zonat e lëna pas dore më së shumti. Ishte zona e Kumanovës dhe Likovës që më së shumti mbushte autobusët e agjencive që, më në fund, u shpallën si fajtori kryesor për këtë eksod modern të shqiptarëve. Çdo ditë, nga kjo zonë niseshin nga 2 autobusë. Fillimisht, organet zyrtare të Maqedonisë dolën me shifra se vetëm brenda një muaji, pas liberalizimit të vizave, nga Maqedonia ishin larguar mbi 150 mijë banorë. Ishin të gjitha këto parashikime që priteshin pas liberalizimit të vizave. Por ajo që e bënte rastin më alarmant ishin shpërnguljet e familjeve të tëra që synonin përfundimin për një jetë më të mirë. Këto familje, kryesisht ia kishin mësyre Belgjikës, si vend që, sipas tyre kishte politikë më liberale për procedurën e azilit ekonomik.

“Deri kur do ta kemi strajcën në shpinë? Deri kur më do t'i përcjellim me lot më të dashurit tanë? Deri kur do të na shkojë jeta vetëm me ndarje?” - ishin këto fjalët e një plakut nga fshati Runicë, që i përcolli gjashtë anëtarët e familjes së tij për në Belgjikë. Këto fjalë, të transmetuara në një nga televizionet e Maqedonisë, e tronditën gjithë masën e gjerë.

Po zbrazet Karada

Shumë lot u derdhën pas liberalizimit të vizave për Maqedoninë me BE-në. Ashtu sikurse edhe janë derdhur me shekuj nga shpërnguljet e shqiptarëve nga trojet e tyre etnike.

“Kafenetë janë të zbrazura. Më parë nuk kishim vend ku të uleshim. Sidomos gjatë periudhës së dimrit, ku zakonisht bashkëfshatarët tanë nuk kanë angazhime. Por tash, gjithçka është zbrazët, nuk po kemi as me kë të bëjmë ndonjë muhabet”, - tha një i ri i fshatit Orizare të Likovës. Të njëjtën gjë na e tha edhe Skender Memeti i punësuar në Internet kafenë ‘Bela’ në Kumanovë. “Më parë lokali ynë punonte pa ndërprerë, kurse tash e mbylлим në orën 22, për shkak se nuk ka të interesuar. Të gjithë të rinjtë na ikën”, - thotë Skenderi nga Kumanova.

Nga ambasada e Maqedonisë në Bruksel, njoftojnë për turma të mëdha njerëzish. U prezantuan edhe fotografi tmerruese të familjeve të tëra që ishin vendosur nëpër stacione të autobusëve dhe trenave. Diplomati Shenasi Iseni, i punësuar në ambasadën e Maqedonisë në Bruksel, njoftoi se nuk kanë numër të saktë të qytetarëve shqiptarë që kanë hyrë në Belgjikë, por deklaroi se, në disa raste, u ka rekomanduar atyre që janë drejtuar në këtë ambasadë se nuk ekziston mundësia e fitimit të azilit, sepse, RM-ja është një prej shteteve me status të kandidatit për në BE dhe se nuk rrezikohen të drejtat elementare të njeriut. Andaj, nuk ia vlen të bien pre e



Abdilqim Ademi

Abdilqim Ademi, në një proncimin në Kumanovë, deklaroi se do të përshejtohen planet qeveritare për këtë zonë, ku në veçanti përmendi: ‘hapjen e pikave kufitare me Kosovën dhe Luginën e Preshevës; ndërtimin e çerdhes për fëmijë në Likovë; hapjen e shtëpisë së shëndetit; një sallë sportive; rregullimin e ujësllësit rajonal; pastaj dramën shqipe në Kumanovë, e kështu me radhë.’

provokimeve dhe gënjeshtreve që bëhen nga faktorë të ndryshëm se në Belgjikë, Francë ose gjetiu, po jepet azil. I njëjti person, tregon se ka pasur një rast me një familjar të tij, të cilin e ka porositur që mos ta marrë këtë rrugë dhe se ai i është përgjigjur: mos u frikëso, se nuk do të vijë te ti. “Ne po përpiqemi të ndihmojmë që mos ta harxhojnë së koti edhe atë pasuri të vogël që kanë, mirëpo ata po na keqkuptojnë”, - tha ekskluzivisht për revistën “Paqja”, z. Iseni, sekretar në Ambasadën e RM-së në Bruksel.

Ky fenomen bëri që të alarmohet situata edhe në BE, duke e kërcënuar Maqedoninë se do të ketë restriksione të liberalizimit të vizave, por edhe në proceset e mëtejshme integruese. Gjithashtu, kjo bëri që kreu më i lartë shtetëror i Belgjikës të vizitonte rajonin, e në veçanti zonën e Likovës, ku pati disa takime me udhëheqësit e kësaj komune, për t’u njoftuar më hollësisht me problemet që i preokupojnë banorët shqiptarë të kësaj ane.



ku i Kumanovës!!!

Shkaqet e shpërnguljes

Zona e Likovës dhe e Kumanovës, ose pjesa e Karadakut të Kumanovës, është ndër pjesët e lëna më anësh. Kjo pjesë, në periudhën e mëparshme, kryesisht ishte zonë bujqësore falë tokës së saj pjellore dhe sistemit të ujitjes që e shfrytëzonte nga dy akumulimet që ishin të ngritura mbi fshatin Likovë dhe sistemi i ujitjes që mbulonte gjithë fushën e Likovës dhe Kumanovës. Fakt tjetër që solli mungesën e perspektivës në këtë zonë ishte edhe periudha e pas pavarësimit të RM-së, ku u mbyll kufiri me Kosovën. Tregu i Kosovës ishte destinacioni kryesor që konsumonte produktet bujqësore të kësaj ane, si: specat, domatet, preshtë e kështu me radhë. Për këtë ndikonte mjaft afërsia e madhe e kësaj zone me Kosovën.

Gjithashtu, në periudhën e mëparshme, edhe qyteti i Kumanovës mund të llogaritet si qytet industrial, për shkak të industrisë mjaft të zhvilluar, e cila u shkatërrua me procesin e privatizimit më kriminal në gjithë rajonin, ku ndërmarrjet gjigante për standardet tona, si fabrika e këpucëve, e veshmbathjeve, e përpunimit të lëkurave, e përpunimit të drurit, e pajisjeve elektronike e kështu me radhë, të gjitha këto, fillimisht u zhvlerësuan e pastaj u "blenë" nga ish-drejtorët e tyre. Sot të njëjtat ndërmarrje janë privatizuar dhe kanë punësuar një numër shumë të vogël punëtorësh, kryesisht maqedonas.

Kjo zonë ishte ndër më të goditurat gjatë luftës së vitit 2001. Përpos ndërtimit të shtëpive, qytetarët e kësaj zone, nuk panë asnjë të mirë nga organizatat e ndryshme, si nga ato shtetërore ashtu edhe prej atyre ndërkombëtare. Nga kjo luftë, mbeti veç

epiteti 'zonë e krizës', që vazhdon ta bartë edhe sot e kësaj dite; epitete ky që pamundëson investime të huaja, sepse në një zonë krize nuk dëshiron të investojë askush.

Tasim Veseli, nga Likova, mori rrugën e Belgjikës, së bashku me gruan dhe katër fëmijët e tij. Posa arriti në Belgjikë, u drejtua te organet kompetente për azil dhe nga u njoftua nga to se nuk kishte mundësi ta fitonte azilin, kështu që vendosi të kthehet në vendlindje. Shpresoj që mos ta humbi vendin e punës, në mullirin lokal në të cilin punoja, - tha për revistën tonë Tasim Veseli. I pyetur për shkaqet e marrjes së rrugës së azilit, ai tha: "Ne morëm rrugën pasi që pamë se çdo ditë e më shumë kushtet ekonomike po vështirësohen dhe se prej vitit 2001 e këndeje nuk ka ndonjë perspektivë. Nuk kishte investime për neve që merremi me bujqësi, më saktësisht ne merremi me përpunimin e duhanit, por tash edhe kjo u ndërpre sepse kombinati i duhanit nuk punon. Tentuam edhe me ruajtjen e bagëtisë, por edhe kjo gjë nuk shkoi. Këto ishin shkaqet që ne vendosëm të marrim rrugën për në Belgjikë", - u shpreh ai. Ai mohon faktin të ketë qenë i manipuluar nga ndokush, ose nga ndonjë agjenci turistike.

Rrugëdaljet.

Vlen të përmendet, se me alarmimin e situatës, në masë të madhe ra interesimi i popullatës për shpërngulje drejt perëndimit, sidomos pas kthimit të një grupi qytetarësh që kishin parashtruar kërkesën për azil. Ditëve të fundit filloi edhe kthimi i organizuar i aplikuesve për azil. Shteti belg ktheu disa prej aplikuesve që dëshiruan të kthehen vullnetarisht, duke ua kompensuar harxhimet e kthimit.

Kthimi i disa autobusëve me njerëz nuk do të thotë edhe zgjidhje e problemit. Kërkohet një strategji dhe zgjidhje afatgjate e këtij problemi. Zv. kryeministri i qeverisë së Maqedonisë z. Abdilqim Ademi, gjatë vizitës së kësaj zone, në një prononcim tha se qeveria do të kontribuojë me disa projekte për përmirësimin e gjendjes në këtë zonë, sidomos ai përmendi ndërtimin e rrugës Sllupčan – Bellanoc, si ndihmesë për hapjen e pikës kufitare me Kosovën, por edhe asaj Llojan – Miratoc, për lidhjen e qytetarëve të kësaj ane me Luginën e Preshevës, që në



Sem Vaknin

të njëjtën kohë ofron edhe mundësinë e qarkullimit të lirë të mallrave. Ai premtoi edhe investime në infrastrukturën rrugore, por edhe në objektet arsimore që fatkeqësisht vite me radhë kanë qenë në kushte të mjerueshme.

Përkundër gjithë kësaj, shpërngulja e qytetarëve drejt vendeve evropiane, pas liberalizimit të vizave, ishte një proces që pritej. Sipas përvojës së vendeve që paraprakisht ishin ballafaquar me këtë problem, një gjë e tillë ishte pritur edhe në Maqedoni dhe gjetiu. Sipas një parashikimi të analistit të njohur Sem Vaknin, parashihet që në dhjetë vitet e para të liberalizimit të vizave, ndërmjet 85.000 dhe 100.000 të rinj të arsimuar dhe kuadro të aftë, do ta braktisin Maqedoninë për të punuar dhe ndërtuar jetën e tyre në vendet e jashtme. Sipas tij, e njëjta gjë ka ndodhur edhe me Rumaninë dhe Bullgarinë. Nga këto vende, pas liberalizimit të vizave, kanë ikur drejt Evropës mbi 400.000 banorë të kualifikuar. ■



Tasim Veseli



Skender Memeti

Presheva mes shpresës dhe zhgënjimit

Drita AZEMI

Një ndër rajonet më të ndjeshme shqiptare, Lugina e Preshevës, vazhdon të mbetet vendi më i diskriminuar në Ballkan. Lufta e UÇPMB (1999/2001) për ngritjen e statusit të shqiptarëve dhe marrëveshja e arritur pas asaj lufte, nuk i dhanë sa duhet rezultatet e shumëpritura për realizimin e objektivave të parashtruara. Regjimi i Beogradit, ndonëse para faktorit ndërkombëtar trumbetohet si demokratik, nuk ka ndryshuar dot mentalitetin e së kaluarës. Inatet e mëhershme serbe, pastaj pasojat e luftërave (në Kosovë dhe në këtë rajon), bëjnë që ky rajon ta ndiejë thellë edhe më tej diskriminimin në çdo aspekt. Nëpër rrugët e vendit shëtisin shumë të rinj, pa pasur as idenë më të vogël për ndonjë perspektivë për jetën e tyre. Ata s'kanë asgjë që mund të bëjnë. Fabrikat, që dikur lulëzonin në kohërat e Jugosllavisë, nuk janë më. Ky është rajoni ku mendohet se vetëm rreth pesë për qind e popullsisë punojnë në ekonominë formale.

Gjendja e rënduar, jo vetëm ekonomiko-sociale, ishte arsyeja më e madhe që kushtëzoi dukurinë shumë të përfolur të këtyre ditëve, azilin. Që nga koha kur BE hoqi regjimin e vizave për Serbinë, ky rajon u përshkua nga dukuria e një largimi masiv. Sipas mediave lokale, rreth 5.000 shqiptarë të Luginës së Preshevës u

larguan nga vendi – kryesisht drejt Belgjikës. Azilkërkuuesit janë "njerëz të rinj, të papunë dhe pa kurrfarë të hyrash... Ata janë të diskriminuar për dekada, prandaj edhe nuk shohin asnjë perspektivë.

Ata nuk ishin naivë, por zori i detyroi të mendojnë se edhe për fatin e tyre është nderur ndonjë rreze drite në tunelin e errët. Mbasi u kthyen, ata deklaruan të zhgënjyer se 'ishin mashtruar se u kishin thënë se në Belgjikë japin para, se do të gjenin punë, se ligji belg e parasheh këtë dhe se nga të gjitha ato nuk doli asgjë e vërtetë'.

Nuk ka qenë e lehtë nisja e atyre nevojtarëve. Dikush shiti lopën, dikush arin, e dikush edhe tokën. Shqiptarët vepruan asisoj sikur ta hidhnin fatin e tyre në bixhoz. E dhanë pasurinë e fundit të paktë që kishin vetëm e vetëm për të dalë nga amullia e mospasjes. Dhe kjo flet për dramaticitetin e gjendjes, flet për alarmin që është nderur.

Nëpër kuluare flitej se fajin për këtë e kishin agjencitë e udhëtimeve, se ato i thoshin popullatës lokale se Belgjika do t'iu ofronte azil politik, punësim, shtëpi dhe kompensim mujor në para. Harrohet se fajin më madhor e ka regjimi serb që e ka lënë këtë rajon të pazhvilluar, pa anashkalluar edhe një pjesë të fajit të partive politike shqiptare, përçarjet e të cilave arrijnë në absurditet.

Nëse edhe ka pasur dezinformata të tilla nga agjencitë, gjë që paraqet një turp për to, ngase nuk ndërtohet lum-

turia mbi fatkeqësinë e tjetrit, prapëseprapë, ato nuk mund të konsiderohen të vetmet fajtoare.

Tema e azilkërkuësve 'po mbyllet' me kthimin e tyre në vendlindje. Realisht askush nuk duhet ta kuptojë këtë si kaptinë të mbyllur me kaq. Përkundrazi, problemi i kësaj dukurie veç tash ka dalë në pah mbi sipërfaqe dhe tani e tutje duhet trajtuar seriozisht.

Tashmë partitë shqiptare në Luginën e Preshevës duhet të vetëdijesohen më shumë se kurdoherë që t'i unifikojnë forcat e tyre politike, për t'u bërë zë më i fuqishëm në artikullimin e të drejtave të shqiptarëve.

Ato duhet të fokusohen edhe jashtë vendit, në ndërkombëtarizimin e pozitës së rëndë të shqiptarëve në këtë rajon.

Se sa të etur janë preshevarët që të interesohet dikush për ta, e dëshmoi edhe vizita e ministrit të jashtëm shqiptar Ilir Meta. Mijëra njerëz mbushën sheshin qendror të Preshevës, për të prititur zv/kryeministrin Meta. Në një prononcim për mediat, z. Meta u shpreh se takimi me autoritetet dhe qytetarët e Luginës së Preshevës ishte pjesa më emocionuese dhe më e bukur e vizitës së tij në Serbi. Urojmë që emocionet e tij të vazhdojnë, për ta nxitur Shqipërinë për të bërë më shumë për këtë pjesë të ndarë të trungut të saj. Me këtë vizitë, shqiptarët e kësaj ane sikur u ngushëlluan pas zhgënjimit nga dukuria e azilit. Të paktën ekziston shpresa se për këtë rajon ka filluar interesimi nga jashtë. ■



Loja shumëfishtë me kufijtë shqiptaro-shqiptarë



Iljasa SALIHU

Kur flasim dhe shkruajmë për kufijtë në Ballkan, e veçanërisht për kufijtë në truallin shqiptar, automatikisht na kujtohet Konferenca e Londrës (1913), ku në mënyrë shumë të padrejtë, në favor të sllavëve dhe në dëm të shqiptarëve, Fuqitë e Mëdha i vizatuan kufijtë aty ku gravitonte interesi i tyre dhe kuptohet, në atë kohë, shprehën haptas një përkëdhelje ndaj sllavëve. Si rrjedhojë e kësaj, shqiptarët në vazhdimësi iu nënshtruan torturave, gjenocidit dhe asimilimit nga dora gjakatare e pangopur sllave. Pastaj, serbët, në kuadër të këtij diskriminimi, e shfrytëzuan privilegjin e tyre, duke krijuar edhe ata vetë kufij ndërmjet shqiptarëve, duke e ndarë vëllanë prej vëllait. Sllavët krijuan kufij të shumtë në truallin shqiptar, por ne, në pamundësi kohore dhe hapësinore, do trajtojmë vetëm çështjen e vendkalimeve në Bellanocë – Gjilan dhe Llojan – Miratocë, kufij, me të cilët pushteti serb i ndau tokat dhe arat shqiptare, duke ua pamundësuar dhe vështirësuar takimet mes vete. Në vend që një banor i fshatit Llojan të shkojë në Miratocë, të të afërmit e tij, për vetëm 2 kilometra, ai patjetër duhet t'i kalojë 35 kilometra, edhe e tërë kjo vetëm për qejf të pushtuesit sllav dhe atij të ashtuquajtur maqedonas. Serbia, në shenjë provokimi, e ka shtruar rrugën me asfalt deri te vija ku ndahet me Maqedoninë, kurse Maqedonia nuk ka hedhur as edhe një lopatë betoni në pjesën e vet, ose më mirë me thënë në pjesën shqiptare. Arsyeja është mjaft e qartë të të dy palët! Serbia e ka shtruar rrugën me asfalt vetëm sa për t'iu thënë shqiptarëve andej e këndeje kufirit se unë ua ofroj bukën te goja, por ju lë të vdisni nga uria, kurse Maqedonia as që lodhet për këtë çështje, sepse nuk është në interes të saj, por vetëm në interes të shqiptarëve. Fundja, në aspektin juridik, momentalisht ky vendkalim as që meriton të quhet kufi, sepse sikur të ishte kufi patjetër duhet të funksiononte. Për më tepër, në këtë punim në kuadër të

revistës "Paqja" do t'i japim përparësi prononcimeve që janë dhënë në media dhe prononcimeve që u dhanë ekskluzivisht për revistën "Paqja".

Çështja e vendkalimit Gjilan – Bellanocë (Kumanovë)

Rruga e vjetër Gjilan - Kumanovë, nga ana e Kosovës, tashmë ka përfunduar deri në kufi me Maqedoninë, ndërsa nga ana e pushtet të Maqedonisë, nuk është rregulluar as edhe një metër rrugë. Me asfaltimin e 15 kilometrave rrugë, nga Gjilani deri në fshatin Zhegër dhe Shurdhan, që janë në pikën kufitare me Maqedoninë, ka përfunduar faza e dytë e rregullimit të rrugës që shpie drejt fshatrave të Kumanovës. Republikës e Kosovës e ka mbaruar misionin për një kohë të shkurtër, ndërsa autoritetet e Maqedonisë as që bëjnë fjalë për rregullimin e rrugës 10 kilometra, nga fshati Sllupçan deri në

Bellanocë. Në Qeverinë e Maqedonisë, deri tani vetëm sa e kanë formuar Komisionin që duhet të merret me këtë punë, ndërsa për punimet në terren, as që është diskutuar ndonjëherë. Në Ministrinë e Jashtme të Maqedonisë bëjnë të ditur se, edhe përkundër faktit se punimet në terrenin kosovar tanimë kanë përfunduar, propozimi për hapjen e vendkalimit gjendet në Qeveri, dhe se është formuar Komisioni për këtë problematikë. Ata kanë fajësuar Qeverinë e Prishtinës për mungesën e formimit të Komisionit. Sekretari shtetëror pranë kësaj ministrie, Abdilkadër Mehmeti vlerësoi për media se propozimi për hapjen e vendkalimit kufitar Bellanocë - Stançiq është në qeveri dhe, si i tillë, ka kaluar në Sekretariatit dhe në Komisionin e sistemit politik pranë qeverisë. "Pra, propozimi për rrugën Bellanocë



Abdilkadër Mehmeti



Selami Mehemi

- Stançiq është futur në programin për menaxhimin e kalimeve të reja kufitare me shtetet fqinje. Si rezultat i kësaj janë formuar dy komisione nacionale me përfaqësues edhe nga resorë tjerë", - ka thënë Mehemi.

Nuk mund të thuhet se nuk punohet në këtë drejtim, por siç shihet prej prononcimeve të zyrtarëve dhe aktiviteteve drejt realizimit të këtyre projekteve natyrale, jetësimi në fjalë është ende i venitur dhe, si rrjedhojë e kësaj, autoritetet, kryesisht ata të Maqedonisë, fajin dhe neglizhencën mundohen ta arsyetojnë, duke ia hedhur këtë përgjumje autoriteteve kosovare. Por realiteti flet të kundërtën. Pikërisht, autoritetet kosovare kanë punuar konkretisht në lidhje me materializimin e kësaj arterie shqiptare.

Çështja e vendkalimit Llojan – Miratocë (Kumanovë – Preshevë)

Si rrjedhojë e kësaj problematike dhe dëshirës së zjarrtë të banorëve andej dhe këndeje kufirit, më mirë se askush tjetër këtë nevojë të qytetarëve, e shfrytëzuan partitë politike shqiptare deri në maksimum, duke e vënë në prioritetin e premtimeve të zakonshme boshe. Ishin të paktë ata njerëz që e kuptuan se ky vendkalim është vështirë të hapet, sepse shumë pak varet prej shqiptarëve, edhe pse në vazhdimësi shqiptarët e pësuan. Për më tepër, në lidhje me këtë çështje, flet Selami Mehmeti kryetari i bashkësisë



Këtu puqet kufiri serbo-maqedonas (shqiptaro-shqiptar) ku pjesa e asfaltaruar është në territorin e Serbisë, ndërsa pjesa e paasfaltaruar i përket Maqedonisë.

lokale në fshatin Llojan, i cili u shpreh: “Në këtë rast, më së shumti bën problem Serbia, për arsye se vendkalimi në Sopot dhe në Llojan është në dorë të saj, duke e përjashtuar rastin e Bellanocës dhe Gjilanit, sepse tashmë ato gjenden në duar të pushtetit kosovar dhe atij maqedonas. Por, trysnia e vazhdueshme që bëhet prej banorëve vendas, duke e alarmuar edhe faktorin ndërkombëtar, bëri që më 21 mars të këtij viti, të pritet të organizohet një takim në Beograd, mes autoriteteve serbe dhe maqedonase (shqiptare), ku do të diskutohet hapja e këtij kufiri, që i ndau dhe i ndan (kufizon) padrejtësisht shqiptarët me shqiptarët. Ne nuk do të ndalemi së kërkuari që ky kufi, edhe pse prapë nuk jemi të kënaqur që po e quajmë kufi, të hapet. Sidoqoftë, me hapjen e këtij kufiri, gjendja e rëndë ekonomike-sociale ndërmjet këtyre dy vendeve do të përmirësohet dukshëm. Pas 21 marsit, nëse nuk merren dot vesh, ne do të fillojmë aktivitetin tonë në terren, duke bllokuar rrugët kryesore që lidhin Maqedoninë me Serbinë dhe forma të tjera të ndryshme protestuese, që t’ia bëjmë me dije njëherë e përgjithmonë edhe faktorit ndërkombëtar se ne nuk lejojmë që në vend të 2 kilometrave të përshkojmë 35 kilometra së koti, që në

vend të liberalizimit të shkojmë në getoizim dhe që në vend të kontaktimit me miqtë tanë andej kufirit artificial të izolohemi tërësisht”, - tha Selami Mehmeti.

Po ashtu, në lidhje me këtë fenomen kufizues, u prononcua edhe mësuesi Zeqirja Islami, i cili një kohë të gjatë kishte punuar si mësues në fshatin Miratocë. Për këtë problematikë ai vlerëson se: “ky kufi, edhe pse artificial dhe improvizues, ka një rëndësi të jashtëzakonshme për të dy fshatrat. Të merremi vesh, kjo nuk është idealja, ndaj po e quaj kufi improvizues, por në mungesë të kësaj shkëlqesie, funksionimi i këtij kufiri do të ishte i mirëseardhur, sepse pavarësisht rrethanave dhe realitetit, në masë të konsiderueshme kemi nevojë për hyrje dhe dalje me vëllezërit e gjakut tonë. Deri sa ka qenë i hapur kufiri, kemi udhëtuar nëpërmjet këtij vendkalimi që ka qenë 2 kilometra larg vendit të punës në fshatin Miratocë. Tani duhet të kalojmë 35 kilometra për të arritur deri në këtë fshat. Ne si punëtorë të arsimit, gjatë kohës sa punonim në këtë fshat, kemi udhëtuar nëpërmjet këtij kufiri. Prej vitit 1999, kur u ndërpre hyrja – dalja përmes këtij kufiri, edhe ne ishim të detyruar ta ndërprisnim punën. Ishte e pamundur të udhëtohej 35 kilometra me një pagë simbolike, pagë e cila nuk i mbulonte as shpenzimet e rrugës. Me ndërprerjen e marrëdhënies të punës, që nga viti ‘99 për shkak të vështirësive të lartcekura, patëm një pauzë prej 5 vitesh. Pas 5 viteve u detyrova të konkurroj në fshatin tim, pra në Llojan dhe u punësova në punë me kohë të pacaktuar. Të punosh në fshatin tënd është nder dhe kënaqësi e madhe. Ndërkaq, sa i përket hapjes së këtij kufiri, unë kam shpresë dhe besoj në se shumë shpejt do të hapet. Tashmë rruga në anën e fshatit Miratocë është asfaltaruar dhe ka mbetur vetëm asfaltimi në fshatin Llojan. Por, hapja e këtij kufiri varet prej të dy palëve, edhe pse flitet se fajet për mos hapjen e këtij kufiri i

ka Maqedonia. Unë mendoj se pa pasur ndonjë marrëveshje dypalëshe, nuk do të ketë hapje të kufirit. Sidoqoftë, shpresat janë të mëdha dhe besoj se edhe bota është duke punuar në këtë drejtim, që tanimë të mos ketë kufi, popujt të jetë të lirë në komunikim dhe në qarkullim, të mos ketë ndarje, por të ketë bashkim”, - tha mësuesi Zeqirja Islami.

Dhe si përmbyllje për këtë çështje të rëndësishme morëm prononcim edhe prej kryetarit të komunës së Likovës, Sadulla Duraku, i cili shpreson të flitet dhe të punohet nga këndvështrime të shumta dhe të ndryshme, vetëm e vetëm që edhe faktori vendimmarrës të dorëzohet pranë këtij realiteti të natyreshëm. Ai u shpreh: “Me sa kam njohuri, që nga themelimi i kësaj komune, në mënyrë permanente është kërkuar që të hapen pikat kufitare në Bellanocë dhe Llojan. Tani, në moment, mund të them se sa i përket pikës kufitare në Llojan – Miratocë, me sa e di unë, Republika e Maqedonisë ka vullnet që të hapet kjo pikë, por nuk kanë gatishmëri përfaqësuesit e Republikës së Serbisë, ndërsa në pikën kufitare Zllakuçan - Stançiq ua bëj me dije se rruga është e zgjeruar dhe e tamponuar. Kemi projekt të përgatitur lidhur me këtë çështje, por deri më tani kanë munguar marrëdhëniet diplomatike mes Maqedonisë dhe Republikë së Kosovës. Me lidhjen e marrëdhënies diplomatike dhe caktimin e ambasadorëve në Shkup dhe Prishtinë, shpresoj se janë pjekur kushtet për të marrë ndonjë hap të këtillë, sepse mendoj se ekziston vullnet dhe interes në mes të dy shteteve”, - tha Sadulla Duraku.

Pra, në bazë të prononcimeve dhe realitetit të përditshëm, më në fund, si duket kemi filluar ta shohim një dritë në fund të tunelit të errët. ■



Zeqirja Islami



Sadulla Duraku



Muhamed J. KAJOLLI

Lufta rreth devesë

(10. xhemaduth-thani 36h, ose 4 dhjetor 656)

Aliu r.a., pas dy javësh qëndrimi në Basra, marshoi drejt Kufës, ndërsa nëna e besimtarëve u kthye në Mekë e shoqëruar nga dyzet ushtarë të

Aliut r.a. Ajo jetoi edhe shumë gjatë pas Betejës së Devesë, e dëshpëruar dhe e penduar për veprën e saj. Një ditë, pasi ishte lodhur për vdekje, e pyetën: A ke dëshirë që të varrosim te varri Pejgamberit s.a.v.s? - Jo, - u përgjigj. Unë kam bërë një gabim pas vdekjes së tij, prandaj më varrosni me motrat e mia te varrezat qytetit

Qëndrimi i Osman bin Hunejfit

Përfundimisht ata u nisën për në Basra.¹ Kur arritën afër Basrës, ushtrinë e treshes² e arritën korrierët e Osman bin Hunejfit³ për të marrë vesh synimin e kësaj ushtrie. Ata iu përgjigjën se qëllimi i tyre ishte vetëm të merrnin gjakun e kalifit Osmanit r.a. Korrierët e këshilluan Osmanin të largohej sa më larg kësaj trazire dhe i kujtuan hadithin e Pejgamberit s.a.v.s. mbi trazirat që do t'i kaplonin besimtarët.

Duke qenë se Ibën Hunejfi ia kishte dhënë besën Aliut dhe ishte informuar se ushtria e Aliut r.a. kishte dalë nga Medina, ai vendosi që të përfitojë kohë. Ai u përpoq disi ta pengonte ushtrinë e treshes të mos hynte në qytet. Ndërsa vetë mobilizoi ushtrinë e tij të qytetit dhe kështu tregoi besnikërinë e tij ndaj kalifit të vendit.

Nuk kaloi kohë e gjatë dhe Ibën Hunejfi nuhati përçarje brenda ushtrisë së tij, por nuk arriti t'i ndalonte të mos shkonin në përkrahje të treshes. Kjo përçarje kishte indikacione të gjakderdhjes së ndërsjellë, por Ibën Hunejfi reagoi me të shpejtë, duke e urdhëruar ushtrinë të dilte nga qyteti, për t'i dërguar ata në vendin e quajtur Merbad, vend në të cilin më pas u bë beteja e parë civile midis muslimanëve.

Beteja në Merbad

Dy ushtritë ishin përballë njëra-tjetrës. Po fillonin parapërgatitjet për sulm. Talha dhe Zubejri mbanin fjalimet e tyre për të ngritur moralin luftarak. Gjithashtu, edhe Aishja r.a. i ndihmoi këta të dy në motivimin e ushtarëve të saj. Fjalimet e tyre ndikuan thellë te një numër i madh i ushtrisë së Ibën Hunejfit dhe menjëherë iu bashkuan ushtrisë së palës së treshes.

Nuk dukej se dy ushtritë ishin në gjendje të luftonin njëra-tjetrën, sepse ndienin afërsinë reciproke vëllazërore,

por disa të pranishëm filluan të gjuanin me gurë, gjë që ndikoi në ngritjen e tensionit. Mes këtij nervozizmi, nga ushtria e Ibën Hunejfit, doli Ibën Kudame Es Sadij, i cili tha: "Oj, nëna e besimtarëve! Vallahi, vrasja e Osmanit është me më pak pasoja sesa dalja jote nga shtëpia dhe kështu e hipur lart mbi deve je në shënjestër të shigjetave. Nëse ke ardhur me dëshirën tënde kthehu në shtëpi, e po qe se të kanë detyruar, kërko ndihmë që të kthehesh" (Taberi:4/316, Dinuri 69)


Meqenëse nuk pati përgjigje, filloi një betejë e ashpër në të cilën nuk kemi të dhëna se sa prej tyre u vranë, por beteja u ndërpre për shkak të muzgut. Gjatë natës, një grup tjetër i ushtrisë së Ibën Hunejfit kërkoi prej tij që të jenë më të informuar, të dinë saktë nëse Talha dhe Zubejri e kishin tradhtuar Aliun, apo ishin betuar duke e pasur shpatën mbi kokë. Kështu vendosën që të mos dalin të nesërmen në fushë të mejdanit. U arit një armëpushim, i cili vlejti derisa u kthye nga Medina Kab Ibën Sewri.

Mendohet se në këtë betejë dhe në disa përlëshje të vogla që ndodhën në

qytet, derisa vinte mesazhi nga Sewri, thuhet se u vranë mbi një mijë besimtarë, midis tyre gjashtëqind besimtarë prej grupit që kishin marrë pjesë në vrasjen e Osmanit.

Sewri, në xhaminë e Pejgamberit, mori mesazhin se Talha dhe Zubejri paskan qenë nën presion, kur kishin dhënë betimin. Derisa Sewri ishte në Medinë, Ibën Hunejfit i vjen një letër nga Aliu (*Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij*) në të cilën thuhej: "...Qëllimi i tyre është bashkimi. Nëse ata duan shkarkimin tim, nuk kanë kurrfarë arsye, por nëse duan ndonjë gjë tjetër shohim e bëjmë." (Ejub: 238)

Qyteti i Basrës po vlonte. Aty mbretëronin mendime dhe thashetheme të ndryshme. Aishja r.a. shkroi disa letra, të cilat i dërgoi në Sham, Jemen e gjetkë. Prej tyre kërkonte ndihmë. Në to thoshte: "Nëse nuk i përgjigjeni ftësës sime, të paktën mos dilni në kra-hun tjetër. Ndërsa Zejd Ibën Sawhani thoshte: "Allahu e mëshiroftë nënën e besimtarëve! Ajo është urdhëruar nga Allahu të qëndrojë në shtëpi, ndërsa ne





të luftojmë. Ajo doli nga shtëpia, ndërsa neve na urdhëron të qëndrojmë mbyllur në shtëpitë tona!” (Ejub: 239)

Një xhuma, në Basra, një grup nga ushtria e Ibën Hunejfit, kërkoi prej tij të shkonte dhe të bisedonte me treshen për t'i dhënë fund kësaj anomalie, por ky refuzoi të dilte nga shtëpia, ndërsa ata e dërguan zvarrë përpara tyre.⁴ Kur Aishja e pa gjendjen e tij, kërkoi të lirohet menjëherë dhe të shkonte nga të dëshironte. Kjo ngjarje tregon se qyteti i Basrës nuk kishte më prijës. Ndërsa Ibën Hunejfi mori rrugën për në Kufe, që të takohej me Aliun r.a.

Pjesëtarët e treshes, vendosën që Abdurrahman Ibën Ebi Bekër⁵, të caktohej përgjegjës i departamentit të financave. Kur erdhi koha e ndarjes së pasurisë (në kushtet tona: rrogat mujore), Talha dhe Zubejri morën përgjegjësinë e shpërndarjes. Pasuria u shpërnda në mënyrë jo të barabartë dhe kështu u shkaktuan trazira të reja brenda në qytet.

Një grup i cili kishte marrë pjesë në vrasjen e kalifit Osman, u ngrit kundër treshes. Mendohet se grupit të Hakim Ibën Xhebelah⁶ u bashkëngjiten rreth 300 vullnetarë. Si duket të gjithë ata ishin prej atyre që kishin marrë pjesë në komplotin e para një viti në Medinë. Aty u krijua një rrëmujë, por aty, me të shpejtë, reagoi ushtria e treshes dhe kështu rebelët u larguan nga qyteti. Ushtria e treshes i ndoqi pas dhe kështu filloi një betejë e re. Kryesuesi i grupit rebel u vra, së bashku me mbi shtatëdhjetë persona të tjerë, ndërsa të tjerët u dorëzuan.

Pas këtij triumfi, Zubejri u emocionua dhe kërkoi nga ushtarët e tij që, aty me të, të qëndronin një mijë ushtarë, bile të marshonin në një vend tjetër që të pritnin ushtrinë e Aliut (*Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij*), por kërkesa e tij u refuzua.

Dalja e kalifit nga Medina

Kur Aliu (*Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij*) pa se fjala e tij nuk po dëgjohej dhe vendimet e tij po refuzoheshin, ai i anashkaloi hëpërhë vrasësit e Osmanit. Jo se ai do t'i falte ata, por, prioritet tek ai doli vendosja e rendit në shtetin e gjerë disa milionë kilometra katrorë. Pa u hamendur fare, mobilizoi ushtrinë e vogël, e cila ishte në Medinë dhe thirri vullnetarët të cilët do të niseshin drejt Shamit-Damaskut. “Në të djathtën e tij vendosi Ibni Abasin, ndërsa në të majtë Omer bin Ebi Selmeh, ndërsa në Medinë caktoi për zëvendës të tij Kith bin Abasin.” (Ibn Kethir:5/462)

Me të dolën vetëm nëntëqind vullnetarë ose më pak, ndërsa prej bashkëluftëtarëve të tij të Bedrit ishin katër. Disa thonë se ishin gjashtë. Pasi u largua nga Medina, kur kaluan katërqind kilometra, urdhëroi të pushonin në vendin e quajtur Er Rebdhe. Aty i erdhi lajmi se treshja ishte drejtuar nga qyteti i Basrës.

Ishte një lajm i hidhur për kalifin. Për këtë shkak, Aliu (*Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij*) e ndryshoi destinacionin e tij, sepse tani, i doli prioritet qyteti i Basrës. Para se të shkonte në Sham, ai do të duhej të sqarohet qartë dhe mirë me treshen. Për të shkuar në Basra, ushtria e kalifit marshoi drejt Al-Kadisijes, për të ndaluar një kohë më të gjatë në rrethinën e Kufës⁷. Ai e zgjodhi këtë rrugë, që është midis Shamit dhe Basrës, me qëllimin që të parandalonte përkrahjet e mundshme ndaj Muaviut dhe njëkohësisht të grumbullonte forca të reja. Vërtet, gjatë këtij marshimi, shumë fise dolën për ta përshëndetur kalifin, ndërsa shumë prej tyre i jepnin ushtarë dhe pasuri.

Me të arritur në territorin e Kufës, më saktë në Dhikar⁸, përpara ushtrisë së

kalifit doli korrieri i Ebu Musa Eshariut, i cili e pyeti për ardhjen e kësaj ushtrie dhe i tha: “Nëse jeni për paqe, Ebu Musa e do këtë, e nëse për luftë ai është kundër saj”. Meqenëse kalifi ishte për paqe, ai dërgoi dy persona⁹ që të merreshin vesh me Ebu Musanë,¹⁰ ndërsa atyre ju dha një letër. Meqenëse ata nuk arritën marrëveshje me të, Aliu dërgoi dy të tjerë¹¹, por edhe këta nuk arritën marrëveshje. Gjithmonë Aliu kërkonte marrëveshje paqësore, prandaj edhe kësaj here dërgoi edhe dy të tjerë¹² dhe ju dha me vete një letër tjetër, por kësaj radhe letra nuk ishte për Ebu Musanë, por e hapur për të gjithë banorët e Kufes: “... Vërtet, kam dalë ky vendi im si tiran ose si i shtypur, si kryengritës ose si ai kundër të cilit është organizuar kryengritje. Sidoqoftë, kujt t'i bie në dorë kjo letër ime e lus në emër të Allahut të Lartmadhëruar të më bashkohet. Nëse jam bamirës, ai do të më ndihmojë, e nëse bëhem keqzbërës, ai, në pajtim me gjykimin e Tij, do të provojë të më orientojë në rrugë të drejtë”¹³ (Er-Radi: f.287)

Mesazhi i Aliut r.a. për Aishen r.a.

Gjatë qëndrimit në Dhikar, kalifi dërgoi edhe Ka'ka Ibën Amrin për në Basra tek Aishja, Talha dhe Zubejri. Pasi ky mësoi se misioni i tyre ishte paqësor, ai u tha se në këtë mënyrë nuk arrihet paqja dhe vazhdoi: A nuk i doli në mbrojtje fisi i Hurkusit Ibën Zuhejrit,¹⁴ derisa ju e ndiqnit për ta vvarë¹⁵ dhe kështu dështuat. Për t'u hakmarrë ndaj një njeriu, vallë, duhet të vriten edhe mijëra të tjerë! Mendoni se kjo është rruga që duhet të ndiqet! Aishja i tha: “Si mendon ju se duhet bërë?” Përgjigjja e tij ishte e nivelit shumë të lartë, sa që të gjithë të pranishmit u kënaqën prej tij dhe i thanë, nëse kështu mendon edhe kalifi, ne jemi për paqe dhe për bashkim.

Para se të kthehej përfaqësuesi i Aliut, nga Basra kishte arritur Osman Ibën Hunejfe dhe prej tij kishte mësuar se çfarë kishte ndodhur në Basra. Gjithashtu mësoi se si ishte shpërndarë thesari i shtetit. I dëshpëruar tha: “O Allah më ruaj mua nga ajo me të cilën i ke sprovuar Talhan dhe Zubejrin.” (Ejub: 240)

Të pakënaqurit

Në ushtrinë e Aliut (*Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij*) tani ishte një numër i madh i grupit të vrasësve të Osmanit. Si duket,

këtij grupi i ish-in bashkëngjitur edhe ata të Kufës dhe, sipas para llogaritjeve të krerëve të komplotistëve, numri tyre brenda ushtrisë së kalifit ishte rreth 2500 luftëtarë. Ky grup u informua saktë se cili ishte qëndrimi i treshes ndaj tyre, ndërsa do të vendosin për të ardhmen e tyre pasi të kuptonin edhe qëndrimin e Aliut (*Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij*).

Pa humbur kohë, Aliu r.a. pasi u bind për qëndrimin dhe sinqertin e tyre, mbajti një fjalim, për të cilin u gëzuan të gjithë, me përjashtim të krerëve të komplotit, sepse nga fundi i fjalimit të tij tha: *"Të gjithë ata që kishin marrë pjesë në vrasjen e Osmanit të mos i bashkëngjiteshin ushtrisë së tij, që do të marshonte drejt Basrës"*.

Kjo fjali i irritoi komplotistët dhe ata u mblodhën për të vendosur mbi fatin e tyre. - Ta mbysim Aliun. Ai nuk ka vlerë më shumë se sa Osmani - tha Eshteri. Çifuti i "konvertuar" Ibën Sevda tha: -Nëse e vrasim, do të na vrasin menjëherë, sepse ata në numër janë më shumë se ne. - Të ikim nga kjo ushtri dhe të vendosemi në një vend ku do të forcohemi, - tha Galab Ibën Hajthem. - Keq, - ia priti sërish çifuti. - Më së miri do të ishte të vazhdonim rrugën me ta dhe kur të vijë momenti i bashkimit të dy ushtrive ta ndezim luftën.¹⁶

Shtëpia e Ubejdullah Ibën Zijadit

Pas fjalimit shpresëdhënës për bashkim, ditën e nesërme ushtria e Aliut u nis për në Basra. Gjithashtu, edhe ushtria e treshes kishte dalë nga Basra, e cila ishte në pritje të ushtrisë së kalifit. Takimi i përfaqësuesve duhej të ishte shtëpia e Ibën Zijadit. Takimi i parë midis emisarëve të Aliut (*Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij*) dhe treshes u bë në Xhumadel-Ahire të vitit 36 h. Takime të njëpasnjëshme u bënë midis dy palëve, për tri ditë me radhë, derisa arriti ushtria e Aliut (*Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij*). Gjatë marshimit të ushtrisë së kalifit r.a. për në Basra, iu bashkëngjiti edhe El-Ahfaf Ibën Kajsi.¹⁷ Ndërsa shumë të tjerë i bënë pyetje Aliut r.a.¹⁸

Kështu ushtria e Aliut arriti numrin mbi njëzet mijë ushtarë. Me të arritur Aliu (*Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij*) në rrethin e qytetit të Basrës, dërgoi përfaqësuesin e tij për të mësuar nëse ende vazhdojnë t'i qëndrojnë besnik marrëveshjes së tyre të zhvilluar me Ka'kan.

Përgjigja erdhi pozitive, prandaj kishin të drejtë të gëzoheshin. Dita e bashkimit u caktua e nesërmja. Ajo natë dukej shumë e gjatë për të dy ushtritë, por ajo dukej edhe më e gjatë për komplotistët.

Lufta rreth Devesë

Komplotistët në agimin e nesërm sulmuan bashkëluftëtarët e tyre që i kishin aty pranë. U përhap lajmi se sulmuesit ish-in ata të ushtrisë së treshes. Kështu një grup tjetër sulmoi kampin e ushtrisë së treshes dhe po ashtu shpërndanë lajmin se ish-in nga ushtarët e Aliut r.a. Ashtu të përgjumur dhe të painformuar mirë, nuk arritën të marrin urdhrat e duhur nga kalifi i tyre. Lufta mori flakën. Aliu r.a., edhe ky i painformuar se çfarë i shtyri të luftonin, po mendohej t'i parandalonte, por zëri i tij nuk dëgjohej. U shndërrua një katrahurë e vërtetë. Vështirë të dëgjohej zëri i dikujt që drejtonte ndonjë çetë ushtarake.

Shumica e krerëve të sahabëve të mëdhenj kishin dëgjuar disa prej paralajmërimeve të Muhamedit s.a.v.s. për trazirat që do të ndodhnin dhe e dinin se cila palë ndërluftuese kishte të drejtë. Një prej paralajmërimeve të Muhamedit s.a.v.s. ishte edhe veterani Amar Ibën Jasir.¹⁹ Gjatë betejës, përpara Amarit doli Zubejri, ndërsa ai përpiqej ta vriste Zubejrin, ky i fundit mbrohej, por nuk e godiste atë, sepse kishte dëgjuar Muhamedin s.a.v.s. se atë (Jasirin): *"do ta vrasë grupi i padrejtë"*.

Aliu r.a. dërgoi një ushtar për të

Talha dhe Zubejri. Prej tyre kërkoi takim urgjent. I pari arriti Zubejri, ndërsa biseda u zhvillua, duke qenë të hipur në kalë. "Po t'i mor Zubejri, a nuk të kujtohet dita kur ne ishim me Pejgamberi e Allahut derisa po kalëronim përgjatë trojeve të fisit Ganem?" 'Po', - ia ktheu. "A të kujtohet kur ai buzëqeshi gjatë një shikimi mbi mua, e ti the se i biri i Ebu Talibit nuk heq dorë nga krenaria, ndërsa ai s.a.v.s. të tha: *"O Zubejri! Ke për ta luftuar Aliun, ndërsa ti do të jesh i padrejtë ndaj tij"*. Zubejri ofshau dhe tha: 'Ah, sikur të më kujtohej vetëm një çast, kurrë nuk do të të luftoja'. Menjëherë u zhvesh dhe doli nga radhët e betejës. (Dinuri: 72) Por, për fatin e tij, atij iu qep mbrapa Amër Ibën Xhurmuz dhe e mbyti larg betejës, derisa ai ishte shtrirë të pushonte në Luginën e Egërsirave.

Më pas u takua edhe me Talhan dhe i tha: 'More gruan e Pejgamberit s.a.v.s. në luftë, ndërsa tënde e le në shtëpi, a nuk ma dhe besën!?' 'Po, por nën tehun e shpatavë, - ia ktheu. Aty u këmbyen disa fjali të tjera. Përfundimi ishte se të formonin një komision që do të gjykonte saktë. (Dinuri: 75) Derisa ish-in ulur dhe po diskutonin për komisionin, dikush nga pjesëtarët e Aliut r.a. hodhën shigjeta nga larg. Ai që pësoi ishte Talha, të cilit një shigjetë i hyri thellë në trup. Ashtu i plagosur rëndë, i hipi kalit dhe ia dha vrapit pa kontroll, ndërsa atij ju qep shërbëtori i tij, i cili e ndaloi kalin dhe e dërgoi për në qytet. Nga gjakderdhja e madhe edhe Talha vdiq.



Luftimet vazhdonin. Kur Aishja e pa se po derdhej gjak, Kab Ibën Sewrit ia dha Kur'anin që t'i thërriste për armëpushim, por për fat të tij, me të marrë Kur'anin, Sewrit i doli përpara një grup rebelësh nga Ibën Sevda dhe e mbytnë menjëherë. Ata e kuptuan se në vigun e devesë, brenda ishte nëna e besimtarëve dhe filluan ta godisnin me shigjeta. Njerëzit po luteshin që të ndërprisnin gjuajtjet ndaj nënës së besimtarëve, por më kot. Ibën Sevda dhe grupi i tij, nuk dëgjonin fare. Ata e donin Aishen të vdekur.

Ushtarët buçisnin, ndërsa zëri shkoi te kalifi i muslimanëve, i cili iu përgjigj ftesës së tyre me të shpejtë. Përreth devesë u vranë shumë njerëz. Secili që shkonte të kapte litarin e devesë për ta tërhequr larg nga beteja, vritej. Njëri prej tyre që shkoi ta kapte devenë ishte Abdullah Ibën Zubejri. Aty pranë tij qëllloi Eshter en Nuhaui, i cili e goditi me shpatë në kokë dhe e plagosi rëndë, por edhe Zubejri ia ktheu dhe e plagoi atë. Aty Abdullahu mori mbi tridhjetë të prerë të shpatës. Kur Aliu arriti afër, pa se vigu mbi deve ishte bërë si trup iriaqi dhe kërkoi që ta godisnin devenë me shpatë dhe ajo ra përtokë. Me këtë veprim, u sigurua hëpërhë jeta e nënës së besimtarëve nga breshëritë e shigjetave. Pastaj u dëgjua zëri i tellallëve të Aliut: "Të mos ndiqen të zmrapsurit, të mos vriten të plagosurit. Ai që e lëshon armën dhe do të mbyllet në shtëpi do të jetë i shpëtuar." (Jakubi: 2/183) Kështu vepruan edhe ata të ushtrisë së treshes dhe kështu filloi një qetësi midis palëve ndërluftuese.

Pasi ra nata të gjithë u kthyen në qytet, ndërsa Aliu r.a. të gjithë besimtarëve të vrarë ua fali namazin e xhenazes pa dallim se cilës anë i përkisnin. Për të, të gjithë ishin besimtarë dhe të gjithë ishin viktime e trazirës, të cilën askush nuk e dëshironte prej tyre. Aliu r.a., pas dy javësh qëndrimi në Basra, marshoi drejt Kufes, ndërsa nëna e besimtarëve u kthye në Mekë e shoqëruar nga dyzet ushtarë të Aliut r.a. Ajo jetoi edhe shumë gjatë pas Betejës së Devesë, e dëshpëruar dhe e penduar për veprën e saj. Një ditë pasi ishte lodhur për vdekje e pyetën: A ke dëshirë që të varrosim te varri i Pejgamberit s.a.v.s? - Jo, - u përgjigj. "Unë kam bërë një gabim pas vdekjes së tij, prandaj më varrosni me motrat e mia tek varrezat qytetit."²⁰ (Shelebi: 1/ 624)

1 Ishte hapur një debat i gjatë midis krerëve të ushtrisë së Aishes. Mervan Ibën el Hakem: pse nuk e thërrisni popullin e Basrës në referendum që të jeni të sigurt, janë me Aliun, a me ju. Talha: 'Ne dimë se kjo qëndër ia ka dhënë besën Aliut, prandaj e kemi vështirë të gjykojmë. Pse së provoni njëherë?' Zubejri ia ktheu: -Ajo që na bën të dyshimtë është edhe nga forca e prefektit të Aliut (Osman Ibën Hunejfit). Në këtë bisedë ndërhyri Velid Ibën Ukbete: 'Nëse vlerësimet tuaja qëndrojnë atëherë jeni në rrugë të mbarë, por nëse nuk qëndrojnë, atëherë jeni duke gabuar, ndërsa ju sot jeni më të fuqishëm se nesër, prandaj veproni'. Mervani: 'T'ju them të drejtën unë mendoj se shkuarja në Sham është më e mirë, por unë do të përkrah atë që do të vendosni ju, edhe sikur të shkatërrohem'. Seid bin As, tha: 'Unë po shkoj në shtëpi dhe më thërrisni pasi të keni marrë vendimin'. Përgjigja përfundimtare doli nga Talha, i cili ju drejtua Zubejrit: 'Më e mira është të kërkojmë nga Abdullah Ibën Omeri të thërrasë njerëzit në referendum'. Por Abdullahu nuk e pranoi këtë, duke ju thënë: 'Kërkoni nga unë që të dalë nga shtëpia dhe të dalë kundër Aliut? Njerëzit sot tradhtohen lehtë, shiten për një dinar ose dërhem. Ndërsa unë e kam ndarë mendjen që të qëndroj larg trazirave dhe iku prej tyre'. (Dinuri: 59)

2 Me treshen kam për qëllim prijësit e ushtrisë së Mekës (Aishja, Talha dhe Zubejri r.a.)

3 Imran Ibën Hasain dhe Ebu el Esved ed Duel- Ejjub: 236

4 Sipas Dinurit f. 69 dhe Taberit 4/318. Një grup nga ushtria e treshes shkuan në shtëpinë e Ibën Hunejfit. Atje i mbytnë rreth dyzet rojtarë të tij. E kapën Ibën Hunejfin, ia shkulën mjekrën dhe flokët dhe e dërguan zvarrë tek Aishja r.a.

5 Subhanallah, Abdurrahmani i cili kontribuonte në ushtrinë e Aishes ishte i vëllai i Muhamedit, i cili kishte marrë pjesë në komplotin e kalifit Osman dhe ishte me ushtrinë e Aliut r.a.

6 Hakim Ibën Xhebelah, ishte njëri prej vrasësve të drejtpërdrejtë të kalifit Osman r.a..

7 Populli i Kufes ia kishte dhënë besën Aliut, por kalifi duhej të ishte i kujdesshëm dhe strateg. Qyteti i Kufes është në mes të Irakut të sotëm, ndërsa Basra në jug të Irakut të sotëm.

8 Dhikar, është një vend i njohur për shumë beteja që janë zhvilluar më parë midis persëve dhe bizantinëve. Është një vend që është midis Kufes dhe Basrës.

9 Muhamed Ibën Ebi Xhafer dhe Muhamed Ibën Ebi Bekr.

10 Ebu Musa El Esharij ishte njëri i dashur. Populli i Kufes kishte respekt për të, prandaj edhe Aliu ia vazhdoi mandatin për shkak se ai i ishte betuar atij për besnikëri. Por si duket, qëndrimi i tij do të ndryshonte pasi dolën në shesh trazirat. Ai do të mundahej të qëndronte larg trazirave duke shprehur lojalitet ndaj kalifit, por në anën tjetër nuk dëshironte ta ndihmonte atë me ushtarë. Ai u mundua ta bindte popullin që të mbyllej nëpër shtëpitë e veta. Pas disa delegacioneve që ia dërgoi Musait, në fund, populli do t'i bindej fjalimit të Hasanit, të birit të kalifit, se e drejta qëndronte me kalifin e tyre. Hasani kthehet te babai i tij me 9 000 vullnetarë, apo 12 000 sipas një versioni tjetër.

11 Eshter en Nuhaui dhe Ibën Abasin.

12 Hasanin, birin e tij dhe veteranin Amar Ibën Jasirin.

13 Bisedat transmetohen në Librat e: Ejubit, f. 239-243, Dinurit, f. 65-68, Nehxhul Belaga, f. 287).

14 Hurkus Ibën Zuhejr, njëri prej komplotistëve, që kishin marrë pjesë në vrasjen e kalifit Osman.

15 Fisi Rebia dhe fisi Mudor ishin betuar se do të luftonin kundër ushtrisë së Aishes r.a., në mbrojtje të Hark-ut.

16 Për më shumë rreth këtyre ngjarjeve mund të lexoni në Tarih elTaberi 4/ 313-362.

17 El-Ahnafi ishte kryeplaku i fisit dhe njëri prej mbrojtësve të Hurkus Ibën Zuhejrit, ndërsa mbrapa tij ishin 6 000 vullnetarë të tjerë. El Ahnafi ia kishte dhënë besën Aliut vetëm atëherë pasi ishte këshilluar me Aishen, Talhan dhe Zubejrin, në ditët e rrethimit të rezidencës së Osmanit r.a. Pasi ishte kthyer në shtëpi, kishte mësuar se treshja kishte ardhur në Basra për të marrë hakun e Osmanit r.a. Ai tregon: "Ngela në udhëkryq, nuk dija se në cilin anë të shkoja, kujt t'ia jepja të drejtën! Vendosa të shkoja me Aliun për shkak se kisha dëgjuar Ebu Bekrin r.a. të thoshte se ai kishte dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s.: "Nuk ka shpëtim një popull që ia beson drejtimin e tij një gruaje"(Buhari, Ejub: 245, Dinuri, 71)

18 Përgjigjet e Aliut janë konsideruar si shumë të rëndësishme për gjeneratat e pasme të umetit të Muhamedit s.a.v.s., sepse, pos tij, askush nuk do të dinte të drejtonte më mirë umetin, i cili ishte sprovuar me ngjarje shumë të mëdha. Vendimet dhe gjykimet e Aliut r.a. janë të vlefshme edhe në ditët e sotme. Disa nga pyetjet:

Nëse ata nuk duan paqe, cili është vendimi ynë? - Për sa kohë ata nuk na trazojnë as ne nuk i trazojmë.

Por nëse ata nuk na lënë rehat? - Atëherë do të detyrohemi të mbrohemi.

A kanë edhe ata të drejtë, sikurse edhe ne? - Po, - tha Alia r.a.

A kanë bazë këta që kërkojnë gjakmarrjen, nëse e bëjnë për hir të Allahut? - Po, - ia ktheu Aliu r.a.

Po cili do të jetë halli ynë dhe i tyre nëse vjen deri te më e keqja? - Shpresoj tek Allahu që secili që do të vritet e që e ka zemrën e pastër do të hyjë në xhenet... (Ejub: 244) ...e shumë të tjera...

19 Mendohet se në këtë kohë Amari ishte nëntëdhjetë e tri vjet.

20 Shelebiu mendon se muslimanët duhet të marrin guxim dhe t'i qartësojnë gjërat një herë e mirë dhe saktë. Ajo çfarë ka ndodhur në atë kohë nuk duhet lënë e hapur, sepse kjo formë e dëmton shoqërinë muslimane. Ai thotë se dikush patjetër duhet të jetë përgjegjës për betejat e përgjakura që u zhvilluan, derisa ishte Aliu r.a. kalif. Ai mendon se figura ose personi kryesor, i cili që shkaktar i përplasjeve midis muslimanëve ishte Abdullah Ibën Zubejri. Për këtë person ai sjell edhe një rast, të cilin e ka marrë nga Ibën Hazmi. Vitet e fundit, Aishja r.a. e kishte marrë shumë inat Abdullahun, sepse kishte mësuar për ambiciet e tij, por për ta treguar urrejtjen e saj për të, ka thënë: "Një ditë Aishja kishte shpërndarë sadaka. Si duket Ibni Zubejri e paska poshtëruar atë, duke thënë se ajo po shpërndan nga pasuria e nënës së tij dhe e paska gjuajtur me gurë. Aishja qenka nervozuar sa s'bën më dhe ishte betuar se nuk do t'i fliste më kurrë." (Shelebi, f. 1/625)

Ankthi i tërmeteve përfshin edhe Kosovën



Agim AVDIU

Përshtypja se numri i tërmeteve është shtuar ka tërhequr dhe alarmuar vëmendjen e njerëzve. Por shkencëtarët thonë se, me gjithë përshtypjen e krijuar, atyre ende u duhet të provojnë se numri i tërmeteve në botë është rritur. Toka përbëhet nga katër shtresa: nga shtresa e brendshme, shtresa e jashtme, manteli dhe korja. Korja dhe manteli i sipërm krijojnë litosferën, një shtresë me trashësi 50 km dhe kjo përbëhet nga të ndara që quhen pllaka tektonike. Këto pllaka dihet që e ndryshojnë pozicionin dhe kanë shumë defekte. Shumica e tërmeteve ndodhin përgjatë vendeve me defekte. "Pllakat mund të lëvizin horizontalisht ose vertikalisht, në atë mënyrë që një pllakë lëviz nën një tjetër". Shumica e tërmeteve ndodhin në zonën e Paqësorit, të njohur si Rrethi i Zjarrit, një rajon që rrethon bregdetin e Oqeanit Paqësor përgjatë vendeve si Zelanda e Re, Japonia, Alaska dhe Kili. Modelimet sizmologjike dhe kalkulimet matematikore të shtypjeve dhe të presioneve kanë treguar një rritje të presioneve në pjesë të tjera të botës, pasi ndodh një tërmet. Kjo, e kombinuar me të dhëna statistikore ka krijuar një teori që tërmetet e mëdha, si ato të fundit në Haiti dhe Kili, mund të rrisin presionin në një pjesë tjetër të pllakës tektonike dhe ta ulin në një pjesë tjetër, duke shkaktuar potencialisht një tërmet pasues në një pjesë tjetër të botës. Tërmeti i fuqishëm që goditi Haitin ka qenë i barabartë me 35 bomba atomike, është shprehur sizmologu i njohur amerikan, Roxher Mason. Lëkundja prej 7,0 ballësh që ndodhi në një zonë me aktivitet të lartë sizmik, ishte e ngjashme me atë që ndodhi në vitin 1751 në San Andrea të Ka-

lifornisë. Kjo pasi tërmeti u shkaktua në një lëvizje horizontale të pllakave tektonike dhe ka qenë i cekët. Bilanci i viktimave mund të ishte edhe më i madh se 100 000 viktima. Një tërmet tjetër i fuqishëm ka tronditur Kilin. Magnituda e tij ishte 7.2 e shkallës Rihter dhe ishte më i fortë se tërmeti i 27 shkurtit, ku dhjetëra persona vdiqën, shumë shtëpi u shkatërruan dhe vendi kaloi një gjendje të jashtëzakonshme. Ky ishte tërmeti më i fuqishëm që ka goditur vendin në gjysmë shekulli. Të paktën 200 persona kanë vdekur dhe ka pasur dhe dy dridhje të fuqishme toke pas tërmetit. Tërmeti i fuqishëm prej 8.8 ballësh që goditi Kilin ka shkakuar zhvendosjen e qytetit Konsepsion për tri metra në drejtim të perëndimit. Tërmeti ka gjeneruar një cunam dhe u bënë paralajmërime për gjithë rajonin e Paqësorit nga Meksika, deri në Zelandën e re dhe Japoni. Një tërmet i madh tronditi edhe Turqinë Lindore. Ai arriti shkallën 6.0 sipas Rihterit dhe ka marrë jetën e 57 vetëve. U shkatërruan shumë shtëpi. Qindra të mbijetuar nga tërmeti në Turqi e kanë kaluar natën në tenda emergjence dhe përreth zjarreve. Banorët e zonave të goditura janë porositur të mos hyjnë në ndërtesat e dëmtuara, pasi mund të rrezohet si pasojë e dridhjeve të reja. Pas tërmetit kanë pasuar afro 40 dridhje të lehta. Turqia ndodhet në një zonë me aktivitet të lartë sizmik. Mbi 17 mijë vetë vdiqën nga një tërmet i fuqishëm në lindje të Stambollit, në gusht të

1999. Edhe Kroacia nuk është e kursyer nga tërmetet.

"Nëse shikojmë botën përgjithësisht, kohëve të fundit vërtet po ndodhin gjithnjë e më shumë tërmete. Ata janë gjithnjë e më të fuqishëm, ndërkaq ky trend është i dukshëm edhe në rajonin tonë", - pohon Vlado Kuk, udhëheqës i Shërbimit Sizmologjik të Kroacisë. Sipas Kuk, në vitin 2008, në Kroaci u ndien 29 tërmete, vitin e kaluar 66, ndërkohë që vetëm gjatë dy muajve të parë të këtij viti plot 18. Gjersa tërmete të mëdha në Tajvan, Kili, Haiti, Turqi vazhdojnë të dominojnë titujt e lajmeve, tërmeti, por për fat të mirë me fuqi jo shkatërrimtare, goditi edhe vendin tonë. Një tërmet rreth pesë ballësh, sipas shkallës Rihter, ka goditur Kosovën. Sizmografët e Rrethit Sizmologjik të Kosovës detektuan tërmetin me epiqendrë 6 km në juglindje të Istogut. Tërmetin e kanë ndier banorët e rrethit të gjerë të Pejës, Istogut dhe tërë territori i Kosovës. Ndërkohë, në rajonin e Mitrovicës janë regjistruar disa dëme materiale nëpër shtëpi banimi dhe ndërtesa kolektive. Në vitin 2002, në Kosovë, në rajonin përreth Gjilanit ishte regjistruar tërmet me intensitet prej 5,3 ballë sipas Rihterit. Kuvendi i Kosovës ndau atë kohë 5 milionë euro. Komuna e Gjilanit ishte përfituesja më e madhe për shkak se edhe dëmet ishin më të mëdha. 3 milionë e 700 mijë euro u dërguan në buxhetin e kësaj komune. Lajmi për tërmetin që ka goditur territorin e Kosovës është dhënë menjëherë në shumë media të rajonit. Mediat serbe raportuan se shkalla e intensitetit ka qenë 4.5 shkallë sipas Richtertit.

"Epiqendra e tërmetit ka qenë në rajonin e Zubin Potokut, 15 kilometra në veriperëndim nga Mitrovica", - ka thënë zëvendës-drejtori i Entit Sizmik të Serbisë, Branko Dragičević për radion "B92". Edhe pse tërmetet nuk parashikohen, sizmologët thonë se Kosova është vend me aktivitet të lartë sizmologjik dhe rreziku është gjithmonë i pranishëm. ■



Pllakat tektonike

Korja dhe pjesa e sipërme e mantelit të Tokës formojnë litosferën

1. Litosfera është e ndarë në pllaka që janë vazhdimisht në lëvizje mes tyre
2. Këto pllaka me peshën e tyre rëndojnë në nënshtrësas e rxehta
3. Njëkohësisht, shkëmbinjto e shkrinë në disa pika tentojnë të ngjiten në sipërfaqe



Vargmalet

Në pikat e fërkimit mes dy pllakave mund të ndodhin tërmete apo fenomene të tjera sizmike. Mund të formohen vullkane apo vargmale




Andet, në ekstremitet të pllakës Nazca janë formuar në këtë mënyrë

1. Malet në përgjithësi formohen kur dy plaka ndeshen, më e forta rëshqet poshtë tjetrës dhe ajo që ndodhet sipër përkulet dhe formon malet

Vullkanet

1. Kur dy pllaka tentojnë të largohen, në litosferë hapet një lloj plaje



2. Nga nënshtrësas e rxehta dalin në sipërfaqe gazra, avuj dhe masa e zjarrtë (magma)

Haiti, Japonia dhe Kili. Toka vazhdon të dridhet. **Pllakat ku mbështetet bota përplasen vazhdimisht me pasojë të frikshme.** Tërmete me përmasa katastrofike dhe cuname: Natyra duket se është çmendur. Çfarë po ndodh me tokën? Ja si t'i interpretojmë mesazhet që natyra na dërgon

Tërmetet

Kur toka nis të dridhet

Kuran 99:1

Toka po lëkundet. Por ajo që të shkakton më shumë frikë dhe ankth është shpeshësia me të cilën po ndodhin këto fenomene.

Më parë Haiti, pastaj Kili dhe Japonia. Pafuqia e atyre që përpiqen të bëjnë parashikime, po duket më e rritur se kurrë pavarësisht shekujsh të tërë studimesh, përpjekjesh dhe momenteve të rralla të suksesit. Sipas statistikave, tërmetet e sotme janë më fatale se në të kaluarën. Në vitin 2009, aktiviteti sizmik në botë mori jetën e 1700 personave. Një vit më parë, më 2008, gjendja ishte akoma më e keqe: me 80 mijë viktima të gjitha të përqendruara në rajonin kinez të Sichuanit (tërmet 7.9 ballë). Këtë vit nga Haiti (tërmet 7 ballë) në Kili (8.8 ballë) numri i viktimave e kaloi shifrën 200 mijë. Tërmeti i Kilit është një sekuençë ekzemplare e asaj që ndodh kur një kataklizëm nis poshtë këmbëve. Ishte ora 3.34 e 27 shkurtit kur në Konsepsion brenda pak sekondave u çlirua energjia e akumuluar në tokë përgjatë thuaspe dy shekujve. Fuqia e tërmetit kilian - që nga fillimi i shekullit 20 është kaluar vetëm katër herë të tjera - u krahasua me shpërthimin e njëkohshëm të mijëra bombave bërthamore. Valët sizmike nisën udhëtimin drejt kores së tokës me një shpejtësi 5 kilometra në sekondë. Të gjithë, rreth 4 mijë sizmografet e vendosur në planet u lëkundën njëkohësisht. Fundi i detit u ngrit me një metër duke shkaktuar dallgë të mëdha. Valët e cunamit nisën të përhapeshin përgjatë Paqësorit me shpejtësinë e avionit: thuaspe 900 kilometra në orë. Fatmirësisht, muret e ujit nuk arritën ndonjë lartësi të madhe (maksimumi dy metra) duke mos shkaktuar dëme. Një tjetër lajm i mirë është se Kili, ndryshe nga Haiti, është një vend shumë i përgatitur në këtë fushë, madje ka edhe një legjislacion rigoroz për inxhinierinë antisizmike. Faji i rritjes së numrit të viktimave si pasojë e tërmeteve nuk është i tokës, që vazhdon të dridhet ashtu siç ka bërë gjithmonë gjatë historisë

Orogjeneza
Ngjeshja e pllakave provokon formimin e vargmaleve

Korja e tokës
Është shtresa solide e jashtme me një trashësi që shkon nga 4 në 15 kilometra nën oqeano dhe arrin deri në 70 kilometra përgjatë vargmaleve


Pllakat divergjente
Dy pllakat largohen dhe nga nëntoka del magma që formon koren e re

Pllakat konvergjente
Dy pllakat përplasen dhe njëra shtyn drejt tjetrës duke e fundosur. Në zonën e përplasjes (subduksionit) mund të ndodhin tërmete të tmerrshme

Magma në mantel
Mendohet se pllakat tektonike shkaktohen nga rymat e shkaktuara në brendësi të mantelit

Matja
Intensiteti i tërmeteve matet me sizmometër

Shtresa poshtë vazhdon nën tokë dhe formon një zgjerim të thellë poshtë, se malet kanë një pjesë që shkon poshtë po aq të madhe sa pjesa e dukshme mbi tokë




LITOSFERA
150 km
Përbëhet nga pjesa solide e jashtme e mantelit të sipërm dhe kores

Cunami
Kur një tërmet ndodh në det, ekziston rreziku që të krijohet një tsunami. Lëvizja e fundit të detit shkakton daligje gjigante të ujit në sipërfaqe

"Filuska" në oqean krijon valë që largohen nga epiqendra e tërmetit për jashtë me një shpejtësi që i kalon 900 km/h

Afër bregut, në thellësi të ulëta daliga e ul shpejtësinë, por bëhet shumë herë më e lartë



Si gjeneron
A. Një tërmet nënutor gjeneron një seri cunamesh (daligjesh anormale)

B. Valët gjigante përshkruajnë oqeanin me një shpejtësi deri në 800 km/h


C. Zvogëlimi i thellësisë e bën daligjen shumë herë më të lartë

Tërmetet

Kur pllakat shtypin njëra-tjetrën mund të ndodhë që e para të rrëshqasë poshtë të dytës. Ky fenomen quhet subduksion. Kjo ndodhi pikërisht në Kili ku pllaka Nazca rëndoi ndaj asaj të Amerikës së Jugut (ku gjenden Andet 0 dhe u zhyt poshtë saj)

Lëvizja e pllakave shkakton tërmetet. Lëvizja e tyre mund të jetë konvergjente, divergjente dhe laterale

ASTENOSFERA
450 km
Astenosfera përbëhet nga masa e zjarrtë brumore që quhet magmë. Mbi të "notojnë" pllakat tektonike që shtyhen mes vetes duke krijuar çrregullime nga më të ndryshmet në sipërfaqen e tokës, si vullkanet dhe tërmetet.



Manteli i sipërm
600 km

Manteli i poshtëm
2300 kilometra

Bërthama e jashtme
2270 km

Bërthama e brendshme
1216 km

Korja
Korja e tokës ka një trashësi që shkon nga 60-80 kilometra. Ajo ndahet në koren oqeanike dhe kontinentale

së saj. Faji është i rritjes së numrit të njerëzve në planet dhe përqendrimi i tyre në qytete të mëdha. Ata që "vrasin" nuk janë tërmetet, as ata më të dhunshmit. Janë ndërtesat, sidomos ato të reja të ndërtuara me çimento të një cilësie të ulët dhe të vendosura njëra pas tjetrës në zonat e botës në zhvillim. Një ditë para tërmetit kilian, më 26 shkurt në Okinava, një lëkundje me të njëjtën magnitudë të ishullit karabik, përluadsi pa asnjë viktimë, duke treguar edhe njëherë se përballë një lëkundjeje të dhunshme ajo që bën diferencën mes jetës dhe vdekjes është fortë-

Sipas statistikave, tërmetet e sotme janë më fatale se në të kaluarën. Në vitin 2009, aktiviteti sizmik në botë mori jetën e 1700 personave. Një vit më parë, më 2008, gjendja ishte akoma më e keqe: me 88 mijë viktima të gjitha të përqendruara në rajonin kinez të Sichuanit (tërmet 7.9 ballë)

sia e betonit me të cilën është ndërtuar godina. Tërmeti japonez u "zgjodh" me pak marrje mendsh për banorët e qyteteve të mëdha. Nuk mund të thuhet e njëjta gjë për atë që ndodhi në Kili. Dy pllakat e Nazcas dhe Amerikës së Jugut kanë në "trup" një fuqi të tillë sa kanë kontribuar në formimin e Andeve në të kaluarën. Prej mijëvjeçarësh përplasen si dy desh kokëfortë, duke përparuar me ritëm të ngadalë, por shumë domethënës rreth 80 milimetra në vit, me "turirin" e Nazcas e detyruar të zhytet drejt fundit duke gërmuar në magmën e ngrohtë që formon zonën amerikanojugore. Gjeologët e quajnë këtë proces subduksion. Sa më shumë ajo zhvillohet në heshtje aq më shumë rrezikon të akumulojë "zemërim", duke e nxjerrë të gjithë energjinë e saj në një tërmet të madh të fuqishëm. Të shtunën në mëngjes në 3.34, askush nuk mund ta përcaktojë përse atë ditë dhe atë orë, pllakat shpërthyen tensionin e tyre. Që prej vitit 1835, Konsepsioni jetojnë me frikën e tërmetejeve të dhunshme. Në zonë, pak kohë pas tërmetit

të atëhershëm, mbërriti Charles Darwin që navigonte në bordin e "Beagle"-s, për të përfunduar teorinë e tij të evolucionit. Ai e përshkroi qytetin Konsepsionit si një grumbull tullash e trugjesh të shkatërruara dhe vuri re ndryshimet që kishte pësuar vija bregdetare si pasojë e lëkundjeve sizmike. Vitin e shkuar, një gjeolog francez dhe kilian ripanë të dhënat dhe shënimet e natyralistit britanik dhe publikuan një studim (pa dhënë një datë të saktë) se një tjetër tërmet i madh, me magnitudë më të madhe se 8 do të ndodhte brenda një kohe të shkurtër në brigjet e Kilit. Artikulli i tyre u publikua në qershor të vitit të kaluar në revistën "Physics of the earth and planetary interiors". Ambicia e tij nuk ishte parashikimet e sakta, por një vëzhgim statistikor i bazuar në lugin e numrave të mëdhenj. "Zona e Konsepsionit është shumë e matur nga pikëpamja sizmike, duke parë se asnjë tërmet i madh nuk është verifikuar që nga viti 1835". Dy pllakat e Nazca-s dhe Amerikës së Jugut që nga koha e Darwinit

janë afruar me 10 metra në krahësim me pjesën tjetër të zonave të tyre. Të shtunën në mëngjes, sizmografët nisën të regjistronin një seri lëkundjesh të lehta, shenjë paralajmëruese kjo për atë që do të ndodhte më vonë, tërmetin e tmerrshëm me magnitudë 8.8 ballë. Tërmetet e shkaktona nga lëvizja e subduksionit janë shpesh më të egra. Pikërisht lëvizjes së këtyre pllakave iu atribuua edhe tërmeti më i tmerrshëm i regjistruar ndonjëherë në tokë me magnitudë 9.5 të shkallës Richter. Përshkallëzimi i egërsisë së lëkundjeve sizmike që kemi vënë re në muajt e fundit, është vetëm një efekt optik. Duke hedhur vështrimin tonë përtej si në hapësirë ashtu dhe në kohë vëmë re se tërmetet janë fenomenet më të rregullta të planetit tonë. Vlerësohet se lëkundjet sizmike pak a shumë të mëdha që prekin planetin tonë çdo vit janë me mijëra. Sizmografët regjistronin nga 12 deri në 14 mijë, nga të cilët vetëm 20 janë me magnitudë më të madhe se 7 dhe me dhjetëra të tjerë në gjendje të shkaktojnë viktima mes popullsisë.

Intervista

Barbara Romanowicz, sizmologe në Universitetin e Berklit

"Shkenca e ka të pamundur të parashikojë katastrofat"



Me një energji rreth 30 herë më të madhe se ai i Haitit, tërmeti kilian ka impresionuar edhe sizmologë të tillë si Barbara Romanowicz. Drejtuesja e "Siesmological Laboratory" e Universitetit të Berklit, ndodhet në një zonë me rrezik më të lartë sizmik të planetit, atë të San Franciskos, të përshkruar si në pritje të "Big One". Në studion e saj gjenden aparaturat më moderne për këto fenomene natyrore.

Ekzistojnë lidhje mes tërmetit në Haiti, Japoni dhe Kili?

Jo. Japonia është shumë larg nga Kili për një tërmet të përmasave të tilla. Dhe kur valët sizmike përhapen në distanca kaq të mëdha, vetëm pas shumë muajsh apo vitesh mund të shkaktojnë një tjetër tërmet

Tërmetet e fundit nuk hapin rrugën për të parashikuar tërmetet e ardhshme?

Këto tërmete prekin pllaka të ndryshme tektonike, ndaj përgjigjia është jo. Çdo zonë e kores ku ndodh një përplasje apo ndonjë lloj stresi ka një histori më vete. E dimë që ka energji të akumuluar në koren e tokës, por të dimë se kur do të çlirohet është e pamundur.

Përshtypja se numri i tyre është në rritje, konfirmohet nga shkenca?

Jo, absolutisht çdo javë verifikohen kataklizmi në planet, por ne i marrim vesh vetëm kur prekin qendrat e mëdha. Afërsia kohore mes tërmetejeve të fundit na ka bërë që të kemi një lidhje mes tyre.

Rindërtimi i qyteteve të shkatërruara

Gjatë shekujve, tërmetet zjarret, përmytjet dhe luftërat kanë shkatërruar e rrafshuar shumë qytete e civilizime të mëdha të planetit, por ato janë ndërtuar sërish nga e para. Ja disa nga këta shembuj frymëzues rindërtimesh



BERLINI
Historia 200-vjeçare e Berlinit është ajo e një qyteti që është përbërur me luftëra dhe rindërtime. Në fund të Luftës së Dytë Botërore britanikët e bombarduan Berlinin, ndërsa kombëtorja sovjetike shkatëroi më pas edhe godinat e rindërtimit të kryeqytetit me granata dhe tanke. Rindërtimi i një qyteti të shkatërruar nga dora e një lufte gjatë shumë viteve është një shkatërim nga një fatkeqësi natyrore. Vendet e Berlinit e Berlinit, qyteti u rinovua me synimin që të shndërrohej në një simbol të pushimit mes Lindjes dhe Perëndimit të ndoshta e përjetshëm e Luftës së Ftohtë. Kur Gjermania u ribashkua në vitin 1999, Berlini mori veshin dhe rindërtimi që ka si një nga kryeqytetet më të rëndësishme të Europës dhe të botës.



ANTIQUA, GUATEMALA
Antigua ka qenë kryeqyteti i Guatemalës dhe u zhvendos dy herë para se të vendosej që kryeqytet të bëhej një tjetër qytet i vendit. Pas konflikteve midis me spanjollët, ndodhi zhvendosja e parë nga ajo që aktualisht quhet Xicomilá në Xugulinë e Achiutlan. Kjo pas shpërthimit të një vullkani shumë të madh në vitin 1541. Por pas këtij shkatërimi, qyteti u ndërtua sërish. Por një seri tërmetesh të tjerë shkakuan dëme të mëdha në shekullin e 18, derisa më në fund spanjollët vendosën që kryeqendra e vendit të shndërrohej qytet i Guatemalës.



ANTIQUA
Ata pak qytetarë që vendosën që të qëndronin pas evakuimit të qytetit ndërtuan një Antigua të re, që do të qëndronte sipas tyre në harmoni me gërmadhat e së arkuarës. Në vitin 1979, qyteti u konstatua nga UNESCO si qendër e trashëgimisë botërore dhe për arsak të etabluar të saj, ajo është një nga pikat më të rëndësishme turistike të zonës.




LISBONA
Një tërmet në mëngjesin e 1 nëntorit të vitit 1755 shkaktoi një cunami shumë të madh dhe një zjarr të përmasave të jashtëzakonshme që shkatërruan edhe qendrën e një qyteti të Lisabonës. Tërmeti pati ndikim shumë të madh në Portugal, duke shkatërruar edhe mënjohje politike dhe mëkthje për goditje e mëkthje për ambicidet koloniale të vendit. Megjithatë qyteti u rindërtua dhe sot vazhdon të jetë kryeqyteti i Portugalisë.



SAINT-PIERRE, MARTINIQUE, 1902
Qyteti bregdetar i Saint-Pierre u shkatërrua më 8 maj të vitit 1902, kur vullkani i Mount Pelée shpërthoi dhe mori jetën e mbi 30 mijë vetëve, që përbënin thuajse tërë popullsinë e vendit. Në vitin 1902, ai ishte një qytet i madh dhe i fuqishëm, një pikë e fuqishme ekonomike në trafikimin e rëndësishëm dhe të shpejtë. Por rindërtimi i tij ka qenë shumë i ngadalshëm dhe madje edhe sot vazhdon të dështojë për shkak të gërmadhave të vendit e tyre. Sot, qyteti kur një popullsi shumë të vogël, prej 5000 banorësh dhe kryesisht mbijetoi përmes të ardhurave nga turizmi.



SAN FRANCISCO
Në vitin 1906, tërmeti i San Franciskos ishte një nga momentet më legjendare në historinë e Kallifornisë, një shtet që ishte mësuar me tronditje të nëntokës. Në fakt, dëmin më të madh e shkakuan zjarret e shkakua nga tërmeti dhe jo vetë goditja. Lajmi i shkatërimit dhe fatkeqësitë u përhap me të shpejtë dhe bوندareja pasdhe shumë të shkurtra kohore nga i gatë vendi vëzhgim sasi të mëdha paraqitje për rindërtimin e tij. Ashtu si edhe Lisabona, tërmeti për San Francisko ishte një mundësi më shumë për të rinovuar veten. Në vitin 1915, qyteti i ri ishte ndërtuar 100% dhe tashmë ishte e njësi me i bukur dhe më komod se më parë.



TOKIO
Tërmeti me shkatërrime shumë të larta që goditi Tokion shkaktoi mbi 100 mijë viktima, por në përfundim të tij u krijuar një plan rindërtimi, në të cilin u përfshinë edhe rrymat moderne të transportit publik si metrot, autobusët dhe rreze pas edhe trenat. Si edhe në raste të tjera, edhe në rastin e Tokios, pati diskutime në lidhje me qëndrimin edhe në të ardhmen aty të qeverisë, për shkak të rrezikshmërisë së zonës, por një pas u vendos përfundimisht që Tokioja do të vazhdojë që të ishte qytet ku do të qëndronte salla e qeverisë.

Greçia në kolaps – Evropa në ankth



Avni AVDIU

Në kontinentin vjen era e protestave, një erë që nuk ishte ndier që nga viti 1968. Evropa është mbërthyer nga paniku i pasojave të krizës në Greqi, që tani po ndihet që nga Portugalia e Spanja e deri në Itali. Në Francë grevat e organizuara nga punëtorët e rafinimit të naftës dhe të trafikut ajror po kërcënojnë që ta bëjnë edhe më kaotike situatën në këtë vend. Papunësia është e lartë 10%. Në vitin 2009 u humbën 400 mijë vende pune. Gjiganti italian FIAT ka ndërprerë prodhimin në të gjithë Italinë, duke lënë jashtë një forcë punëtoresh prej 30 mijë personash për dy javë dhe ndërkaq për muajin në vijim janë parashikuar edhe mbyllje të tjera. Një tjetër vend me një situatë të vështirë është edhe Spanja. Aktualisht, Spanja po përballet me një rezistencë shumë të vendosur dhe të organizuar të punonjësve kundër politikave të qeverisë socialiste të Zapateros, i cili ka marrë masa shtrënguese për të vënë në linjë financat. Shumë analistë druajnë se mos një krizë në Spanjë mund të jetë edhe më e rëndë dhe me pasoja më të mëdha se ajo e Greqisë dhe kjo për arsyen e thjeshtë se ekonomia spanjolle është 5 herë më e madhe se ajo greke dhe në këtë rast edhe burimet dhe rezervat e shteteve të pasura të Bashkimit Evropian si Gjermania e Franca nuk do të mjaftonin për të shpëtuar falimentimin e shtetit. Në Gjermani pritet një grevë masive e punëtorëve të “Lufthansas” ku pritet të protestojnë 4500 pilotë avionësh dhe situata vazhdon që të mos jetë e stabilizuar edhe në ekonominë më të fuqishme të kontinentit. Kancelarja Merkel, e cila po përballet me një rekord të borxhit të brendshëm prej 100 miliardë eurosh, me protestat dhe me realitetin e vështirë të vendeve në jug të kontinentit që kërkojnë para për t’u shpëtuar, po përpiqet që të gjejë rrugëzgjdhje. Por gjithsesi, deri më tani, situata më problematike ka të bëjë me Greqinë, një vend

anëtar i Eurozonës, i përfshirë nga grevat dhe protestat që prej kohësh. Greqia është e zhytur në borxhe dhe punëtorët po organizojnë greva dhe protesta ndaj masave të rrepta të qeverisë për uljen e deficitit buxhetor. Protestat e mbështetura nga Partia Komuniste kanë tentuar që të bllokojnë bursën e Athinës, dhe ditët e fundit janë mbyllur shumë shërbime publike si aeroportet, hekurudhat, transportin detar. Inati i punëtorëve ka të bëjë kryesisht me shkurtrimin e përfitimeve që kanë pasur deri më tani. Këto greva dhe protesta kanë mbyllur dhe vazhdojnë që të mbyllin shkollat, zyra qeveritare dhe gjykata. Shqetësime dhe vonesa të mëdha ka pasur me bankat, spitalet e kompanitë e drejtuara nga shteti. Kjo nuk është kriza e parë e tmerrshme nëpër të cilën po kalon Greqia, por është më e pashpresa. Kryeministri George Papandreou e krahasoi krizën e buxhetit të cilën po përjeton vendi me situatën e një kohe lufte dhe tha se Greqia ishte në prag të falimentimit. Kur, në vitin 1981, Greqia u bë anëtare e Komunitetit Ekonomik Evropian (EEC) mori shumë para dhe grekët, fillimisht, nuk dinin se si ta menaxhonin këtë sasi. Gjatë 2004-2008, Bashkimi Evropian i ka dhënë Greqisë miliarda euro. As politikanët dhe as njerëzit e thjeshtë nuk kishin një vetëdije të qartë për këto para. Më pas, të gjitha qeveritë që erdhën në pushtet mbështetën mënyrën e jetesës mbi kredi dhe borxhe. Aktualisht kemi mbërritur në një pikë kur popullsia nuk dëshiron që të shtrëngojë rripin dhe qeveria, ndërkohë nuk mund të menaxhojë financat e saj. Në Greqi, 1 në 10 qytetarë është nëpunës shtetëror, kurse shpenzimet në aparatit shtetëror tejkalojnë në bazë vjetore 70,5

miliardë euro. Borxhi shtetëror rritej me proporcionin gjeometrik, prodhimi vendas ulej, klasa politike deklaronte shifra të rreme. Askush nuk maste realisht borxhin, i cili deklarohet thjesht brenda burimeve qeveritare, nga një ministri në tjetrën. Sistemi i tatimitaksave, linte shumë për të dëshiruar, evazioni fiskal “lulëzonte”. “Gota u mbush krejtësisht” nga qeveria konservatore e Kostas Karamanlis, pas vitit 2004. Reformat ekonomike shtyheshin çdo ditë për më vonë, derisa në vend shpërtheu “orteku” i madh financiar. Korrupsioni ka depërtuar në të gjitha shtresat e shoqërisë. Sipas “Transparency International”, mesatarja e grekëve paguan çdo vit rreth 1000 euro në rryshfete për çështje personale. Në Greqi, edhe qytetari më i ndërgjegjshëm ka hequr dorë nga morali i tij dhe sot mendon se shmangia e taksave është një veprim i justifikueshëm. Ai mendon se kjo është e vetmja mënyrë për të pasur para. Nga kjo del se e gjithë shoqëria, deri në skajet e saj më periferike, ndan një faj të madh të përbashkët. Qeveria greke ka shpallur hollësisht shkallën tatimore të të ardhurave për të gjithë, duke theksuar se ata që fitojnë më shumë duhet edhe të paguajnë më shumë. Sipas këtij sistemi duket, në pamje të parë, se nuk preken shtresat e mesme të popullsisë, me të ardhura nga 20.000 deri në 40.000 euro. Edhe Presidenti grek Karolos Papulias, ka kërkuar që edhe rroga e tij të mos përjashtohet nga ligji i ri i reduktimeve të të ardhurave.

Në perspektivën evropiane kriza greke ka hapur një udhëkryq të papritur. Kancelarja Merkel tha se kriza në Greqi e ka vënë në monedhën Euro në vështirësinë më të madhe që ajo njeh, që prej hedhjes në treg. Ndihamat do të jenë të domosdoshme. Greqia së shpejti do të ketë nevojë për 50 miliardë euro. Këto para duhet të vijnë prej Gjermanisë dhe vendeve të tjera anëtare. Në një shkrim në “Washington Post” analizohet arsyeja se përse populli gjerman refuzon të ndihmojë Greqinë në shlyerjen e borxheve. Gjermanët janë të inatosur, sepse së pari me paratë e taksapaguesve u shpëtuan nga falimentimi bankat e mëdha



të vendit dhe së dyti tani kërkohen para të tjera për të shpëtuar nga falimentimi shtete të tëra. Sipas "Washington Post" tregohet qartë se gjermanëve u ka ardhur në majë të hundës, duke paguar faturat e çdokujt në Evropë. Megjithatë, gazetaret greke po paralajmërojnë për një mundësi të "histerisë antigjermane". Pas faqes së parë të revistës gjermane "Focus", në të cilën pasqyrohej një foto jo shumë e këndshme e statujës së Venusit, një grup konsumatorësh grekë bëri thirrje për bojkotin e mallrave gjermane. Dhe më pas, Theodoros Pangalos, zëvendësministri grek, deklaroi publikisht se gjermanët morën paratë e grekëve dhe arin e tyre gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe kanë refuzuar gjithmonë që të paguajnë reparacionet e luftës. Ato që shtypi i një vendi evropian raportoi këto ditë ishte rrëqethëse. Disa parlamentarë, me siguri duke shprehur vetëm opinionet personale, i bënë thirrje Greqisë të shesë një pjesë të ishujve në këmbim të ndihmës financiare. Kjo reminishencë nostalgjike e epokave imperiale tingëllon e çuditshme në fillim të shekullit të 21. Media amerikane u kërkoi grekëve të shesin ishujt dhe Akropolisin. Kriza e Greqisë po dëshmon kundërshtitë dhe mosmarrëveshjet në kuadrin e Evropës së vjetër për mekanizmat dhe burimet e zgjidhjes së saj. Qëndrimi i parë kufizohet në solidaritetin dhe mbështetjen morale, ndërsa qëndrimi i dytë, më bujari dhe realisti, shkon përtej moralitetit e solidaritetit, pra te ndihmat financiare. Problemi i Greqisë ka treguar se institucionet financiare të BE-së nuk kanë fuqi dhe përvojë të mjaftueshme që të "sundojnë" shtetet anëtare renegate, thotë Zhan-Pierr Zhoje, ekonomist francez dhe ish-anëtar i stafit të presidentit të komisionit evropian. Ajo çfarë po ndodh në Greqi nuk do të mbetet me kaq, do t'i tejkalojë kufijtë e saj. Nga kjo frikë, vendet e Eurozonës kanë rënë dakord për një paketë shpëtimi shumë miliardëshe për Greqinë, si pjesë e masave që po merren për të shpëtuar monedhën e përbashkët, euro. Edhe pse vendi helenik paraqet vetëm 0,5% të ekonomisë botërore, shembja e këtij vendi financiarisht do të ketë pasoja globale. Pasojat financiare të rrezikut të "rastit financiar grek" është duke u bërë kërcënimi më i madh për monedhën euro dhe projektin evropian. Kriza në zonën e euros thekson nevojën për një

debat më të hapur në lidhje me meritat dhe defektet e ultra-inflacion të ulët.

NGA ARTIKUJT MË TË RËNDËSISHËM TË SHTYPIIT BOTËROR

"The Times" i Londrës- "Nëse grekët nuk shtrihen pa protestuar në shtratin e operacionit, e gjithë ndërtesa evropiane rrezikon të shembet".

BBC- "Nëpunësit shtetërorë të Greqisë, megjithëse nuk u dëmtuan në atë shkallë sa ata të Irlandës, protestojnë për faktin se ata që kanë të ardhura të pakta do të vuajnë, ndërsa të pasurit përsëri do të përfitojnë".

"Los Angeles Times" - "Qeveria greke ka për të përballuar një vepër titanike, ashtu si Herkuli pastroi stallën e Avgjias, ashtu edhe ajo duhet të shkarkojë këtë borxh të madh që kërcënon të ardhmen ekonomike të Evropës. Greqinë e pret një e ardhme spartane".

"Wall Street Journal" - "Megjithëse zgjidhja në problemin financiar të Greqisë është padyshim lufta kundër evazionit fiskal, kjo nuk është aspak e lehtë".

"The Independent" - "Nuk është ende e qartë nëse protestat e programatuara janë shenjë e një rebelimi serioz të punëtorëve kundër masave të qeverisë, apo thjesht pasqyrë e mospëlqimit nga ana e sindikatave, të cilat i kanë grevat si praktika të zakonshme në këto raste".

CNN, artikulli i plotë për krizën greke. E para, në atë çka parashikohet të jetë një radhë grevash, ka filluar në Greqi. Punonjësit e sektorit publik protestojnë kundër masave të ashpra të vendosura nga një qeveri, e cila po përpiqet të gërmojë rrugën e saj për të dalë nga një krizë financiare, e cila rrezikon të mbërthejë mbarë Evropën. ■



Çamëria

Rini HYSENI

Çdo ditë e më shumë jo vetëm në mediat greke, por edhe ato të huaja, një vend të rëndësishëm zënë reportazhet dhe analizat, të cilat kanë në qendër të tyre Greqinë, krizën që ajo po kalon, pasojat që lidhen me të. Mirëpo po të shikojmë nga prizmi shpirtëror, duket se Greqinë e ka zënë ahti i çamëve. Grekët po shfrytëzojnë pa mëshirë shqiptarët. Po diskriminojnë një gjysmë milioni popull. Duan të krishterizojnë gjithë jugun dhe të helenizojnë gjithë brezin e ri të Shqipërisë. Çështja e emigrantëve është një rast tjetër, rast i të drejtave të njeriut, pasi kemi mungesën e arsimit të tyre në gjuhën amtare, gjë që është një standard i njohur në Bashkimin Evropian.

Historikisht, territori që tashmë është Greqi Veriore, nuk ka qenë banuar kurrë nga grekët deri kohët e fundit. Në vend të tyre, popullsia përbëhej më së shumti nga turq, shqiptarë, bullgarë, vllleh, sarakacanë, pomakë dhe romë. Si rezultat i shpërnguljeve pas luftërave ballkanike, si dhe i shkëmbimeve të popullsisë midis Greqisë dhe Turqisë më 1922, mandej pas Luftës së Dytë Botërore dhe Luftës Civile greke, qindra mijëra jogreke u detyruan të iknin nga Greqia për t'u zëvendësuar me grekë etnikë nga Azia e Vogël dhe grupe më të vogla nga Athina, që u vendosën me strategji në qytetet dhe fshatrat e trevave kufitare, nga ku ata do t'i raportonin Athinës mbi veprimtarinë e popullsisë jogreke. Në dekadat që pasuan që nga ajo kohë, kryesisht çamët e krishterë ortodoksë që mbetën në Greqi janë duke luftuar për t'i mbijetuar asimilimit kulturor. Kjo praktikë vazhdon deri në ditët tona dhe është një tregues i kërcënimit që ende ndiejnë autoritetet greke nga kufijtë veriorë.

Përgjigja e Athinës ndaj çështjes çame është e njëjtë si për çdo gjë që ka të bëjë me çështjet e pakicave, konkretisht – për të kjo çështje nuk ekziston.

Sikurse është e njohur në qarqet çame, një pengesë e madhe për të gjetur një zgjidhje të pranueshme të çështjes çame është se teknikisht vazhdon të

- plaga që dhemb

ekzistojë gjendja e luftës midis Greqisë dhe Shqipërisë. Në tetor 1940, ushtria italiane kaloi kufirin grek, duke e futur automatikisht Shqipërinë në luftë me Greqinë. Tirana, natyrisht, këmbëngul që Shqipëria ishte një viktimitë e pushtimit fashist dhe hedh poshtë çdo përgjegjësi për sulmin. Në vitin 1985 është bërë e ditur se zyrtarët shqiptarë e kanë ngritur çështjen e gjendjes së luftës gjatë kontakteve të atij viti me homologët e tyre grekë, duke i kërkuar Athinës ta hiqte ligjin e luftës. Pas vizitës së tij në Tiranë, në janar 1985, zëvendësministri i parë i Jashtëm grek, Karolos Papulias, theksoi vëmendjen serioze të qeverisë së Papandreut për futjen në Parlamentin grek të një projektligji për t'i dhënë fund gjendjes zyrtare të luftës. Dy vjet më vonë, më 1987, Ligji i Luftës më në fund u shfuqizua nga qeveria greke, ndonëse ky vendim nuk është ratifikuar kurrë zyrtarisht nga parlamenti grek, i cili thotë se ekzistenca e një Traktati të Miqësisë, nënshkruar nga të dy vendet në mars 1996, e shfuqizon automatikisht atë. Njëzet nënet e traktatit theksojnë që marrëveshja do të jetë e vlefshme për një periudhë 20-vjeçare. Përndryshe, kjo do të thotë se marrëveshja është e detyrueshme të rivlerësohet nga secila qeveri aty nga viti 2016. Pronat e çamëve janë konfiskuar si rezultat i këtij ligji kontradiktor.

Athina zyrtare duhet të nisë të negociojë mbi të drejtat e çamëve sa më shpejt që të jetë e mundur, pasi ajo do të hapet dikur, por e rëndësishme është që ajo të bëhet shpejt.

Qysh nga viti 1985, qeveritë që ia kanë lënë vendin njëra-tjetrës në Shqipëri i kanë përsëritur me këmbëngulje Athinës ta shqyrtojë këtë çështje, por pa sukses. Udhëheqjet politike, si të Shqipërisë, ashtu edhe Greqisë, kanë interesa afatgjata me zgjidhjen e këtij problemi. Sa më shumë që çështja çame të mbetet e pazgjidhur, aq më shumë rritet rreziku që çështja të bëhet *pré e* ekstremistëve.

Problemet e vjetra të Ballkanit po gërmohen, por politika greke, si konservatorët ashtu edhe socialistët, e cilësojnë të mbyllur çështjen çame, ndërkohë që

reagimi i Tiranës është i plogësht nga dobësia e shtetit shqiptar.

Në fakt, faktori ndërkombëtar është aktivizuar, por e rëndësishme është që grekët do të duhet të vendosin të bëhen realistë dhe të fillojnë të bisedojnë, sepse përndryshe do të kemi turbullira për vite të tëra. Ndërkaq, edhe qeveritë shqiptare, si të së majtës ashtu edhe të së djathtës, kanë ndërmarrë përpjekjet e tyre për ta hapur këtë çështje, por grekët nuk e kanë marrë në konsideratë.

Çështja çame është një problem i të drejtave të njeriut, por nuk është vetëm i tillë, ndaj duhet të ishte zgjidhur shumë kohë më parë. Çamët kanë pasur një përvojë të keqe prej shumë kohësh dhe kanë harxhuar shumë pasuri për pasuritë e tyre të patundshme.

Duke shqyrtuar shumë raste delikate anekënd globit, bëhet më e lehtë për t'u kuptuar përse çamët e kanë të vështirë t'ia mbushin mendjen Evropës të merret me kauzën e tyre.

Në Poloni ka pretendime të jashtëzakonshme si nga hebrejtë, ashtu dhe nga gjermanët, dhe më pak nga rusët dhe ukrainasit. Polonia ka përmbushur disa kërkesa të hebrejve, por nuk pranon t'u kthejë ndonjë gjë gjermanëve. Në Republikën Çeke, gjermanët sudetë kanë pretendime territoriale dhe pronësore që mbështeten jozyrtarisht nga Gjermania dhe Austria. Praga nuk pranon shfuqizimin e dekretëve të Benes, që më 1945 u morën me forcë pronat 2.5 milionë gjermanëve, pa asnjë kompensim. Ka gjithashtu pretendime të shumta italiane mbi Slloveninë dhe Kroacinë për pronat në Istria, të marra nga Jugosllavia më 1945. Po ashtu, refugjatët maqedonas të Egjeut, që ikën nga Lufta Civile në Greqi, kanë pretendimet e tyre, të cilat janë hedhur poshtë prerazi nga Greqia. Ka vetëm pak çështje të ngjashme me çështjen çame, të cilat mbeten të pazgjidhura dhe që, në të vërtetë, përfshijnë drejtpërdrejt ose tërthorazi të gjitha vendet e Evropës Qendrore.

Çamët ende duken se kanë besim tek udhëheqësit ndërkombëtarë se do të ndërhyjnë për çështjen e tyre. Në shtator të vitit të kaluar, një grup çamësh të moshuar që jetojnë në Amerikë, i

shkruan një letër Nicholas Sarkozy-së në cilësinë e Presidentit, si të Francës ashtu dhe të Bashkimit Evropian. Letra e tyre e gjatë dhe prekëse jepte një histori të hollësishme të historisë së vuajtjeve të çamëve, që kthehej prapa deri te Kongresi i Berlinit më 1879. Ata i bënin thirrje Bashkimit Evropian si "një simbol i demokracisë dhe mbrojtës së të drejtave njerëzore për gjithë banorët e Evropës". Një javë më vonë, kjo u pasua nga një tjetër letër drejtuar Sarkozy-së, të shkruar nga përfaqësuesit e familjes mbretërore shqiptare në Paris. Kjo letër kërkonte gjithashtu "mirësinë e lartë" të Presidentit Sarkozy për ta trajtuar çështjen çame në emër të demokracisë evropiane. Letra pyeste: "Si mund të pranojmë ne një Bashkim Evropian që nuk respekton të drejtat e njeriut"? Përgjigja fatkeqësisht ishte se ata mund të kishin të drejtë. Çamët nuk mund të prisnin ndonjë "fener demokratik" për të ndihmuar kauzën e tyre, ndërkohë që BE mbetet në mëdyshje për të zbatuar ato që vetë predikon.

Prandaj dhe do apo s'do, i përket udhëheqjes shqiptare të merret seriozisht me çështjen çame. Vitet e fundit ka pasur disa debate të nxehta dhe të bujshme midis politikanëve shqiptarë, por ende nuk është bërë asgjë për të ndihmuar në zgjidhjen e këtij kanceri të panevojshëm që gërryen së brendshmi marrëdhëniet miqësore greko-shqiptare.

Profesor James Petifer, pedagog i historisë në universitetin mjaft prestigjioz të Britanisë, Oksford, në një intervistë dhënë gazetës 'Shqip' theksoi: "Në fakt, kjo është një çështje e njohur në Ballkan që i ka rrënjët që nga koha e Perandorisë Otomane. Unë mendoj se këtu kemi të bëjmë me çështjen e lidhshimit të Kishës Ortodokse Greke, pasi ka ende disa besimtarë ortodoksë që e kanë në konsideratë fuqinë e Greqisë. Unë mendoj se kjo nuk është çështje kombësie, por thjesht e karakterit fetar. Në janar të vitit (2009), gjatë bombardimeve të Gazës nga Izraelitët, një organizatë çame shpërndau një mesazh me titullin GAZA, SREBRENICA, PARAMITHIA. Kjo donte të thoshte se si palestinezët, boshnjakët dhe muslimanët çamë janë masakruar nga të krishterët. Pra, ekziston rreziku që radikalizimi i çështjes çame të marrë dimensione të padëshirueshme. ■"



Çmimi për 'Vepër Jetësore' në duart e Nazmi Rrahmanit

Në një ceremoni solemne, e cila u mbajt në ambientet e Galerisë së Arteve të Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Kosovës, bëri ndarjen e Çmimit Kombëtar Letrar për Vepër Jetësore "Azem Shkreli" dhe të çmimeve letrare vjetore. Sivjet, juria profesionale ka nderuar me çmimin për Vepër Jetësore "Azem Shkreli" shkrimtarin Nazmi Rrahmani, me çmimin për librin më të mirë të vitit 2009, Gëzim Aliun për romanin "Në klubin e të shëmtuarve". Poeti Ag Apolloni u nderua me çmimin letrar për librin më të mirë të vitit për poezi për veprën "Zomb". Eseiisti Ibrahim Berisha u nderua me çmimin letrar për librin më të mirë të vitit 2009 për kritikë dhe eseistikë, për veprën "Konvergjenca intelektuale", ndërsa përkthyesi Bekim Bejta u nderua me çmimin letrar për librin më të mirë të vitit të shkuar për përkthimin e veprës "Raga - afrim i kontinentit të padukshëm" nga Jean-Marie Gustave le Clezio. Ministri Valton Beqiri tha se organizimi i kësaj ceremonie është edhe një dëshmi e angazhimit dhe përkushtimit institucional të MKRS-së për mbështetjen, stimulimin dhe promovimin e vlerave të letërsisë sonë kombëtare. "Në këtë kontekst, - shtoi ai, - sivjet MKRS e ka zgjeruar gamën e çmimeve letrare, disa nga të cilat jepen për herë të parë". Ai përgëzoi laureatët e çmimeve letrare për vitin 2009, duke theksuar se MKRS do të vazhdojë ta mbështesë krijimtarinë letrare jo vetëm përmes këtyre çmimeve, por edhe përmes botimit dhe promovimit të saj. Në emër të laureatëve të shpërblyer u falënderua Nazmi Rrahmani. Në ceremoninë solemne u tha se MKRS ka vendosur që mjetet materiale të çmimit të refuzuar nga shkrimtari Rexhep Hoxha t'i destinojë për botimin e letërsisë për fëmijë.


(Përgatitur nga Flamur Maloku)

10 vjet pa pagesë

Janë pak institucione të kulturës në Kosovë, të cilët krijojnë të hyrat e tyre. Filarmonia e Kosovës, tash e dhjetë vjet, jep koncert pa asnjë pagesë. Thonë se e kanë në plan të bëjnë diçka, por kur nuk dihet. Teatri Kombëtar mbetet si vjelësi më i madh i mjeteve

Ka dhjetë vjet që Filarmonia e Kosovës nuk detyron asnjë qytetar të Kosovës të paguajë nëse ai dëshiron ta dëgjojë një vepër të bukur që e ekzekuton ky institucion. Madje edhe pse koncertet nuk janë të shpeshta, qytetari mund të hyjë në sallë (zakonisht Salla e Kuqe), të shëtisë dhe të dalë si në bahçe të babës, pa e futur dorën në xhep. Njëra prej arsyeve që ka sjellë deri te kjo mospagesë është mos popullarizimi i muzikës serioze, e cila lidhet paralelisht me arsyetimin banal se Filarmonia e Kosovës nuk ka sallë, por edhe çështje teknike që do të thotë: vend për t'i shitur biletat. Deri në vitin 2007, Filarmonia e Kosovës ka paguar Sallën e Kuqe për t'i mbajtur koncertet. Ndërsa që nga kjo kohë ajo nuk paguan për këtë sallë. Sipas Baki Jasharit, Filarmonia e Kosovës nuk ka një objekt të saj, sikurse teatri, ku mund t'i shesë biletat, ndërsa edhe mospagesa, sipas Jasharit, lidhet edhe me atë që për të qenë pjesë e festivaleve të muzikës serioze nuk paguhet. "Mendoj se pyetja është e drejtë dhe me vend dhe do të shqyrtohet seriozisht, por do të shkohet në drejtim të realizmit vetëm kemi probleme teknike", - është shprehur Jashari. Ai tha se çmimi i biletës do të mund të ishte 2 deri në 3 euro, por jo më shumë. Kur do të fillojë të aplikohet kjo pagesë, ende nuk dihet. Mirëpo institucioni i vetëm që sot ka të hyra është Teatri Kombëtar i Kosovës, Ansambli i Këngëve dhe Valleve "Shota", IMM Prishtinë, IMM Pejë dhe IMM Prizren. Institucionet e tjera, si: Muzeu i Kosovës, Galeria e Arteve e Kosovës, nuk kanë të hyra të tyre. Teatri Kombëtar i Kosovës, vetëm gjatë muajit janar, ka krijuar të hyra vetjake prej afro 1500 euro. "Ndërsa në vitin 2009, janë 9 mijë e diçka euro, gjë që, në një mënyrë, na bën të lumtur", - është shprehur Burbuqe Berisha, drejtoresha e Teatrit Kombëtar të Kosovës. Sipas saj, mjetet e mbledhura shfrytëzohen nga TKK edhe pse ka vonesa në kohë. "Unë jam për një transparencë, por jo edhe të ketë aq lëvizje të mëdha që së pari mjetet të derdhen në thesar e pastaj të na vijnë, por ato mjete të derdhen në xhirollogarinë e TKK-së dhe ato mjete të jenë transparente e të përdoren për nevoja të teatrit", - tha Berisha. "Kjo çështje është e përcaktuar me Memorandumin e Mirëkuptimit, të nënshkruar ndërmjet MKRS-së dhe MEF-it dhe kjo është bërë me qëllimin e evidentimit të saktë të mjeteve të grumbulluara dhe të shfrytëzimit të tyre nga institucionet që i kanë krijuar vetë ato", - është shprehur në anën tjetër Arbërore Riza, këshilltare dhe zëdhënëse për media. ■

Nuk e pengon futbollli për namaz



Jahmir Hyka



Alban BILALLI

Jahmir Hyka, futbollist i kombëtares shqiptare dhe i skuadrës gjermane nga Bundesliga, përveç stërvitjeve të përditshme që janë obligative për një futbollist, gjen kohë edhe për t'u falur pesë herë në ditë. Për të, çdo gjë është e programuar. Ai mund t'i gjejë 30 minuta për namaz pa problem. "S'kam problem. Çdo gjë është e programuar, plus që 30 minuta në ditë për faljen mund t'i gjejë kushdo," - ka thënë Hyka për një intervistë, dhënë një mediumi gjerman. Pos tij, në familje falen edhe dy vëllezërit, dy motrat si dhe prindërit. Ai ka filluar ta falë namazin që nga mosha 12 vjeçare dhe vazhdon ta falë ende. "Unë kam filluar të falem që në moshën 12 vjeçare, pasi në familjen time tiranase falen pothuaj të gjithë, dy motrat dhe dy vëllezërit e tjerë, po ashtu dhe prindërit kanë filluar të falen

nga pak." Pos namazit, ai respekton edhe obligimet e tjera të fesë islame. Agjërimi e muajt të shenjtë Ramazan, që është shtylla e tretë e Islamit, ai e kryen edhe pse mundohet që në ditët kur ka ndeshje të mos agjërojë. "Mund të them që kudo ku kam qenë nuk më është ndaluar një gjë e tillë. Megjithatë, mundohem që në ditët kur kam ndeshje të mos agjëroj," - ka thënë Hyka.






Falja e namazit, agjërimi i Ramazanit, si dhe predikimi i riteve tjera islame, i janë shpërblyer Hykës. Ai është vetëm 22 vjeçar dhe luan në Bundesligën gjermane, njëra nga ligat më të forta në botë, gjë që është privilegj i madh për një futbollist. Hyka, po ashtu, luan edhe për Kombëtaren e Shqipërisë. Paga mujore e Hykës është afro 20 mijë euro. "Paga ime mujore është më shumë se 20 mijë euro në muaj. Por ndoshta bëj gabim që e deklaroj këtë shifër në media, edhe për moshën e re që kam. Shumë, mbase, nuk do ta besonin," - është shprehur Hyka.

Karriera e Hykës

Hyka njihet si një futbollist shumë

i shpejtë dhe një driblues i talentuar. I lindur më 8 mars të vitit 1988 në Tiranë, Hyka e nisi karrierën e tij prej futbollisti në vitin 2000 te skuadra 'Dinamo' e Tiranës, ku qëndroi plot 6 vite. Në vitin 2006, ai nënshkroi një kontratë me gjigantin norvegjez Rosenborg, klub nga i cili u largua pas një viti, pasi si 16 vjeçar ai nuk mundi të gjente vend si titullar. Edhe pse klubi norvegjez dëshironte ta mbante, Hyka u largua për në Greqi, ku nënshkroi kontratë me klubin e Olimpiakosit. Ai arriti vonë në klubin grek, kështu që klubi e huazoi te skuadra e Tiranës. Me Tiranën ai zhvilloi 32 ndeshje, duke shënuar 7 gola. Në maj të vitit 2008, ai nënshkroi kontratë me klubin gjerman 1. FSV Mainz 05. Kontrata peshonte 3.7 milion euro për 4 vite.

Hyka, po ashtu, ka zhvilluar edhe 6 takime për kombëtaren e Shqipërisë dhe ka shënuar vetëm një gol, kundër Lihtenshtajnit. Ka debutuar për Shqipërinë në përballje me Rumaninë, ku Shqipëria u mposht nga Rumania me rezultat të thellë 6-1. ■

AUTOR: AGIM GASHI	DËME	LËNDE E FORTË PLASTIKE	KUFINJTË	PËREMËR DËFTOR	QËLLIM	DUAL NAME LISTING	AMPERI	EKREM KRYEZIU	PJESË E CMIMIT	PJESA E ZGJEDHUR E SHOQËRISË		TOKËZIMET	POLITIKANI SHOIPTAR, ILIR	MËSYMJA, SULMI						
SHTET ISHULLOR OQEANOR											BURIMI E QESHUR TALLËSE									
ETIOPAS							ÇELIKOSET INSTITUTE of FIRE ENGINEERS													
POLITIKANI, ILJAZ								TIKETA SHPRESA GASHI												
MJET LUNDRIMI						FSHATAR REPUBLIKA														
CEREMONI FETARE				AI QË BËN NJË LLOJ EKONOMIE LLOJ BIME FRUTORE									INDUKSIONI E ARABISË							
I MORALIT											KRYEHOXHË									
 I AFËRMI I DËRGUAR SPECIAL																FUTBOLLISTI ANGLEZ, XHON				
ENERGJIA		ELIDA KRYEZIU POROSIA														SHKRONJË GREKE			HENDEK, LLOCORE	
LUMË YNI																TONI	BANKA POPULLORE I NJË DEGE TË MATEMATIKËS			
GRIMËCOJ			REOMIRI LLOJ LËNDE SHUMË E ËMBËL													 AJËR (ang.) BANOR I NJË KONTINENTI				
SHUMË																KASA				
ANËCAK																OYTET SHOIPTAR (pashq.)				
ROBERT EARL KEEN				I ZALLIT							MËRIA	PJESË SHTËPIA	HEROI, VOKSHI (shq.)	TETOVA	INDIA	RADIO- TELEVISIONI			AUSTRIA FUTBOLLISTI SHOIPTAR, ADRIAN	
 SEKT I VECANTË ISLAM THAVA																BESIMI ISLAM SHTABI I PËRGJITH.				
BANORE E QYTETIT NË FOTO															VË KËMBËN PËREMËR VETOR				KOSOVA LIBERATION ARMY	
DHE		PËREMËR PYETËS INTERNET MULTIMEDIA						I MPITË ERBIUMI												
NOTIMET E SËRISHME										VEND NË NEPAL AZOTI										
EMNAKU I AMARËS						AJO QË BËN IRONI														